

Shkurt 2012
Numri: 47
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

Shqipëri: 150 Lek
Kosovë: 1 Euro
Maqedoni: 60 Den

ETIKA

QËNDRUESHMËRIA
NË BESIM





Editorial

- O i dërguari i Allahut! Më mëso ndonjë gjë në lidhje me Islamin që të më mjaftojnë dhe të mos kem nevojë të pyes kënd tjetër në lidhje me këtë çështje.

I dërguari i Allahut tha:

- Beso tek Allahu dhe qëndro i vendosur në besimin tënd. (Muslim, Iman 62, 38)

Me këto dy fjalë, i dërguari i Allahut krijoi kornizën e “konsistencës së myslimanit”:

- Besimi dhe **qëndrueshmëria në rrugën e drejtë (istikamet).**

Njëra është konsistenca e zemrës, ndërsa tjetra pleksja e modelit të jetës...

Të thuash “besova” dhe më pas të bësh përpara në këtë “rrugë” pa dalë prej saj, pa bërë zikzake, pa u lëkundur, të bësh para me saktësi...

Deri në xhenet.

Ky është udhëtimi i myslimanit.

Ky udhëtim është shprehur në mënyrën më përmbledhëse në bashkimin e fjalëve “udha e drejtë” (sirati mustekim) dhe është shndërruar në skeletin kryesor të përmbajtjes së kulturës islame.

Sirat: udhë.

Mustekim: e drejtë.

Sirati Mustekim: udha e drejtë.

Udha e drejtë është shndërruar në një tipar të atillë për myslimanin, saqë ai ndjen çdo çast domosdoshmërinë e pushtimit nga ndjeshmëria për të qenë përherë në këtë udhë.

Kjo rrugë i është treguar myslimanit nga vetë Allahu, nëpërmjet Kuranit dhe praktikës së të dërguarit të Allahut.

Të jesh në rrugën e drejtë, ka disa forma:

1. Mund të jesh në rrugën e drejtë me fjalë, me vepra dhe me zemër.
2. Mund të mos jesh në rrugë të drejtë me fjalë, por me vepra dhe me zemër. E para është më lart se e dyta.
3. Mund të jesh në rrugë të drejtë me fjalë dhe me vepra, por nuk je me zemër.
4. Mund të jesh në rrugë të drejtë me zemër dhe me fjalë, por nuk je me vepra.
5. Mund të jesh në rrugë të drejtë vetëm me fjalë dhe të të mos jesh me zemër dhe me vepra.
6. Mund të jesh në rrugë të drejtë vetëm me zemër dhe të mos jesh me fjalë dhe me vepra.
7. Mund të jesh në rrugë të drejtë me vepra dhe të mos jesh me fjalë dhe me zemër. (Ruhul Bejan, c. 1, 115)

Nuk ka dyshim se qëllimi final është “të jesh në rrugë të drejtë me zemër, me fjalë dhe me vepra”, që do të thotë të arrihet një pleksje e plotë në të gjithë shkallët e personalitetit të njeriut.

Do të lexoni:



Ahmet Tashgetiren /

Besimi dhe vendosmëria në rrugën e drejtë

4



Ahmet Tashgetiren / 4

Besimi dhe vendosmëria
në rrugën e drejtë

Ma. Muhidin Ahmeti / 8

Drita e besimit dhe e Mevludit -1-

Nuredin Nazarko / 11

Dyzimi i njeriut

Ajni Sinani / 12

Islami, fe dhe shtet

Ma. Gilman Kazazi / 16

Edukata ndaj Kuranit

Edison Çeraj / 19

Mbi pasqyrimin e transcendencës
hyjnore në artet pamore

Arjan Ymeraj / 22

Istikame

Altin Torba / 24

Beteja e suksesit

Nexhat Ibrahimimi / 26

Refleksione morale në Kuran

Vehbi Vakasogllu / 29

Civilizim pa dashuri
- Dashuri pa civilizim

/ 32

Fotoja e Muajit


Mustafa Erish / 34

Nga duhet të fillojmë që ta lexojmë
dhe mësojmë Islamin? -2-

Nexhat Ibrahimimi /

Refleksione morale në Kuran

26



Mustafa Erish /

Nga duhet të fillojmë që ta lexojmë
dhe mësojmë Islamin? -2-

34



Viti: VI | Numri: 47 | Shkurt 2012

Drejtor & Kryeredaktor:

Alban Kali

albankali@yahoo.com

+355 67 20 86767

Redaktor:

Zija Vukaj

Korrektore:

Ma. Irida Hoti

Përkthyesit:

Albert Halili / Arjan Ymeraj / Artur Tagani

Elona Sytari / Fatmir Sulaj / Ilir Hoxha

Kopertina:

Edison Çeraj

Dizajn-Grafik:

Bledar Xama

Për artikuj:

e-mail: revistaetika@progresibotime.com

e-mail: kosova@progresibotime.com

e-mail: maqedoni@progresibotime.com

Shkurt 2012

40

Osman Nuri Topbash /
Të mos harrosh përkohshmerinë



46

Zamira Bushati /
Edukimi i brezit të ri me moralin fetar



56

Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz /
Dashuri dhe vëllazëri me qendër besimin



Një Ajet - Një Hadith **38 -39/**

Të mos harrosh përkohshmerinë **40 / Osman Nuri Topbash**

Edukimi i brezit të ri
me moralin fetar **46 / Zamira Bushati**

Dhikri **48 / Abdullah Byjyk**

Durimi në sprovimin me mirësi **50 / Hatixhe Jëlldëz**

Kriza globale në ekonomi
është kriza e modernizmit **52 / Ali Bullaç**

Dashuri dhe vëllazëri
me qendër besimin **56 / Prof. dr. Hasan K. Jëllmaz**

Dija të bën njeri **59 / Shejda Muhamed Konevi**

Kapaciteti i mendjes
dhe fuqija e bindjes **62 / Zani i s'kaluemes**

Popujt do të ekzistojnë
për sa kohë që do të ruajnë
parimet dhe bazat e moralit **64 / Imam Naim Drijaj**

Hasan Haki pashë Bushatlliu **65 / Ma. Ermal Nurja**

Tregimet Islame **66 / Ma. Artur Tagani**

Xheneti, parajsja myslimane **68 / Enciklopedi Islame**

Lamtumirë Nënë!
70 / Familja

Kini kujdes
nga pecetat e letres që përdorni **72 / Shëndet**

PROGRESI
BOTIME
www.progresibotime.com

Adresa:

L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi
Shkodër / Albania
Tel: +355 22 254 634
Fax: +355 22 254 633

Zyra e përfaqësimit Maqedoni

Rr. Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25
Shkup / Maqedoni
+389 71 956 271

Zyra e përfaqësimit Kosovë:

Rr. Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin
Prizren / Kosovë
Tel: +381 29 222 795
Fax: +381 29 222 797
+377 4411 98 48

Çmimi:

Shqipëri: 150 Lekë
Abonim (një vjetor): 1500 Lekë
Kosovë: 1 Euro
Abonim (një vjetor): 10 Euro
Maqedoni: 60 DEN
Abonim (një vjetor): 720 DEN
Europë: 2 Euro
Abonim (një vjetor): 24 Euro

BESIMI DHE VENDOSMËRIA NË RRUGËN E DREJTË (istikamet)

Ahmet Jashgetiren

Sufjan ibn Abdullah (r.a.), rrëfen:

I thashë profetit:

- O i dërguari i Allahut! Më mëso ndonjë gjë në lidhje me Islamin që të më mjaftojë dhe të mos kem nevojë të pyes kënd tjetër në lidhje me këtë çështje.

I dërguari i Allahut më dha këtë përgjigje:

- Beso tek Allahu dhe qëndro i vendosur në besimin tënd. (Muslim, Iman 62, 38.)

Me këto dy fjalë, i dërguari i Allahut krijoi kornizën e "konsistencës së myslimanit":

- Besimi dhe **vendosmëria në rrugën e drejtë (istikamet)**.

Njëra është konsistenca e zemrës, ndërsa tjetra pleksja e modelit të jetës...

Të thuash "besova" dhe më pas të bësh përpara në këtë "rrugë" pa dalë prej saj, pa bërë zikzake, pa u lëkundur, të bësh para me saktësi...

Deri në xhenet.

Ky është udhëtimi i myslimanit.

Ky udhëtim është shprehur në mënyrën më përmbledhëse në bashkimin e fjalëve "udha e drejtë" (sirati mustekim) dhe është shndërruar në skeletin kryesor të përmbajtjes së kulturës islame.

Sirat: udhë.

Mustekim: e drejtë.

Sirati Mustekim: udha e drejtë.

Udha e drejtë është shndërruar në një tipar të atillë për myslimanin, saqë ai ndjen çdo çast domosdoshmërinë e pushtimit nga ndjeshmëria për të qenë përherë në këtë udhë.

Kjo rrugë i është treguar myslimanit nga vetë Allahu, nëpërmjet Kuranit dhe praktikës së të dërguarit të Allahut.


Namazi është shpirti i jetës së myslimanit. Pa namaz, jeta e myslimanit nuk ka shpirt.

Në çdo namaz, myslimani pasi dëshmon besimin e tij në një Zot, me fjalët: "**Vetëm ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë**", më pas i lutet Zotit me fjalët: "**Na udhëzo në rrugën e drejtë.**"

Në këtë sure është treguar edhe kuptimi i kësaj rruge, duke përmendur atë që është e rëndësishme dhe duke lënë pa përmendur atë që nuk është e nevojshme të përmendet në këtë rast:

- Rruga e atyre që u janë dhuruar begati, nuk është rruga e tyre që meritojnë dënimin e Zotit.

Pra udha nuk është një udhë e re. Në atë rrugë kanë kaluar të tjerë më përpara, kanë pasur përvojën e tyre.



“Mos shkoni rrugëve të tjera që ju shmangin nga rruga e Tij. Kështu ju porosit Ai, për t’ju ruajtur nga të këqijat.”

(Enam, 153)

Disa kanë merituar begatitë, pasi i kanë dhënë hakun asaj rruge, ndërsa të tjerët kanë merituar zemërimin hyjnor, sepse kanë dalë nga ajo udhë e drejtë.

Kur lexojmë fjalën e të Plotfuqishmit, që zotëron dijen e të gjitha kohëve, shohim se aty është treguar edhe për *“ata që kanë merituar begatitë”* edhe për ata që *“kanë merituar dënimin hyjnor”*...

Në ajetin 49 të sures Nisa, kur numërohen njerëzit *“të cilëve Allahu u ka dhuruar begati”*, përmenden *“profetët, besnikët ndaj Zotit, dëshmorët në rrugën e Zotit dhe njerëzit e mirë”* dhe bëhet e qartë se *“ata që janë në rrugë të drejtë”* kanë për të qenë bashkë me ta.

Pra situata është shumë e qartë dhe nuk ka vend për mjegull.

Dihet shumë mirë se ku të shpie në fund fare, udha e drejtë që ndjek udhëtari.

Pasi rruga e drejtë, ashtu siç na e thotë vetë Kurani, është udha që të shpie drejt e te Zoti i Gjithësisë.

“Kjo është rruga Ime e drejtë; prandaj ndiqeni.”
(Enam, 153)

Në ajetin 41, të sures Hixhr, Allahu i Lartësuar i del dhe një herë për zot *“rrugës”* që të shpie tek Ai:

“Allahu tha: Kjo është rruga Ime e drejtë.”

Pra *“takimi”* (vuslat) do të realizohet duke ecur përgjatë kësaj rruge.

Në ajetet 52 dhe 53 të sures Shura, Krijuesi tregon rreth udhërrëfimit të Profetit Muhamed (a.s.), për në rrugën e drejtë:

“Nuk ka dyshim se ti i shpie në rrugën e drejtë, në rrugën e Allahut.”

Pra, kapu pas atij profeti dhe rruga jote do të jetë e drejtë!

Më pas në Kuran, besimtarët paralajmërohen të mos shkojnë rrugëve të tjera, sepse, kur njeriu tregon interes ndaj këtyre rrugëve, atëherë lind rreziku i *“largimit nga rruga e Allahut!”* Ja se çfarë thuhet në ajetin fisnik:


“Mos shkoni rrugëve të tjera që ju shmangin nga rruga e Tij. Kështu ju porosit Ai, për t’ju ruajtur nga të këqijat.” (Enam, 153)

Mjafton vetëm fakti se njeriu ka një *“armik”*, të cilit i është dhënë mundësia që të ngre kurthe kundër *“rrugës së drejtë”*. Shejtani që është betuar me këto fjalë:

“Unë do t’u zë pritë njerëzve në rrugën Tënde të drejtë.” (Araf, 16)

“...Unë do t’u zbukuroj atyre (njerëzve) rrugën e gabuar në Tokë dhe të gjithë do t’i shpie në mashtrim.” (Hixhr, 39)

Udhëtimi ka rrezikun që të ndesheni me hajdutë rrugësh, që kanë për qëllim ta bëjnë devijimin të duket interesante për zemrat.



*“Pa dyshim, ata që thonë:
“Zoti ynë është Allahu!” dhe pastaj
qëndrojnë në rrugën e drejtë,
nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar
e as për t’u dëshpëruar (kur t’u
vijë vdekja). Ata do të jenë banorë
të xhenetit, ku do të qëndrojnë
përgjithmonë, si shpërblim
për atë që kanë punuar.”*

(Ahkaf, 13-14)

Atje “njerëzit e sinqertë në fe”, pra ata që dëgjojnë zërin e zemrës, që nuk përkulen para vështirësive, që nuk e lejojnë shpirtin e tyre të shkojë sa andej-kënde, që i mbeten besnikë rrugës së drejtë kanë për t’u shpëtuar kurtheve të shejtanit, kanë për ta fituar provimin e kësaj jete dhe do të mbërrijnë në stadin e dëshiruar.

Ky nuk është aspak një udhëtim i lehtë.

Kur vetë profeti Muhamed, i cili gjatë gjithë jetës së tij ka qenë i mbrojtur nga gjynahet flet aq shumë, na tregon se “provimi i qëndrimit në rrugën e drejtë” është i vështirë, çdo besimtar duhet të ndalë një çast dhe të përipiqet me sa të mundet që të përmirësojë jetën e tij.

- Mua më plakën surja Hud dhe vëllezërit e saj. Ato mi zbardhën flokët.

Suret, që profeti Muhamed i cilësoi si “vëllezërit e sures Hud”, janë suret:

- Vakia, Hakka, Mearixh, Murselat, Nebe, Tekvir ve Kariat...

Përgjegjësia për të cilën flet profeti Muhamed se ia ka zbardhur flokët, është ajeti i sures Hud **“Festekim, kema umirte – Qëndro në rrugën e drejtë, ashtu siç të kam urdhëruar!”** (Hud, 112.) Komentatorët e Kuranit shprehin se “suret vëllezër të sures Hud”, flasin rreth çështjeve si kiameti, mahsheri dhe ahireti, të cilat bënë që profetit t’i zbardheshin flokët.

Kjo do të thotë se, atëherë kur përgjegjësia e “të qenit në rrugën e drejtë” perceptohet në një masë të afërt me përpikmërinë e të dërguarit të Allahut, për të cilin Allahu urdhëron dhe thotë se **“Ti, o Muhamed, je në rrugën e drejtë”** (Jasin, 4.), kjo gjë do të hapë rrugën drejt përjetimit shpirtëror të përgjegjësisë së madhe që rëndon mbi ne.

Vallë, kur e lexojmë Kuranin, çfarë gjejmë në të në lidhje me natyrën e “rrugës së drejtë”.

Aty gjejmë një kornizë të tillë të përgjithshme.

1. Ndërgjegjësimi se Allahu është “Zoti i botëve” dhe përmbushja e detyrave tona ndaj Tij si robër të Zotit.

“Me të vërtetë, Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj, andaj adhurojeni Atë. Kjo është rruga e drejtë!” (Ali Imran 51, Merjem 36, Zuhruf 64.)

2. Të jesh i lidhur fort pas Allahut.

“Kush mbahet fort pas (fesë së) Allahut, sigurisht që është i drejtuar në udhë të mbarë.” (Ali Imran, 101.)

3. Feja e dëlirë e Ibrahimit, që qëndronte i palëkundur në këtë besim dhe nuk i kishte adhuruar asnjëherë idhujt.

“Thuaj: “Me të vërtetë, Zoti im më ka udhëzuar në rrugë të drejtë, në fenë e vërtetë, fenë e pastër të Ibrahimit besimplotë, i cili nuk ka qenë adhurues i idhujve”. (Enam, 161)

Në Kuran na mësohet se qëllimi final i “rrugës së drejtë” është “të gëzosh begatinë e madhe”, të cilën Allahu e ka shprehur shumë qartë në Kuranin fisnik. Vlerësojeni në mënyrë sa më të hollë këtë gosti hyjnore që gjendet në ajetet e Kuranit, sikur të ishit duke e shijuar që tani atë lumturi të vërtetë:

“Me të vërtetë, atyre që thonë: “Zoti ynë është Allahu”, e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t’u zbresin engjëjt (para vdekjes) e do t’u thonë: “Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni xhenetit që ju është premtuar. Ne jemi mbrojtësit tuaj në jetën e kësaj bote dhe në botën tjetër. Atje do të keni çfarë t’ju dëshirojë zemra dhe çfarë të kërkon, dhuratë e pasur prej një Zoti Falës dhe Mëshirëplotë.” (Fusilet, 30-32)

Në qoftë se flokët e kokës do tu zbardhen në këtë jetë, për shkak të ndjeshmërisë suaj në jeni apo jo “në rrugën e drejtë”, atëherë të jeni të sigurtë se jeni “pa frikë” në rrugën që të shpie drejt botës së përhershme.

“Pa dyshim, ata që thonë: “Zoti ynë është Allahu!” dhe pastaj qëndrojnë në rrugën e drejtë, nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar e as për t’u dëshpëruar (kur t’u vijë vdekja). Ata do të jenë banorë të xhenetit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë, si shpërblim për atë që kanë punuar.” (Ahkaf, 13-14)

Ismail Hak Bursevi, në veprën e tij Ruhul bejan, na ofron një sqarim të fjalëve, veprimeve dhe jetës së zemrës rreth “të qenit në rrugën e drejtë”, duke analizuar format e ekzistencës në personalitetin e njeriut.

Je se çfarë shkruan ai:

“Të jesh në rrugën e drejtë, ka disa forma:

1. Mund të jesh në rrugën e drejtë me fjalë, me vepra dhe me zemër.

2. Mund të mos jesh në rrugë të drejtë me fjalë, por me vepra dhe me zemër. E para është më lart se e dyta.

3. Mund të jesh në rrugë të drejtë me fjalë dhe me vepra, por nuk je me zemër.

4. Mund të jesh në rrugë të drejtë me zemër dhe me fjalë, por nuk je me vepra.

5. Mund të jesh në rrugë të drejtë vetëm me fjalë dhe të mos jesh me zemër dhe me vepra.

6. Mund të jesh në rrugë të drejtë vetëm me zemër dhe të mos jesh me fjalë dhe me vepra.

7. Mund të jesh në rrugë të drejtë me vepra dhe të mos jesh me fjalë dhe me zemër. (Ruhul Bejan, c. 1, 115.)

Nuk ka dyshim se qëllimi final është “të jesh në rrugë të drejtë me zemër, me fjalë dhe me vepra”, që do të thotë të arrihet një pleksje e plotë në të gjithë shkallët e personalitetit të njeriut.

Nuk dihet nëse çdo besimtar mund të përballojë një përgjegjësi si ajo e profetit Muhamed, që “iu zbardhën flokët nga kjo përgjegjësi”, por secili e ka detyrë që të shkojë pas

gjurmëve të profetit dhe të kapet pas besnikëve të fesë dhe njerëzve të mirë në rrugën e “kapjes fort pas Allahut”.

A jemi të ndërgjegjshëm se çfarë udhe po shkojmë, cilat gjurmë po ndjekim dhe pas kujt jemi u kapur?

Kjo është pyetja kryesore.

A e ndiejmë thellë në shpirt ndjeshmërinë që të fal sureja Hud?

Në cilin vend të shkrirjes së besimit me vendosmërinë në rrugën e drejtë, ndodhet personaliteti ynë?

Kjo është pyetja.



Drita e besimit dhe e Mevludit -1-

Ma. Muhidin Ahmeti

HYRJE

Sa herë që na vjen muaji Rebiu-l-Evvel, muaji në të cilin lindi krijesa më e shkëlqyer në botë, ne duhet të gëzohemi për lindjen e tij, siç gëzohemi për lindjen e diellit pas errësirës së madhe të natës. T'i gëzohemi dritës me të cilën ai erdhi, dritë dhe pishtar që nuk do të shuhet deri sa të ketë ditë dhe natë në Dynja. Shkëlqimi i nurit të tij ndriti zemrat dhe shpirtrat e njerëzve edhe pas vdekjes dhe do t'i ndritë derisa të ketë jetë në gjithësi.

Asnjëherë si sot nuk është folur dhe shkruar mbi Muhamedin (a.s.) dhe asnjëherë si sot nuk është ndjerë një nevojë kaq e madhe që të kuptohet, të ndihet dhe të prezantohet personaliteti i Pejgamberit dhe mesazhi i tij për njerëzimin.

Kjo nuk i habit ata të cilët e dinë dhe besojnë që Muhamedi (a.s.), është mëshirë dhe gëzim për botët; që ai është i dërguari i fundit, dëshmitari, dhe sjellësi i lajmit të gëzueshëm; pishtari i pashuar dhe shembulli më i mirë; miku më i besueshëm dhe këshilltari i vazhdueshëm; mbrojtësi ynë dhe bashkudhëtari fisnik, i cili na prin në rrugën drejt qëllimit më të lartë. Nuk ka fjalë njerëzore që mund ta shprehë tërë madhësinë e njeriut dhe pejgamberit - Muhamedit (a.s.), por atë e bën fjala e Allahut: "Ti o Muhamed, je i lartë në moralin tënd".

Madhështia e Muhamedit (a.s.), nuk është në pasuri, sepse ai ishte i varfër. Nuk është as në fuqi, sepse ai ishte i dobët. Madhështia e Muhamedit (a.s.), është në modestinë e tij karshi të dobtëve, në guximin e tij përballë të fuqishmëve dhe në angazhimin e tij para miqve të sinqertë. Ai nuk është një mister, por ndikimi i tij është misterioz, sidomos mbi ata të cilët përpigën ta kundërshtojnë; ai nuk është hyjni, por porosia e tij ka fuqi hyjnore; ai nuk veçohet prej njerëzve, por mënyra e tij e jetës ishte mbinjerëzore. Vetëm ai ka mundur t'i lejojë pjesëtarët e vet që armiku t'ua mësojë shkrim-leximin; vetëm ai ka mundur t'i shndërrojë kundërshtarët e tij të përbetuar në miq të pasionuar; vetëm Muhamedi (a.s.), ka mundur të mbetet në memorien e vazhdueshme të njerëzve, të cilët nuk e kanë parë, por e ndjejnë frymën e tij dhe e prekin dorën e tij

të shpëtimit në botën që gjithnjë e më shumë po pushtohet nga errësira e imoralitetit.

Prandaj, derisa sot e kujtojmë ditëlindjen (mevludin) e Muhamedit (a.s.), të mos na rrëmbejë dëshira për ta parë figurën e tij, por për të forcuar besimin në vlerat e larta të moralit, pikërisht ashtu siç besoi dhe veproi pejgamberi Muhamed (a.s.).

A ka gjë më madhështore se bindja që në Ditën e Gjykimit do të jemi pranë Pejgamberit (a.s.), sepse, siç ka thënë ai: "Më afër meje në Ditën e Gjykimit do të jenë ata, të cilët më kanë besuar, edhe pse asnjëherë nuk më kanë parë."; a ka diçka më të vlefshme se siguria që Muhamedi (a.s.), do të jetë mbrojtës për ne në Ditën e Premtuar, atë ditë kur asgjë dhe askush nuk do të mund të na ndihmojë; as pasuria, as pushteti, as autoriteti, as fama, përveç asaj që është shkruar në librin e ruajtur të veprave tona të mira; a ka diçka më të mirë se mendimi që një ditë do të jemi nën mëshirën e Allahut, për shkak se do të jemi në shefaatin e Pejgamberit (a.s.); a ka diçka më të fuqishme në zemrën tonë se besimi të cilin e kemi trashëguar prej Pejgamberit tonë, i cili na i jep kuptim jetës dhe na shpie deri te qëllimi më i lartë.

Nuk ka asgjë më të rëndësishme se besimi ynë, që nuk jemi të vetëm në këtë botë dhe që na pret miku në botën tjetër; nuk ka asgjë më madhështore se njohja jonë që jemi në rrugën e Pejgamberit (a.s.); nuk ka gjë më të bukur se dashuria jonë ndaj Muhamedit të dashur, të cilën e ndjejmë në shpirt dhe e mbajmë në zemër; nuk ka gjë më të mirë se dëshira jonë që të jetojmë në dashurinë vëllazërore, të cilën na e dhuroi Pejgamberi ynë.

Ja përse mevludi në shtëpitë dhe xhamitë tona ka kuptim: që të zgjojë tek ne të gjitha ato mendime fisnike dhe të gjitha ato vepra të mira, të cilat e stolisin më të mirin midis njerëzve më të mirë, më të dashurin midis të dashurve të Allahut (xh. sh.) dhe më të nderuarin midis pejgamberëve të nderuar.

Përkujtimi i Muhamedit (a.s.), e vazhdon besimin dhe e forcon qëllimin tonë që të jemi dhe të mbetemi si një trup dhe

një shpirt i vetëm në luftë për të drejtat dhe lirinë tonë.

ORGANIZIMI I CEREMONIVE DHE MANIFESTIMEVE NË DITËN E LINDJES SË PEJGAMBERIT (A.S.)

Që nga kohët e lashta, te të gjitha bashkësitë ekzistonte tradita që solemnisht të shënoheshin datat e rëndësishme nga e kaluara, siç janë lindja e heronjve, të cilët me veprën dhe jetën e tyre lanë gjurmë të thella në histori dhe ndikim të dukshëm për të kaluarën dhe të ardhmen e tyre. Duke shënuar kujtimin për ta, ato bashkësi, në realitet, shprehnin falënderim, respekt dhe admirim ndaj atyre njerëzve dhe njëkohësisht edhe gatishmëri për ta vazhduar veprën e tyre.

Muslimanët në mbarë botën, e konsiderojnë ardhjen e të dërguarit të Allahut (a.s.), si mëshirën më të madhe të Allahut (xh.sh.), për njerëzit. **“Ne të kemi dërguar, padyshim, vetëm si mëshirë për botët”** (Enbija, 107), andaj ditëlindjen e tij e shënojnë në mënyrë të përshtatshme me të dhe mësimet, të cilat ua komunikoi njerëzve nga Allahu (xh.sh.)

Për këtë temë, autori i veprës “Sejjiduna Resulullah”, Abdullah Siraxhuddin, thotë: “Është normale që secili besimtar i vërtetë, që është i mençur, do t’i gëzohet ditës në të cilën lindi Pejgamberi i Allahut (a.s.). Ditës në të cilën filloi nuri i udhëzimit dhe i diturisë për gjithë botën. Ditës, në të cilën lindi ai, për të cilin Allahu (xh.sh.), thotë: **“Të kemi dërguar vetëm si mëshirë për gjithë botët.”** Prandaj, le ta shënojë atë ditë secili musliman dhe le të jetë i gëzuar dhe fisnik.

Organizimi i manifestimeve të tilla, në të cilat do të këndohen fragmente nga sire-ja (jetëshkrimi) i Muhamedit (a.s.), ku, përveç të tjerash do të citohen ajete kurane, pastaj do të përmendet nderi dhe kujdesi që Allahu tregoi ndaj Pejgamberit të tij, pastaj ruajtja dhe mbrojtja, të cilën Ai ia ofroi atij. Në ato manifestime flitet edhe mbi moralin e Pejgamberit dhe cilësitë e tij. Një hapësirë e konsiderueshme në përmbajtjen e mevludit i kushtohet temës së Mi’raxhit të Pejgamberit (a.s.), - një ndër temat më frymëzuese, jo vetëm për poetët muslimanë, por edhe për ata jomuslimanë perëndimorë. (Shën. ynë). Aty gjithashtu këndohen salavate dhe selame për Pejgamberin (a.s.), ilahi dhe kaside – poema kushtuar Resulullahut (a.s.), si dhe lutje dhe dua që i drejtohen Allahut (xh.sh.).

Secila prej gjërave të lartpërmendura është mbështetur në shariat, e dëshiruar dhe e kërkuar dhe që të gjitha ato janë veprime, përmes të cilave i afrohem Allahut (xh.sh.) dhe që për të gjitha ka shpërblime të caktuara. Të këtij mendimi janë dijetarët islamë të zgjedhur dhe me vlera të pakontestueshme, si dhe njerëz të devotshëm e të ditur të umetit të Muhamedit (a.s.). (Sejjiduna Resulullah, fq. 473)

Kur është fjala për të kuptuarit e mevludit të shqiptarët në përgjithësi, duhet të kemi parasysh një gjë. Muslimanët nuk e kuptojnë mevludin si lindje (vetëm) në kuptimin biologjik të një personi të caktuar, në rastin konkret të Pejgamberit (a.s.). Më parë do të thuhej që kjo është një lindje e një fryme

të re, ardhja e një kohe të re, shkëputje nga besimi i vjetër. Muslimani çdo mevlud e përjeton pikërisht në mënyrë të tillë, duke e kthyer atë në burim dhe origjinë, që shpesh harrohet në vorbullat e këtij Ballkani kodrinor.

Në të kaluarën e popujve muslimanë, e në veçanti në trevat tona shqiptare, në mënyrë tradicionale mevludi ishte rast për t’u njohur më për së afërmi me jetën dhe biografinë e Muhamedit (a.s.) e në rastin konkret tek shqiptarët, ai luajti një rol jashtëzakonisht të madh, sepse edhe përmbajtja e tij ishte plot me gjëra të pëlqyera, si: leximi i Kuranit, dërgimi i salavateve mbi Muhamedin, recitimi i poezive për të, shpjegimi për moralin e tij, dhënia e ushqimit për të pranishmit etj., të gjitha këto në suaza të së lejuarës.

Mevludi, pra, është një kornizë në të cilën janë mbledhur shqiptarët dhe e kanë përkujtuar Pejgamberin e tyre në dritën e rolit të tij tashmë të theksuar sa herë, rol i cili ka reflektuar si në të kaluarën, në të tashmen dhe në të ardhmen. Kështu, është e njohur që shqiptarët ngjarjet e tyre më të rëndësishme i kanë shënuar me mevlud, transferimi në shtëpi të re, përfundimi i mirë i ndonjë pune, ceremonia e martesës, synetisë, lindja e fëmijës e madje edhe vdekjen e të afërmeve e kanë përkujtuar me mevlud, etj.

Nëse e shikojmë njohjen e identitetit islam shqiptar në Kosovë, gjejmë që mevludi paraqet një nga simbolet e identitetit tonë fetar, simbol i përkatësisë së një bashkësie në këto hapësira. Secili prej nesh i mban në kujtesë vargjet e recituarra nëpër mevlude. Në veshët tanë akoma jehon muzikaliteti i ilahive, kasideve dhe vargjeve të mevludit, që organizohej nëpër shtëpitë dhe xhamitë e mëhallave tona.

Është tjetër pyetje të kuptuarit e traditës nga pikëpamja tradicionale. Natyrisht se duhet të

nënvizojmë që kjo nuk është pjesë rituale e besimit (ibadet), sepse ibadetet i jep Ligdhënesi, Allahu (xh.sh.), por ajo është gjithsesi pjesë e traditës, e cila ka pasur dhe ka rol specifik për shqiptarët në Kosovë e gjetiu.

Ata që lehtësisht marrin të drejtën t’i hedhin poshtë mendimet dhe pikëpamjet e të tjerëve ndaj traditës, duhet ta kuptojnë që vetëm një pikëpamje apo një interpretim nuk i jep porosinë atributin e universalitetit, aplikimit në çdo kohë dhe hapësirë. Mevludi nuk është ibadet i cili hap dyert e xhennetit, por është një rast dhe mundësi për t’u mbledhur, afruar dhe përkujtuar Pejgamberin (a.s.).

Nëse e kuptojmë mevludin në këtë kontekst, me siguri që do ta kuptojmë më mirë porosinë e Pejgamberit në vendin tonë.

Kur është fjala për mevludin, përsëri duhet të kemi parasysh dy gjëra: një gjë është mevludi si tekst – poemë, që këndohet me rastin e përkujtimit të lindjes së Muhamedit (a.s.) dhe diçka tjetër është solemniteti, privat apo publik, me rastin e të cilit tubohen njerëzit që të jenë prezentë aty, duke dëgjuar dhe kënduar vargje të zgjedhura të mevludit, duke diskutuar për probleme të ndryshme fetare, duke u njohur më mirë reciprokisht dhe duke u afruar shpirtërisht me njëri tjetrin.



Personalisht mendoj se mevludi nuk duhet kuptuar vetëm si këndim i tekstit, vargjeve të shkruara mbi jetën dhe biografinë (sirën) e Resulullahut, por si një formë organizimi që përbëhet nga më shumë elemente dhe aktivitete. Mevludi ka emër të madh, i cili është përhapur dhe kultivuar shekuj me radhë në botën myslimane në përgjithësi, por edhe te ne shqiptarët në veçanti. Mevluet familjare kanë luajtur rol të dyfishtë në shoqërinë shqiptare, duke ruajtur njëkohësisht edhe gjuhën tonë amtare edhe traditën tonë fetare islame. Shpesh ai ishte e vetmja lidhje e myslimanit me islamin. Shumë imamë dhe hoxhallarë, sidomos gjatë kohës së komunizmit, në mevluet familjare kanë shpalosur dhe shpjeguar shumë çështje fetare, gjë të cilën nuk kanë mundur dhe nuk kanë guxuar ta bëjnë nëpër xhamitë e tyre. Dhe kjo për arsyen e thjeshtë se në xhami ka qenë rrethi më i gjerë, i përbërë nga njerëz të panjohur dhe të pakontrolluar, të cilët kanë mundur të denoncojnë imamin për politizimin e fesë dhe përdorimin e saj kundër ideologjisë moniste që ishte atëherë në fuqi, si dhe indoktrinimin e popullatës myslimane. Ndonëse emri i mevludit është shumë i përhapur në masat e gjera myslimane, megjithatë ne nuk duhet të mbetemi vetëm tek emri dhe të vetëkënaqemi me pjesën sipërfaqësore të tij. Gjëja më e rëndësishme të organizimi i mevludit (qoftë ai familjar apo publik-manifestiv), është strukturimi programor dhe përmbajtjesor i tij, si dhe amortizimi final i burimeve dhe potencialeve njerëzore, përmes një strategjie të qartë për një vizion të dakorduar. Përpjekje të këtilla do ta shndërronin mevludin në një mjet të fuqishëm, një mundësi më tepër dhe një shans të mirë për përcjelljen dhe transmetimin e mesazhit universal të Pejgamberit të islamit (a.s.). Nga kjo kuptojmë se mevludi si i tillë, nuk është qëllim por mjet për të realizuar objektivat madhore të islamit dhe myslimanëve në kohën e sotme të globalizmit. Ai është një nga alternativat e komunikimit masiv me njerëzit, për vetëdijësimin dhe sensibilizimin e tyre për të vërtetat e islamit, në kohën kur ato po shtrembërohen nga të gjitha anët, si nga myslimanët ashtu edhe nga jomyslimanët. Ai është një prej shumë formave të promovimit dhe prezantimit të vlerave universale të islamit, në kohën e vërshimit të antivlerave dhe përpjekjeve gjigande për t'i bërë ato udhë të "shpëtimit" (lexo: shkatërrimit) të njerëzimit.



Prandaj, nëse thua se mevludi është bid'at dhe veprim i ndaluar, atëherë me këtë duhet të mohosh dhe të shpallësh të ndaluar tërë revolucionin mediatic dhe teknologjinë e ngritur për të. Nuk ka dyshim se mevludi është bid'at (risi), por varet si e përdor bid'atin: e përdor për të mirë apo për të keq. Në këtë kuptim, bid'ate janë edhe gazetatat, revistat, radioja, televizori, kompjuteri, interneti etj. Pra, sikurse mevludi edhe këto janë mjete të komunikimit masiv, por me një dallim, se janë shumë më të avancuara, më të zhvilluara dhe më të sofistikuara, të cilat kanë një hapësirë jashtëzakonisht të gjerë ndikimi, që për disa sekonda përcjellin lajmin në të gjithë botën. Në fakt, po ta shikojmë çështjen nga ky prizëm, atëherë del se televizori, interneti janë mjete të cilat përdoren jashtëzakonisht keq dhe tmerrësisht në mënyrë destruktive.

Mevludi, madje fare nuk keqpërdoret. Përkundrazi... Mirëpo, është interesant se recipientët e mendimit për mevludin e ndaluar, janë ata, të cilët i përdorin këto mjete në masën më të gjerë për transmetimin e fjalës së Allahut dhe të mesazhit të Pejgamberit (a.s.). Dhe bëjnë mirë, por duhet ta bëjnë të gjithë një gjë të tillë. Dhe shtrohet pyetja: përse vallë anatemojnë përdoruesit e "bid'atit të mevludit" dhe nuk denoncojnë përdoruesit e bid'atit të internetit?

Për sa i përket çështjes debatuese se mevludi është një lloj shtese e besimit, fesë, se ai është ibadet etj., kjo nuk është e vërtetë dhe askush nuk e thotë dhe nuk e mendon një gjë të tillë. Ai nuk bën pjesë në fushën e akidës, besimit (kredos islame), as të ibadeteve, por i takon sferës së Da'vës – thirrjes në rrugën e Allahut (xh.sh.). Është një mënyrë e thirrjes në rrugën e Allahut, një mundësi e përhapjes së islamit dhe mësimave islame. Është një aktivitet dhe veprimtari e pëlqyer dhe e preferuar në punën misionare të imamit dhe të atyre që bëjnë punën e misionarit. Varet krejtësisht prej imamit përkatës se si do ta organizojë ceremoninë e mevludit. Në kohën e sotme ka shumë mënyra dhe mundësi për ta modernizuar mevludin, duke ia përshtatur kushteve, rrethanave dhe specifikave të vendit ku ai zhvillohet. Sot, si asnjëherë më parë është e nevojshme që në kuadër të mevludit apo në emër të tij, të organizohen aktivitete nga më të ndryshmet, që kanë të bëjnë me figurën dhe personalitetin e Pejgamberit të Zotit – Muhamedit (a.s.). Manifestime dhe fushata popullore në shërbim të njohjes dhe prezantimit më të mirë të figurës së Pejgamberit (a.s.), siç ndodhi në Austri, në vitin 2009. Motoja e këtij aktiviteti ishte: "Porosia e Pejgamberit (a.s.), për austriakët", që konsistonte në hadithin e njohur të Muhamedit (a.s.), lidhur me marrëdhëniet ndër-njerëzore e në mënyrë të veçantë, me fqinjët.

"Nuk është besimtar i vërtetë ai që fle në gjumë i ngopur e fqinji i tij është i uringur, dhe ky e di." Ky është mesazhi të cilin Pejgamberi Muhamed (a.s.), ia dërgon popullit austriak mysliman dhe jomysliman.

Ky hadith është shfaqur në 426 panele reklamash elektronike, të shndritshme dhe lëvizëse në rrugët e 12 qyteteve austriake.

Po ashtu, është shfaqur në ekranet informatike në 10 stacione metroshe në kryeqytetin e Austrisë, në Vjenë.

Kjo ndodhi në ditëlindjen e Pejgamberit (a.s.) dhe vazhdoi për disa ditë. Ishte një fushatë shumë e pëlqyer e myslimanëve austriakë, me të cilën ata deshën t'ua prezantojnë Pejgamberin (a.s.) dhe mësimet e tij paqësore bashkëqytetarëve të tyre.

Shkurt, himnizimet për Muhamedin (a.s.) e as "Këndimi i Mevludit" nuk janë "ibadete" fetare, por janë një traditë fisnikëruese e Islamit (paqes, dashurisë, harmonisë, jetës), në mjediset islame, që ka dhënë rezultate të mira për kultivimin e respektit ndaj Profetit të Islamit dhe të harmonisë vëllazërore midis besimtarëve në Një Zot, në përgjithësi, sepse lartësohen edhe Profetët e feve të Shpallura, paraislame.

DYZIMI I NJERIUT

Në botën e sotme, qenia mbi të cilën flitet më shumë pa asnjë lloj mëdyshjeje, është njeriu dhe vendi që zë ai në botë dhe në univers. Nga ana tjetër, njeriu është njëkohësisht edhe qenia më e sulmuar, për t'u zhbërë si njeri, si personalitet. Kjo goditje ndaj të qenësishmes së njeriut nuk mund të ndodhë spontanisht, aksidentalisht, rastësisht. Ajo çfarë po synohet sot, është shndërrimi i njeriut në shumësi kopjesh, për të përmbytur origjinalin, unin e qenësishëm. Mundësia e dyzimit të qenies njerëzore është prezente përmes procesit të formimit të një uni paralel, me unin fillestar, me unin origjinal. Ky un paralel apo pseudoun merr përsipër të luajë rolin e unit origjinal, duke prodhuar ndjesinë se njeriu është duke vepruar në përputhje me unin origjinal. Në këtë mënyrë, pseudouni ka vendosur nën kontroll veprimtarinë njerëzore, duke sfumuar, zvetënuar pothuajse tërësisht, unin autentik, unin origjinal dhe të parëhershëm. Fakti që njeriu mund të luajë shumë role, porsì një kameleon, në marrëdhëniet me të tjerët, nuk do të thotë se shumësia e roleve kapërcen unin origjinal, porse shumësia e roleve vjen si rezultat i formimit të pseudounit, që mbizotëron veprimtarinë e këtij njeriu, duke e kameleonizuar. Pavarësisht kësaj situate, ku uni është i mbytur nga pseudouni, uni fillestar është aty, i struktur nga stuhia e pseudounit, që në një situatë të çfarëdollojshme të fillojë të rilulëzojë, duke u ridimensionuar sipas atyre ndjesive fillestare, origjinale, autentike, që kanë qenë të ndrydhura, për shkak se kanë qenë nën trysinë e pseudounit, që më shumë sesa për respektimin e origjinalitetit të unit fillestar, merakoset për konformizmin, përshtatjen, me shpresën se duke u konformizuar, nuk do të konfrotohet me pjesën tjetër të shoqërisë, paçka se humbet origjinalitetin dhe rrezikon anonimatën, madje këto të fundit janë të parapëlqyerat e pseudounit. Duke u dyzuar dhe nën trysinë e pseudounit, humbet sigurinë në vetvete, gjykimin e shëndoshë, sepse tashmë nuk është më vetvetja, edhe pse mund të kujtojë se është vetvetja. Meqë më shumë se sa për origjinalitetin e unit, shqetësohet për atë se çfarë të tjerët kërkojnë të shfaqë, ndihet krejtësisht i zhgënjyer dhe i pasigurt në personalitetin e tij, sepse forca e të tjerëve, e modelit sundues të shumicës është më e fortë se forca e personalitetit të ndërtuar mbi pseudounin. Pamundësia për të dalë në kundërrymë, paçka se të tjerët janë aty, e bën të ndihet konfuz, i paqartë, madje dhe i depresionuar shpeshherë dhe konformiteti e përshtatshmëria duket sikur e qetësojnë, por nuk mund

t'ia largojnë dobësinë e paqëndrueshmërisë së personalitetit të sunduar nga pseudouni. Ky njeri i konformuar dhe i përshtatur ndaj modelit sundues të shumicës, nuk jeton më për veten, por jeton për të tjerët. Personaliteti i tij nuk formohet përmes përpjekjeve për të ruajtur origjinalitetin njerëzor, përmes njohjes së qenies së tij, por formohet ashtu si të tjerët dëshirojnë të formohet. Fjalët, sjellja, veprimet e tij nuk mund të jetësohen pa marrë më parë miratimin e të tjerëve, qoftë edhe përmes heshtjes, sepse nuk gjen dot forcë në vetvete për të thyer akullin me emërtimin "modeli sundues i shumicës", që akullzon personalitetin e tij. Përshtatshmëria ndaj modelit sundues të shumicës, konsiderohet si e vetmja kurë për të qenë "i qetë", nga shigjetimet, etiketimet e kësaj shumice, që nuk mund ta gëlltisë dot faktin se dikush prej qenieve njerëzore qenka rebeluar ndaj modelit sundues, duke ndjekur një model kryekëput të ndryshëm, madje të mospërputhshëm dhe krejtësisht kundërvënës në thelbin e vet, ndaj modelit sundues. I gjendur në një sipërmarrje të kësaj natyre, fare e panatyrshme për shumicën e të tokësorizuarve, nuk mund të përjashtohen edhe epitete stigmatizuese ndaj kësaj qenieje. Paçka situatës në të cilën kjo qenie gjendet dhe jo pa urtësi, dritësimi që buron nga parimet e epërme dhe shkakësitë parake e mëkojnë pandalshëm dhe, pikërisht ky dritësim që formëson personalitetin e qenies njerëzore, është e vetmja forcë që mund të thyejë akullin e modelit sundues të shumicës. Ashtu sikundërse modeli sundues manifeston vetveten, ashtu edhe qenia rebeluese ndaj këtij modeli ka të drejtë ta manifestojë vetveten në origjinalitetin e vet, sepse ky nuk është manifestim i vetë-reklamimit në kufijtë e vetvetes, por manifestim i fuqisë së të vërtetës nëpërmjet qenies njerëzore. Në rast se nuk do të kemi personalitete të ndërtuara sipas parimeve të së vërtetës, tjetërsimi, depersonalizimi dhe tëhuajësimi do t'i shfaqen këtij njeriu si "vlerat" që janë të domosdoshme për të "qenë" vetvetja. Kjo është logjika e pamundësisë së shkëputjes nga grupi, masa, turma, ku njeriu nuk është më njeri, por grup, turmë, masë, kategori, tek të cilat shkarkon dhe përgjegjësinë personale për zgjedhjet e tij, pavarësisht se zgjedh mbi dëshirën e të tjerëve, sepse personaliteti i tij anonim projektohet tek masa dhe turma. Kështu humbet dhe shkrihet personaliteti njerëzor, si nisja në oqean, shkrihe prej së cilës humbet dramën e të qenit njeri, humbet atë çfarë në të vërtetë e bën të jetë njeri, lirinë.

Islami vendos lidhjen mes fesë dhe shkencës, religjionit dhe politikës, xhamisë dhe shkollës, tokës dhe qiellit, dynjasë dhe ahiretit, trupit dhe shpirtit, arsyes dhe besimit, idesë dhe praktikës, besimit dhe shehadetit.

Islami, fe dhe shtet

Ajni Sinani

Të shkruash për Islamin si fe dhe shtet (din ve devle) nuk është fare e thjeshtë. Kjo për faktin se një pjesë e myslimanëve kanë rënë nën ndikimin e jash-tëm që i ka tronditur seriozisht konceptet themelore, diku duke i modifikuar e diku duke i nxjerrë jashtë përdorimit. Shteti shekullarist është shfaqur shekujt e fundit si përgjigje ndaj dominimit të Kishës dhe luftimeve fetare në Evropë, të cilat e kishin shkatërruar atë për dekada. Këto lufta që kishin shkaktuar shumë viktima, duke shkretuar një pjesë të konsiderueshme të Evropës së asaj kohe, kishin ndikuar që shteti dhe kisha të mbaheshin në distancë.

Mirëpo feja, sipas Islamit, nuk duhet të reduktohet vetëm në rrafshin shpirtëror, duke e përjashtuar veten nga politika dhe jeta e përditshme, pasi kjo do të rezultonte me abstenimin dhe heqjen dorë nga aktualiteti dhe realiteti i botës. Bota islame, e gjetur përballë trysnive të shumta nga jashtë, si dhe për shkak të trazirave të brendshme, si rezultat i dekadencës së saj dhe i mosudhëheqjes efikase dhe, qysh më herët, si rezultat i ndarjes së dijeve në dije fetare dhe profane, është kapluar nga ndjenja e hutimit. Ajo çka e karakterizoi periudhën e shekullit XX dhe këtej, është shpartallimi i sundimit të shtetit universal islamik dhe imponimi i dominimit të konceptit evropian të shtetit kombëtar dhe në shumë vende myslimane edhe i konceptit të sistemit evropian në politikë dhe ekonomi.[1]

Andaj, shqyrtimi i këtij raporti në islam është edhe më i vështirë, pasi koncepti i përgjithshëm modern rreth kësaj çështjeje është mjaft i ndjeshëm, për faktin se Perëndimi i sheh konceptet e veta si të aplikueshme për të gjithë. Njeriu ka nevojë për religjionin që është politikë dhe për një politikë që është etikë.[2] Pikërisht për këtë, Islami është fe në të cilën nuk ka hendeqe dhe ndarje artificiale mes besimit dhe shkencës, prandaj ai ka vendosur lidhjen mes aktivitetit shpirtëror dhe atij fizik, punës dhe adhurimit, si dhe mes përparimit material dhe shpirtëror.[3]

RELIGJIONI

Islami imiton shembullin, sipas të cilit Zoti qeveris mbretërinë e Tij. Ai është një imitim i rendit kozmik, i manifestuar këtu në këtë jetë njerëzore si një rend shoqëror dhe politik.[4] Islami nuk është religjion[5] por Fe (Din), që ngërthen të gjitha aspektet e jetës së njerëzimit, sikurse janë: aspektet politike, sociale, ekonomike, juridike apo ushtarake. Religjioni nuk duhet të konsiderojë se do të jetë aq më religjion, sa më shumë ta mohojë politikën dhe forcën.[6] Të largosh politikën dhe ekonominë nga ndikimi i fesë dhe të abstenosh e të heqësh dorë nga kjo botë në emër të religjionit dhe metafizikës së tij, do të thotë dalje nga bota reale në botën e utopisë.

Pikërisht për këtë, në Islam gjejmë inkorporimin e këtyre dy elementeve. Islami nuk mund ta pranojë shekullarizmin dhe as shekullarizmi nuk mund ta gjejë vendin në gjirin e Islamit. Alternativa e shekullarizmit do t'i shkaktonte pasoja katastrofale Islamit dhe do ta shpinte drejt vdekjes. Kjo, ngase Islami pa ligjin e tij, Sheriatin, nuk do të ishte i plotë, por i cunguar, gjysmak, nuk do të ishte Din-i, feja që ka shpallur i Gjithëdituri, sikurse e gjejmë në Kurandin Famëlartë.

Shkëputja e Islamit nga realiteti dhe aktiviteti i gjithëmbarshtëm i njeriut dhe mospërfillja e moszbatimi

i Ligjit të tij, do të ishte blasfemi. Sepse vetëm Zoti është Krijuesi, Zotëruesi, Ligjvënësi dhe Mbizotëruesi Absolut i gjithçkaje që ekziston.[7] Andaj, të gjithë të dërguarit i kanë ftuar njerëzit që të ndërgjegjësohen e të njohin sovranitetin absolut, që i përket ekskluzivisht Allahut dhe kanë kërkuar që jetën e tyre ta jetojnë sipas modelit dhe programit të shpallur nga Zoti.[8] Në Islam, sovraniteti nuk u përket njerëzve si një popull apo si një kolektiv, por ligjit. Askush në shtetin islamik nuk “bën ligje”; vetëm Zoti. Dhe Ai veprimi kështu për herë të fundit me revelimin e Kuranit dhe ilustrimin e Pejgamberit Muhamed.

Islami si fe e shpallur, nuk kufizohet vetëm në aspektin shpirtëror, por ofron vizionin e një jete civilizuese: të një jete shoqërore të ligjit, rendit, drejtësisë dhe autoritetit. Ai është Program Hyjnor dhe Ligj i shpallur, që bën shpjegimin realist të jetës dhe përkon me natyrën njerëzore. Sheriati u shpjegon myslimanëve se si ata ta kuptojnë botën dhe jetën përmes arritjes së virtyteve, moralit, shkencës dhe forcës.

Ligji islamik përmban rregulla që përcaktojnë dhe formësojnë marrëdhëniet ose më saktë, të drejtat dhe obligimet në raportin njeri-njeri, njeri-shoqëri, njeri-naturë dhe njeri-Krijues. Në tërësinë e tij, Islami është një mendim alternativ për njerëzimin, si një sistem besimi dhe një mënyrë jetese. Ai është një vetëdije e thellë politike, sepse përshkohet nga një konceptim i përgjithshëm dhe i kompletuar mbi jetën, universin, shoqërinë, qeverisjen, dhe ndërlidhet ngushtë me politikën, ekonominë, kulturën, dhe etikën.[9]

ISLAMI BESIM DHE LIGJ (AKIDE DHE SHERIAT)

Fjala Din, që Kurani e përmend me qindra herë, nënkupton bindje ndaj vullnetit të Zotit, si në jetën e individit, ashtu edhe të bashkësisë, sepse Islami dallon nga ajo që kuptohet me fjalët religjion në Perëndim. Islami fokusohet mbi një shpjegim realist të jetës dhe mbi përhapjen e të kuptuarit të jetës në formën e saj reale, si një hyrje që përgatit rrugën për jetën e dytë. Islami nuk e mallkon këtë botë. Për myslimanin e gjithë toka është xhami, dhe kur ai nuk ka ujë, mund të pastrohet prej saj (të marrë tejmemum).

Formula: *“ata që besojnë dhe bëjnë punë të mira”* ka karakter religjioz, moral dhe shoqëror. Islami ndërthet gjithë aktivitetin dhe veprimtarinë e njeriut. Ai s’është religjion që njeriut ia ndalon të mirat e kësaj bote ose që urdhëron heqjen dorë nga kjo botë. Islami si fe (din) e shpallur, integron shpirtin dhe trupin, besimin dhe veprat, qiellin dhe tokën, dynjanë dhe ahiretin, namazin dhe zekatin, agjërimin, haxhin dhe kurbanin. Islami është Fe që e pohon jetën dhe botën, por e disiplinon ndjekjen e tyre me moralitet; dhe që i pohon vlerat e pastërtisë, besnikërisë dhe devocionit.

Islami vendos lidhjen mes fesë dhe shkencës, religjionit dhe politikës, xhamisë dhe shkollës, tokës dhe qiellit, dynjasë dhe ahiretit, trupit dhe shpirtit, arsyes dhe besimit, idesë dhe praktikës, besimit dhe shehadetit. Ai krijon një sistem, në të cilin individit nuk konsiderohet si një vegël mekanike në sistemin shoqëror, as shoqëria si një organizim i krijuar

për hir të individit. Më saktë, ai i jep secilit – individit dhe shoqërisë – të drejtat e tij dhe i siguron individit, si dinjitetin e tij shpirtëror, ashtu edhe atë material.[10]

Edhe burimet e islamit e kanë shenjë e kësaj dyjësije: Kurani dhe Hadithi, që përfaqësojnë shpalljen dhe përvojën, amëshimin dhe kohën, mendimin dhe praktikën.[11] Si program hyjnor, Islami është më pak mënyrë e mendimit, më tepër mënyrë e jetesës. Komentuesi më i mirë i Kuranit është vepra e Muhamedit (a.s.). Madje, pa një praktikim dhe jetësim, Kurani është i pakuptueshëm.

Suneti i Muhamedit plotësoi hallkën munguese midis të të menduarit dhe të bërit, midis perceptimit ideacional dhe veprimit, midis mendimit dhe jetës e historisë. Vepra e Muhamedit (a.s.), ishte jetësim i Kuranit, ndaj me plot të drejtë është thënë se Muhamedi (a.s.), ka qenë Kurani i gjallë që ka ecur mes njerëzve. Fillimi i Islamit ishte në Mekë dhe shpellën Hira, ku njëra paraqet veprimin, kurse tjetra meditimin. [12]

Më vonë do të jetë Medina. Islamit aty do ta gjejmë, jo vetëm si besim, por edhe si politikë. Medina do të shndërrohet në komunë fetare dhe shoqëria islame në komunitet politik. Në Medinë feja e fundit e shpallur njerëzimit, Islami, është manifestuar dhe jetësuar, si rezultat i të cilit jeta e njerëzve ndryshoi. Shembujt e parë historikë dhe universalë të aplikimit të Islamit, Muhamedi (a.s.), i dha në një copë vend (lokalitet), të quajtur Jethrib-Medine.[13]

Medina u mbiemërua me këtë emër, ngaqë në këtë qytet u realizua Din-i i vërtetë për njerëzimin. Atje besimtarët iu nënshtruan autoritetit dhe juridiksionit të Pejgamberit (a.s.)[14] Medina është vendi ku jetoit dhe u zhvillua tradita, praktika e Pejgamberit (a.s.). Marrëdhëniet njerëzore, jeta shoqërore, e drejta, ekonomia, politika, morali, si dhe çdo sjellje njerëzore dhe shoqërore, morën formën e vet dhe u zbatuan në Medinë, në bazë të mesazhit dhe parimeve themelore të Islamit.[15]

Mesazhi islam bëri që populli më i prapambetur i asaj kohe, me pranimin e Islamit, të bëjë një kërcim të madh drejt virtytit, humanizmit, dijes dhe urtësisë. Arabët dolën nga errësira në dritë dhe u bënë prijësit e botës së qytetëruar. Islami i disiplinoi dhe i bashkoi myslimanët përgjatë gjeneratave, shekujve dhe kontinenteve, në çdo aspekt të jetës së tyre, duke vulosur mendjet, zemrat dhe veprat e tyre me vulën e Islamit. Kështu, i konvertuari kaloi nga Koha e Gurit në kohën e dijes, shkencës dhe përparimit me një kërcim të paparë, nga miti dhe supersticioni, drejt empirizmit dhe dëshmisë racionale; nga lufta për mbijetesë individuale apo fisnore, drejt asaj të mëkëmbësisë hyjnore të historisë njerëzore.[16]

ZEMRA E ISLAMIT ËSHTË TË PERCEPTUARIT E TIJ INTEGRAL TË BOTËS

Sheriati përfshin porosi të shpallura nga Zoti, që kanë të bëjnë edhe me sferën shpirtërore edhe me sferën profane të jetës. Kurani dhe Suneti përmbajnë qindra norma dhe rregulla nga jeta e përditshme, ndër të cilat ka edhe norma që kanë të bëjnë me shtetin, politikën dhe ekonominë.

Islami nuk është i lidhur vetëm për xhami, shtëpi, treg, pallat qeveritar, për luftë e paqe, por është shkencë, politikë, punë, aktivitet, luftë-xhihad. Ai është i pandarë nga çdo aktivitet i tij, duke ia sqaruar njeriut atë që është e lejuar dhe atë që është e ndaluar.[17] Prandaj, Islami nuk është vetëm raport individual i njeriut ndaj Krijuesit, por më shumë se kaq, sepse përfshin: diturinë, besimin, shkencën, artin, moralin, drejtësinë, traditën, të gjitha aftësitë dhe shprehjet, të cilat njeriu i realizon si anëtar i shoqërisë.

Islami mbron institucionin e familjes, u përmbahet parimeve të drejtësisë, vetëmjaftueshmërisë, përgjegjësisë personale dhe kolektive, lirisë së besimit dhe mendimit, konsultimit (shuras) dhe parimit të njëshmërisë së njerëzimit në aspektet e origjinës së tij, interesave dhe fatit të tij.[18]

Myslimanët nuk janë të përkryer, por ata pranojnë porosinë nga i Përkryeri. Ne, natyrisht nuk mund të arrijmë përsosmërinë, por për këtë na drejtohet i Përkryer, duke na dëftuar rrugët më të mira. Çdo injorim i Rrugës së Vërtetë (Siratul mustekim) do të na kushtojë humbje katastrofike dhe shkatërrime të mëdha.[19]

PROMOTORËT E PRIVATIZIMIT TË RELIGJIONIT

Në rastin e Islamit duhet parë, mes të tjerash, se çështja e raportit mes fesë dhe politikës nuk është identike, sikurse raporti i kishës dhe religjionit. Nëse këtij dallimi nuk i kushtohet kujdes, mund të arrihen disa konfuzione, si në planin teorik, ashtu edhe në atë praktik. Filozofia perëndimore në tërësi, mohon ekzistencën e zgjidhjes me anë të Shpalljes dhe Urtësisë së Zotit. Njeriun perëndimor e kanë mësuar se privatisht mund të jetë i krishterë, kurse si njeri publik, afarist dhe politikan, mund të jetë edhe makiavelist. Çështja e fesë është çështje individuale e individit dhe, sipas Krishtërit, kisha kultivon shpirtin, kurse shteti sundon trupin, sipas thënies: "Zotit hyjnore, mbretit mbretëroren." [20]

Këtij pasazhi biblik, Islami i përgjigjet me parullën "Din ve devle" (Islami "fe dhe shtet"). Sepse e gjithë shpallja kuranore është gjithëpërfshirëse, meqenëse ajo e zotëron individin dhe shoqërinë me tërësinë e tij.

Pra, ndryshe nga Krishtërimi, Islami kërkon që të formojë një shoqëri të mirëfilltë islame, që udhëhiqet nga parimet fetare dhe morale dhe, meqenëse ndryshimet shoqërore nuk krijohen në vakuum, por nëpërmjet transformimit të shoqërisë, pikërisht për këtë arsye raporti i Islamit me politikën është i lidhur ngushtë dhe i pandashëm. Ai kërkon nga myslimanët që ta organizojnë veten në mënyrë kolektive, që të vendosin një sistem, që të rregullojë marrëdhëniet ndërnjerëzore, që t'i gjykojë konfliktet me drejtësi dhe paanësi, dhe që të vërë në jetë synimin e Zotit në botë dhe në histori.[21]

Me integrimin e tij politik (religjioni si fe dhe si shtet - din ve devle), Islami rrënon nocionin eurocentrik dhe atë shekullar të religjionit, të cilin Perëndimi e konsideron të aplikueshëm për të gjithë.[22] Ka pohime të gabuara, sipas të cilave: "Zoti dëshiroi që Islami të jetë religjion, njerëzit me atë bënë politikë!" Ndërkaq për myslimanët, religjioni

dhe politika nuk janë as të kundërta dhe as të ndara.[23]

Ka prej myslimanëve që gjërat i shohin nga prizmi nacionalist dhe, nëse rregullat e fesë, udhëzimet e religjionit dhe parimet e kulturës do t'u shërbenin qëllimeve të nacionalizmit, nacionalisti do ta mbështeste religjionin e vet me shumë dëshirë e, nëse këto parime bien ndesh me nacionalizmin, ai nuk do ta pranonte fenë e vet, por do të gjente e do të pranonte parime dhe teori të tjera.[24]

Mirëpo, duhet të jetë e qartë se Islami kërkon që shoqëria të organizohet në parimet moralo-etike e juridike që ofron ai, nëpërmjet krijimit të sistemit politik, ekonomik dhe juridik-shtetëror, që do të përcaktonte vetëdijen fetare, shoqërore dhe pse jo edhe atë kombëtare të saj.[25] Islami dhe Krishtërimi nuk janë dalluar gati për 1200 vjet në aspektin e veprimtarisë dhe ndikimit të tyre tek ithtarët e vet. Pasi mbreti Konstantin e mori timonin e Perandorisë Romake, në shek. IV, religjioni i krishterë u bë religjion shtetëror, ashtu sikurse është edhe në kohët më të reja në vendet ortodokse të Evropës Juglindore.

Ishin Reformacioni dhe Iluminizmi që luftuan ndikimin e Kishës dhe bënë ndarjen e fesë nga shteti. Mirëpo edhe përkundër faktit se në Evropë kemi ndarjen e shtetit nga religjioni, megjithatë, sikurse thotë Murad Hofmann, në Gjermani prapëseprapë gjenden festa fetare që i mbron shteti, mbledhet tatim për Kishën, mbahet mësim fetar në shkollat shtetërore dhe mësuesit fetarë paguhen nga buxheti shtetëror. Në gjyq dhe në ushtri betimi bëhet në Zot, ashtu sikurse titullohet edhe Kushtetuta Federale. Në ushtri janë të punësuar edhe priftërinj ushtarakë, në muret e shkollave qëndrojnë të varur kryqet. Dhe këtë gjë gjermanët me të drejtë nuk e ndjejnë si obskurantizëm mesjetar.[26]

Nëse kështu qëndron gjendja në shumë shtete perëndimore duke përfshirë edhe SHBA-të, që sipas Eduard Seidit është vendi që më së shumti merret me fe, atëherë pse Islami të akuzohet si luftëtar dhe mbrojtës i idesë për shtet fetar? Islami nuk kërkon asgjë tjetër veçse shtetin e këtij lloji, ku religjioni dhe politika, religjioni dhe ekonomia, religjioni dhe shoqëria të jenë afër njëra-tjetrës dhe të ndërldhura mes tyre.

Myslimanët e të gjitha vendeve e kanë pranuar shtetin islamik si të domosdoshëm për Islamin dhe e kanë kuptuar përligjjen e tij si të bazuar në Sheriat. Juristët islamë vënë në dukje se kërkohet që seksionet dhe klauzolat e shumta të Ligjit, të mbështeten dhe të zbatohen nga shteti.[27] Pa shtetin, konkludojnë ata, këto segmente të Sheriatit nuk do të respektoheshin, një mungesë që dënohet qartë nga Kurani si e barabartë me braktisjen e të tërë religjionit dhe prej këtu, që rezulton në apostazi: "**... E kush nuk gjykon me atë që e zbriti Allahu, ai është mohues.**" (El Maide: 44.; "**... E kush nuk vendos sipas asaj që zbriti Allahu, ai është mizor (i padrejtë)**" (El Maide: 45.); "**... Ata që nuk gjykojnë sipas asaj që zbriti Allahu, janë mëkatarë të dalë jashtë rrugës së Zotit.**" (El Maide: 47.)

E drejta islame për shtetin e saj ideal nuk kërkon ndonjë formë të caktuar shtetërore. Çdo gjeneratë myslimane është

e ftuar që të gjejë për vete atë organizim shtetëror që i përgjigjet më së miri nivelit të saj zhvillimor.[28] Forma e shtetit, sikurse ajo e shtetit të parë në islam në Medinë, mund të jetë edhe republikë. Në asnjë rast e drejta islame nuk e kërkon teokracinë në kuptimin e ngushtë të fjalës, gjegjësisht sundimin e klerikëve, ngase në Islam nuk ka kler.

RËNIA E PERANDORISË OSMANE

Pa marrë parasysh se çfarë thonë për Perandorinë Osmane, ajo konsiderohet me vlera dhe qeveria e saj ka qenë me rëndësi të posaçme. Për këtë arsye, jahuditë dhe të krishterët kanë vepruar së bashku për rrëzimin e Hilafetit Osman dhe Evropa e ka copëtuar botën islame.[29] Pas rënies së Perandorisë Osmane më 1924, u arrit formimi i shteteve kombëtare myslimane, të cilave u është dhënë identiteti modern politik me parashenja të shprehura të kombëtares e në dëm të identitetit islam. Paraqitja e konceptit komb dhe raporti i kombit dhe fesë në Islam, përkrah faktorëve të tjerë, ka kontribuar në dobësimin e universalizmit islam dhe përfundimin e parohializmit kulturor islam.[30]

Duke e pasur në konsideratë tërësishtësinë e mësimin islam dhe pandashmërinë e botëkuptimit islam, këta dy tre shekujt e fundit të historisë bashkëkohore islame është paraqitur kriza e identitetit tek myslimanët, si dhe synimi dhe përpjekja e tyre për kthim nga rrënjët e islamit. Çlirimi i vendeve islame nga kolonializmi ka bërë që popujt e këtyre vendeve të kërkojnë kthimin nga Islami dhe ligji i tij, Sheriati.

Edhe pse momenti aktual i zhvillimit tonë kulturor e historik është i ngarkuar me të kaluarën e largët dhe të afërt dhe shembulli ynë si një popull me tri fe është më specifik në krahasim me disa popujt të Ballkanit, mendoj se kjo nuk paraqet problem për sa i përket ithtarëve të feve të tjera, sepse atyre Islami ua njeh, jo vetëm të drejtën e ekzistencës së tyre në një shtet mysliman, por edhe të drejtën e ushtrimit të fesë së tyre.

Shembull për këtë kemi Kushtetutën e shtetit islamik (Kartën e Medinës), që i konsideronte çifutët si një komunitet (umet) autonom brenda shtetit.[31] Ajo e pajisi gjykatën rabine me autoritet absolut për të gjykuar dhe për të vendosur për të gjitha çështjet e çifutëve. Qysh prej disfatës dhe shpërbërjes së tyre prej romakëve, kjo ishte hera e parë që ekzistenca komunale çifute dhe Ligji i Torës, u njohën si legjitimë prej ndonjë shteti. Pluralizmi i shtetit islamik ishte një pluralizëm ligjesh, një novacion i padëgjuar tjetërkund në historinë e njerëzimit. Shteti islamik i Medinës ishte një mikrokozmos i atij që duhet të jetë rendi botëror.[32]

Shteti islamik, si rrjedhim, ishte projektim dhe implementim i një rendi multireligjioz i vetë Pejgamberit, i cili mblodhi së bashku nën një rend paqeje dhe legjitimiteti myslimanët, çifutët dhe të krishterët.[33]

Historia nuk njeh kushtetutë tjetër të shkruar që ka respektuar minoritetet, sikurse i ka respektuar kushtetuta e shtetit islam. Kjo gjë është respektuar gjatë gjithë historisë islame. Mendoj se para se të hapet ndonjë diskutim serioz

për rëndësinë e lidhshmërisë së fesë dhe politikës, do të ishte me interes që të njihemi edhe me përvoja të vendeve të caktuara, ku raporti ndërmjet religjionit e politikës është i ngushtë dhe me influencë për zhvillimin e gjithëmbarshtëm dhe prosperitetin e një populli apo një vendi.

Padyshim, rreth lidhjes së ngushtë të fesë dhe politikës duhet të shkruhet më shumë. Po ashtu, mes vetë myslimanëve duhet të ekzistojë një vullnet i fortë për një dialog tolerant, dhe të tregohet gatishmëri për të ndihmuar njeri-tjetrin në tejkalimin e hendeqeve, të cilat të tjerët qëllimisht na i kanë hapur e të cilat, nga padija i kemi pranuar.

Me këtë rast dua të kujtoj se ishte pikërisht Islami si besim që ka mbrojtur identitetin tonë dhe na ka mbrojtur nga asimilimi sllavo-grek, dhe ishte Islami si ligj dhe moral që na ka mbrojtur nga destruktivitetet e ndryshme. Këtë gjë Islami mund ta bëjë edhe më tutje, por me kusht që Islami të mos kuptohet vetëm si një religjion dhe si një çështje private. Edhe pse jam i vetëdijshëm për situatën në të cilën gjendet populli ynë, mendoj se, të paktën në planin teorik, nuk duhet ta vëmë asnjëherë në pikëpyetje lidhjen e Islamit me politikën, sepse kjo është pjesë e pandashme e besimit islam. Kurse në planin praktik, duhet të punojmë që të gjitha fetë (tri fetë e njohura) të jenë zyrtare, qoftë në Shqipëri apo në Kosovë.

[1] Mustafa Ceriq, Islam izmedju religije i nacije, Glasnik, Sarajevë, 1991, nr. 5.

[2] Alija Izetbegović, Islami ndërmjet Lindjes e Perëndimit, Shkup, 2000/1421, f. 236.

[3] Muhamed Kutub, Bota në fokusin islam, Tiranë, 2006, f. 475.

[4] Sejid Muhammed Nakib El Attas, Islami dhe Shekullarizmi, Prishtinë, 2006, f. 93.

[5] Ka shumë përkufizime mbi religjionin. Ndër më të pranishmit është ky: Religjioni është mënyrë, sipas së cilës njeriu realizon lidhjen e tij me forcat e larta. Shih Dr. Muhammed Abdullah Draz, Ed Din, Beirut, 1390/1970.

[6] Alija Izetbegović, po. cit., f. 263.

[7] Ajni Sinani, Islami besim, ligj, kulturë dhe qytetërim, Prishtinë, 2007, shih: Deklarata Islame për të Drejtat e Njeriut, f. 124-142 dhe Deklarata Islame (e Kajros) e të Drejtave të Njeriut, f. 153-163.

[8] Ibid, f. 18.

[9] Muhammed Bakir es -Sadër, Filozofia Jonë, Prishtinë, 2006, f. 67.

[10] Ibid, f. 56.

[11] Alija Izetbegović, op. cit., f. 242.

[12] Ibid, f. 243.

[13] Ali Bullaç, Historia, shoqëria dhe tradita, Prishtinë, 2003, f. 170.

[14] Sejid Muhammed Nakib El Attas, op. cit., f. 81, shih fusnotën 48.

[15] Ali Bullaç, op. cit., f. 170.

[16] Ismail al Faruki and Lois Lamya al Faruqi, The Cultural Atlas of Islam, New York, 1986, f. 279.

[17] Ali Tantavi, Prezantimi i përgjithshëm i fesë islame, Shkup, 1421/2001, f. 189.

[18] Abdul Hamid A. Ebu Sulejmani, Kriza në mendjen myslimane, Tiranë, 2006, f. 195

[19] Nexhat Ibrahim, Islami si provokim global, Shkup, 2006, f. 299.

[20] Alija Izetbegović, op. cit., f. 252.

[21] Ismail al Faruki and Lois Lamya al Faruqi, op. cit., f. 158.

[22] Dr. Murad Hofmann, Islami në mijëvjeçarin e tretë, Shkup, 1428/2007, f. 123.

[23] Ibid, f. 121.

[24] Mustafa Ceriq, op. cit.

[25] Ibid, f. 30.

[26] Dr. Murad Hofmann, op. cit., f. 125.

Kndaj Edukata Kurani



Ma. Gilman Kazazi

Leximi i Kurani është ndër adhurimet më të vlefshme. Leximi i tij e qetëson zemrën, e largon mërzinë, e çlodh mendjen dhe mbi të gjitha, na afron tek Allahu.

Allahu e ka bërë Kurani udhëzim dhe shërim për besimtarët. Kurani është mrekullia më e madhe që i është dhënë profetit Muhamed (a.s.). Allahu i ka sfiduar njerëzit dhe xhindët deri në Ditën e Gjykimit, për të sjellë një Kurani të ngjashëm me të, një sure të ngjashme me të, por nuk do të jetë e mundur.

“Thuaj: Kurani është për besimtarët udhëzues e shëruës.” (Fusilet, 44) **“Dhe, Ne, shpallim nga Kurani atë që është ilaç dhe mëshirë për besimtarët.”** (El-Isra, 82)

“Thuaj: Sikur të tuboheshin të gjithë njerëzit dhe xhindët, për të hartuar një Kurani të tillë, ata nuk do të mund ta hartonin ashtu siç është ai, madje, edhe sikur t’i ndihmonin njëri-tjetrit.” (El-Isra, 88)

Këtë Libër të madhërishtë, Allahu e zbriti që të praktikohet dhe zbatohet në jetë. Myslimani e ka për obligim ta ruajë, respektojë dhe nderojë Kurani.

Në vijim do të parashtrijmë pikat më të rëndësishme në lidhje me edukatën e myslimanit ndaj Kurani:

- **Të qenët krenar me aftësinë e të lexuarit të Kurani nga gjuha e kulluar arabe.** Të mos mashtrohet me të mirat e kësaj bote dhe të mos bëhet pishman për mosarritjen e ndonjë mirësie tjetër nga kjo botë. Allahu i Lartësuar i është drejtuar profetit Muhamed, duke i thënë:

“Ne, të kemi shpallur ty shtatë ajete që përsëriten (el-Fatiha) dhe Kurani e madhërueshëm. Mos i drejto sytë e tu kah ato kënaqësi që Ne ua kemi dhënë disave prej tyre dhe mos u hidhëro për ta (në mos besofshin). E ndaj besimtarëve bëhu i butë.” (El-Hixhr, 87-89)

- **Sinqeriteti në leximin e Kurani,** leximi i Kurani për hir të Allahut. Leximi i tij është ibadet (adhurim) dhe çdo ibadet duhet të shoqërohet me njetin e pastër. Ibadetet nuk pranohen pa sinqeritet. Kush e lexon Kurani për hir të njerëzve, për hir të parave, për t’u thënë: “Sa zë i bu-

kur!”, ai nuk meriton shpërblim tek Allahu.

Parimi islam, i shprehur në gjuhën e Profetit Muhamed (a.s.), është: **“...Allahu pranon nga veprat, vetëm ato të sinqertat, që bëhen për hir të Tij.”** (Nesaiu)

- **Lexoje Kurani duke qenë i pastër.** Është e pëlqeshme që të merret abdest para këndimit dhe është e detyrueshme që të merret abdest para se të preket Kurani.

Pastërtia nga *xhunubllëku*, *hajzi* dhe *nifasi* janë kusht për leximin e Kurani, sipas mendimit të katër medhhebeve. Dijetarët e medhhebit Maliki e kanë lejuar leximin dhe preken e Kurani për gruan me hajz dhe nifas, për qëllim të përsëritjes dhe mësimin të Kurani. Prekja e Kurani, sipas mendimit të dijetarëve të katër medhhebeve, duhet bërë duke qenë i pastër.

“Me të vërtetë ai është Kurani i Famshëm. Është në një libër të ruajtur. Atë nuk e prek kush, vetëm të pastrit. Është zbritur prej Zotit të botëve” (el-Vakia, 77-80)

Profeti Muhamed (a.s.), thotë: **“Kurani e prek vetëm i pastri.”** (Maliku)

“Unë urrej ta përmend Allahun, përveçse duke qenë i pastër.” (Ibn Hiban)

“Pastroni gojën tuaj (dhëmbët) kur të lexoni Kurani.” (El-Bezar)

Aliu thoshte: **“Goja juaj është vendkëndimi i Kurani, prandaj pastrojeni atë me misvak.”** (Ibn Maxheh)

Pra, pëlqehet edhe pastrimi i dhëmbëve, kur lexohet Kurani.

- **Drejtimi nga kibla, kur lexojmë Kurani,** pëlqehet dhe nuk obligohet. Profeti Muhamed (a.s.), e ka lexuar Kurani në drejtime të ndryshme. Profeti Muhamed (a.s.), thotë: **“...ndenja më e mirë është në drejtim të kibles.”** (el-Mu’xhem el-Eusat)

- **Duhet të kërkohet mbrojtja e Allahut nga shejtani, kur fillon të lexosh Kurani.** Thuhet: Eudhu bil-lahi mineshejtani-rraxhim.

Allahu thotë në Kuran, në suren En-Nahl, ajeti 98: **"Kur të lexosh Kuranin, kërko mbrojtjen e Allahut prej djallit të mallkuar."**

- **Të thuhet: "Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim", në fillim të leximit të çdo sureje.** Përshtohet sureja "et-Teubeh", e cila nuk fillohet me Bismil-lah.

- **Kur lexohet Kurani, duhet të dëgjohet me vëmendje.** Në Kuran, në suren El-Araf, ajeti 204, Allahu thotë:

"Kur lexohet Kurani, dëgjojeni atë (me vëmendje) dhe heshtni, në mënyrë që të fitoni mëshirë."

- **Kurani duhet ruajtur nga vendet e pahijshme.** Është e turpshme për njerëzit ta mbajnë Kuranin vetëm për bereqet dhe vetëm për t'i mbrojtur ata nga fatkeqësitë, duke e vendosur atë poshtë dyshekëve, sipër rafteve të rrobave, në kroskote makinash, në sirtarë dyqanesh e shumë vende të tjera.

"...kush madhëron atë që Allahu e bëri të shenjtë, ajo është më e dobishme për të tek Zoti i vet.", "...E kush i madhëron dispozitat e Allahut, ajo është shenjë e devotshmërisë së zemrave." (El-Haxh, 30, 32)

- **Nuk lejohet udhëtimi me Kuran në një vend ku ekziston mundësia që të përdhohet, shkelet, shqyhet apo digjet.**

"Mos udhëtoni me Kuran, sepse kam frikë mos bjerë në dorën e armikut." (Myslim). Njëherësh ky hadith është argument se Kurani ka ekzistuar i shkruar që në kohën e Profetit Muhamed (a.s.).

- **Përsërite atë që ke mësuar nga Kurani dhe mos e harro.** Nëse ke harruar diçka nga Kurani, mos thuaj: "kam harruar atë sure", po thuaj: "më doli nga mendja ajo sure". Profeti Muhamed (a.s.), thotë:

"Askush nga ju të mos thotë: kam harruar këtë dhe atë ajet, sepse më ka dalë nga mendja...". (Ibn Hiban)

Nëse myslimani thotë: "kam harruar këtë dhe atë ajet", ai tregon mosinteresimin dhe neglizhencën e tij ndaj Kuranit, sepse Kurani harrohet vetëm nëse lihet pas dore. Në të vërtetë, me këtë hadith profeti Muhamed ka ndaluar të lihet në harresë ajo pjesë që është mësuar nga Kurani.

Ebul-Alijeh thotë: "Ekemi konsideruar nga gjynahet e mëdha të mësohet Kurani e pastaj të flihet derisa të harrohet."¹

Gjithashtu transmetohet - me një varg të saktë transmetuesish - nga Ibn Sirin se: "Gjeneratat e para e kanë urryer atë që harronte Kuranin e thoshnin për të fjalë të rënda."²

- **Nuk lejohet polemika që ngjall dyshime dhe de-**

1. (El-Metalib el-Alijeh, Ibn Haxher, 10\170. Thotë Ibn Haxher në Fet'hul-Bari 9\86 se: "vargu i transmetuesve është i mirë."

2. Fet'hul-Bari, Ibn Haxher, 9\86.

bati me të padrejtë rreth Kuranit. Profeti Muhamed (a.s.), thotë:

"Polemika në Kuran është (shpie në) kufr (mosbesim)". (Ebu Davud)

- **Nuk lejohet komentimi i Kuranit pa dituri.** Allahu e ka obliguar kërkimin e diturisë për myslimanin dhe na ka ndaluar të flasim në emër të Allahut pa dituri.

Thuaj: "Zoti im e ka ndaluar amoralitetin edhe hap-tazi edhe fshehurazi, edhe mëkatet, edhe shtypjen pa të drejtë, dhe që Allahut t'i bëni shok, për të cilën gjë nuk ju ka shpallur kurrfarë argumenti, dhe ka ndaluar që për Allahun të flisni çka nuk dini". (el-A'raf, 33)

- **Të tregohet i durueshëm në mësimin e leximit të Kuranit në gjuhën arabe.**

Profeti Muhamed (a.s.), thotë: "Ai që e lexon Kuranin me shkathtësi, do të jetë me melaiket e ndershëm dhe ai që e lexon me vështirësi, do të ketë dy shpërblime." (Ebu Davudi)

- **Pëlqehet zbukurimi i zërit gjatë leximit të Kuranit.** Kurani nuk lexohet si gazetë apo roman. Pjesë e zbukurimit të Kuranit është zbatimi i rregullave të leximit të tij. Profeti Muhamed e ka dëgjuar leximin e Kuranit nga shokët e tij me zë të bukur dhe ka kërkuar prej atyre që

kishin zë të bukur t'i lexonin Kuran. Ai (a.s.), thotë:

"Zbukurojeni leximin e Kuranit me zërin tuaj." (Ahmed)

"Kush nuk e zbukuron zërin kur lexon Kuran, nuk është nga ne." (Buhariu)

"O Eba Musa, të është dhënë një zë (ton) i bukur, sikurse

H. Davudit." (Buhariu)


"Njeriu me zë më të bukur në leximin e Kuranit është ai, që kur e dëgjoni duke lexuar, e kuptoni se e ka frikë Allahun". (Ibn Maxheh)

- **Të lexohet Kurani me ngadalësi dhe melodi, pa u nxituar.** Kjo, në mënyrë që të kuptohet ajo çka lexohet, të meditohet rreth asaj çka lexohet dhe të shqiptohet çdo gërmë e tij në mënyrë më të saktë.

Të shpejtuarit e tepërt në lexim, është vepër e urryer tek dijetarët. Leximi i një xhyzi me ngadalësi, është më mirë sesa leximi i dy xhyzave me shpejtësi.

Në suren el-Muzemmil, ajeti 4, Allahu thotë: **"...dhe lexo Kuranin me kujdes dhe qartë" "Dhe Ne, Kurani e kemi shpallur pjesë-pjesë, që ti t'ua mësosh njerëzve ngadalë dhe Ne, e kemi shpallur atë kohë pas kohe (sipas nevojës)." (el-Isra, 106) "(Ky) është një libër (Kurani), që ta kemi zbritur ty, libër i bekuar, për t'i studiuar argumentet e tij dhe për t'u këshilluar mendimtarët me të."** (Sad, 29)

Kur është pyetur Enesi (r.a.), për leximin e Profetit Muhamed (a.s.), e ka cilësuar leximin e tij: **"...leximi i zgjatur..."** (Buhariu)



Abdullah ibn Mugaffel (r.a.), e ka cilësuar leximin e tij: "...lexim i qetë, i ëmbël, melodioz..." (Buhariu)

Ummu Selemeh (r.a.), e ka cilësuar leximin e tij: "...lexim i qartë, gërmë për gërmë." (Tirmidhi)

Abdullah ibn Amr (r.a.), e pyeti Profetin Muhamed (a.s.), në sa kohë duhet ta lexonte Kuranin? I tha: *Në një muaj.* Abdullah ibn Amr tha: "Unë mundem ta lexoj më shpejt se kaq?" *Atëherë lexoje për shtatë ditë,* - i tha Profeti. "Unë mundem ta lexoj më shpejt se kaq", - ia ktheu Abdullahu. Profeti i tha: *Nuk mund ta kuptojë Kuranin ai që e lexon në më pak se tre ditë.* (Ebu Davudi)

Qëllimi kryesor në leximin e Kuranit është të kuptuarit e tij e pastaj praktikimi i asaj që kupton. Nuk mund ta kuptosh, nëse e lexon shpejt.

Ibrahim el-Havas ka thënë: *"Shërimi i zemrës gjendet në pesë gjëra: leximi i Kuranit duke medituar e kuptuar, lehtësimi i lukthit nga ushqimet, namazi i natës, përlujta para Allahut në kohën e syfyrit, shoqërimi i njerëzve të mirë"*.

-Leximi i Kuranit me zë, që të dëgjohet. Nëse leximi me zë shkakton hipokrizi a dyfytërsi tek lexuesi ose krijon zhurmë ndaj dikujt që falet apo shqetëson një person që fle, atëherë ai duhet lexuar pa zë.

Profeti Muhamed e ka krahasuar lexuesin me zë me dhënësin e sadakasë haptazi dhe lexuesin pa zë me dhënësin e sadakasë fshehurazi. (Ebu Davudi) Dhënia e sadakasë fshehurazi është më e mirë sesa dhënia haptazi.

E nëse është i sigurt nga dyfytërsia dhe shqetësimet e tjera, atëherë leximi me zë është më i mirë, sepse dobia e leximit zgjerohet për gjithë prezantuesit, aktivizohen shqisa më shumë në leximin e Kuranit, si dhe ndihmon në kuptimin dhe perceptimin më të mirë të Tij. *Profeti Muhamed (a.s.), në namazin e natës herë lexonte Kuran me zë të lartë, e herë me zë të ulur.* (Ebu Davudi)

Gjithashtu, leximi duke shikuar në Mus'haf, është më i mirë sesa të lexosh përmendsh, sepse shikimi në Mus'haf është ibadet në vete. *"Kush dëshiron ta dojë Allahun dhe të dërguarin e tij, le të lexojë nga Mus'hafi."* (Silisiletus-Sahihah)

Por, meqenëse qëllimi i leximit është të kuptuarit dhe të medituarit, atëherë gjithsecili le të gjykojë për veten se ku arrin të kuptojë dhe meditojë më shumë, duke lexuar nga Mus'hafi apo duke lexuar përmendsh.

- Është (mekruh) e papëlqyeshme të ndërpritet leximi i Kuranit për t'i folur një njeriu pa nevojë. Përfundimi i fjalës së Allahut është më parësor sesa bashkë-

bisedimi me një njeri. *Abdullah ibn Umeri (r.a.), kur lexonte Kuran, nuk fliste, derisa ta mbaronte leximin.* (Buhariu)

- Kur të lexohet Kurani, le t'i drejtohem Allahut me dua dhe lutje. Kurani nuk duhet bërë mjet fitese dhe pazarllëku me njerëzit.

"Kush lexon Kuran, le ta lusë Allahun me të. Do të vijnë ca njerëz të cilët e lexojnë Kuranin dhe lusin me të njerëzit." (Tirmidhi)

Ndërsa marrja e shpërblimit për mësimin e Kuranit, sipas dijetarëve të parë është e ndaluar. Me këtë mendim kanë qenë hoxhallarët e medh-hebit Hanefi dhe Maliki. Dijetarët e mëvonshëm e kanë lejuar marrjen e shpërblimit si domosdoshmëri e kohës, për të garantuar vazhdimësinë e mësimin të Kuranit. *"Gjëja më e merituar, për të cilën mund të merrni shpërblim, është Kurani."* (Buhariu)

- Nuk lexohet Kuran në sexhde apo ruku gjatë namazit. Sepse sexhdja dhe rukuja janë gjendje përlujtes dhe nënshtrimi ndaj madhësisë së Allahut. Gjendja e përlujtes nuk përkon me respektin dhe edukatën e leximit të Kuranit. *"Unë jam ndaluar të lexoj Kuran në ruku apo sexhde. Në ruku madhështoni Allahun, në sexhde bëni dua, sepse është më e mundshme t'u përgjigjet dua juaj"*. (Myslim)

- Respektimi i sexhdeve të Kuranit. Të biesh në sexhde, kur lexoni ajetet e sexhdeve. Në Kuran ndodhen 15 ajete të tilla.

Ajeti i parë i sexhdes në Kuran, është ajeti 206 i sures el-A'raf dhe ajeti i fundit është ajeti 19 i sures el-Alak. Sexhdet e tjera gjenden në suret e mëposhtme të shoqëruara me nr. e ajetit. Err-Rra'd: 105. En-Nahl:

50. El-Isra:109. Merjem: 58. el-Haxh: 18, 88. El-Furkan: 60. En-Neml: 26. Es-Sexhdeh: 15. Sad: 24. Fussilet: 38. En-Nexhm: 62. El-Inshikak: 21.

- Mësoje leximin e Kuranit nga persona të aftë. Shqiptimi i saktë i gërmave të Kuranit nuk mund të mësohet nga libri, pa mësues.

Profeti Muhamed i ka porositur sahabët e tij ta mësojnë Kuranin nga persona të caktuar, edhe pse në atë kohë ka pasur me dhjetra hafizë dhe gjuha e tyre ka qenë arabishtja. *"Mësojeni Kuranin nga katër persona: Abdullah ibn Mes'udi, Ubej ibn Ka'bi, Muadh ibn Xhebeli dhe Salim Meula Ebi Hudhejfeh."* (Buhariu)

Lexues i nderuar, mendoj se njohja e rregullave të sjelljes ndaj Kuranit, si ndaj librit më të çmuar që kemi në shtëpitë tona, nuk duhet të jetë privilegj vetëm i njerëzve të cilët merren me thirrjen islame. Këto njohuri duhet të depërtojnë në masën e gjerë të besimtarëve. Duke parë zbrazëtinë që ekziston për këtë lloj edukate, vendosa ta paraqes këtë punim.



Mbi pasqyrimin e transcendencës hyjnore në artet pamore

Edison Çeraj

Nëse do e përmblihdhim me dy fjalë thelbin e trajtesës së mëposhtme, mund të themi se arti evropian (Greqia e Lashtë, Rilindja dhe të gjitha periudhat pas saj) synon/kërkon të Vërtetën, ndërsa ai lindor (arti islam në veçanti) e manifeston atë; thënë ndryshe është një lloj zgjatimi konkret, – domethënë pamor – i saj, për aq sa kjo e fundit i ka dhënë tagër.

Pikërisht për këtë arsye, arti perëndimor është aq i ndryshëm nga lindori; sepse kanë qëllime të ndryshme; sepse i qasen krejt ndryshe njeriut dhe jetës.

Letërsia greko-romake ka njohur parimin e hyjnizimit përmes idealizimit. Në këtë proces, konkretja (një qenie njerëzore ose një objekt në natyrë) ndahet prej shembullit apo konkretizimit të vet individual, me qëllimin për të përforcuar cilësitë e saj. Kur këto cilësi kishin arritur shkallën më të fundit të mundshme, objekti paraqitej si ai që natyra duhej ta prodhonte dhe dëshironte ta prodhonte, por që nuk ia kishte dalë ta bënte përmes ngurrimit dhe njëmijë e një përpjekjeve të saj. Në këto përpjekje ajo mund të kishte pasur vetëm sukses të pjesshëm. Arti është më i aftë se natyra; në të artisti mund të prodhojë, por kurdoherë dështonte ta bënte këtë. Vepra e artit, për këtë arsye, nuk është një imitim i natyrës, siç mendonte Platoni; e as që është ky një përgjithësim empirik prej asaj që është e dhënë në natyrë. Është *a priori*, e kështu, transcendente apo hyjnore, duke qenë se është produkt i një procesi idealizimi të zbatuar deri në shkallën më të plotë e përfundimtare.¹

Perënditë e Greqisë së lashtë nuk ishin realitete transcendente, as krejtësisht e ontologjikisht tjetër gjë, përveçse natyrë. Ata ishin prodhim i të njëjtit proces idealizimi, të zbatuar prej gjenisë njerëzore. Ata ishin njerëzorë, që të gjithë tepër njerëzorë; qejflinj, ngurrues, urrejtës, dashurues, komplotistë e kundër-komplotistë kundër njërit-tjetrit; përfaqësues të çdo aspekti të personalitetit njerëzor, të çdo force të natyrës, prej së cilës ata ishin idealizimi përfundimtar.²

Këto perëndi bashkëpunonin me heronjtë apo me njerë-

zit që kishin një pozitë të caktuar në shoqëri, për të arritur kështu një qëllim i cili ishte projektim i dëshirës njerëzore për të zotëruar diçka, për të ngadhënjyer apo për të mbërritur te një ideal që përthyej te tokësorja si tepër tokësor. Kështu, njerëzorët i zotëronin perënditë, pavarësisht të papriturave që këta të fundit u caktonin, pasi edhe këto të papritura për njerëzorët rrëfeshin nga poetët si domosdoshmëri e vendosjes së një dallimi apo kufiri të “pamundur” ndërmjet së epërme dhe së poshtme.

Kur skulptori i paraqiste ata në mermer apo poeti në vetëzbulimin e tij dramatik, çdo njeri që kuptonte gjuhën belbëzuese të natyrës, do të thërriste: “Po, pikërisht kjo është ajo që natyra ka dashur të thotë!” Ky është natyralizëm dhe lashtësia klasike ishte shembulli më i mirë i tij. Ndaj dhe është mashtruese e çorientuese të flasësh për transcendencë në lashtësinë greko-romake. Do të ishte më mirë të flitej për imanencë. Imanenca kërkon natyroren, korreктen dhe empiriken, për arsye se ajo është një përmasë e kësaj. Ajo nuk e shmang konkretin, për arsyen se është një idealizim i natyrores, dhe pa natyroren ajo nuk mund të arrihet. Kjo është edhe arsyeja se pse arti i Greqisë dhe i Romës është figurativ; dhe interpretimi i figurave të caktuara në art, apo portretizimi, është në nivelin më të lartë.³

Evropa e rigjeti trashëgiminë e saj të lashtësisë dhe u rivu në zotërim të saj pas një mijëvjeçari, në kohën e Rilindjes. Gjatë atyre njëmijë vjetëve, Krishtërimi u përpoq nën një estetikë të trazuar dhe të errët, e cila gërshetonte elementet e trashëgimisë greke me disa elemente të asaj semite. Rrjedhimi qe Bizanti, arti i të cilit nuk u ngrit kurrë përtej ilustrimit. Pika më e fortë e artit bizantin, pra, ikona, ishte jonatyraliste në formë (e kështu, pra, semite, në ndjekje të trashëgimisë çifute) dhe natyraliste në përmbajtje, për arsye të ideve diskursive që ajo shprehte në figura apo drejtpërdrejt në titujt që u caktoheshin figurave prej artistit. Elementi semit u shkund tej prej artistëve të Rilindjes, që prodhuan imazhe të Jezuit, të Marisë, të Atit e të shenjtorëve, në përputhje me kuptimet e krishtera që u njiheshin atyre, drejtpërdrejt përmes vetë figurave, në stilin e Greqisë së lashtë.

1. Faruki, I. (2006) "Transcendencë hyjnore dhe shprehja e saj", f. 60. Përkth.: Edvin Cami. Tiranë: Erasmus.

2. Po aty, f. 60-61.

3. Po aty, f. 61.

Megjithëse autoritetet e Krishtëritimit, në fillim, e dënuan natyralizmin si kthim në paganizëm/idhujtari, ata u pajtuan me të, më në fund, për arsye të lidhjes së hyjnisë me natyrën, implicite në mishërim. Që nga ajo kohë, arti i Krishtëritimit ka qenë kryesisht figurativ dhe idealizues. Duket se kjo u pa si e kënaqshme, pasi transcendenca në mendjen e të krishterit nuk shtronte kurrë kërkesa që arti figurativ të mund të mos i përmbushte. Pra, krejt ndryshe nga mendja e myslimanit, që pranonte transcendençën absolute të Hyjnisë, siç lexojmë në Kuran: "Asgjë nuk i shëmbëllen Atij. Ai i dëgjon të gjitha dhe i sheh të gjitha." (42/11)

Siç e vëmë re, ndryshe nga i krishteri, myslimani pranon transcendençën e plotë dhe absolute të Hyjnisë. Pra, kjo nuk mund të pajtohej në asnjë mënyrë me imanencën e zbutur që toleronte shprehjen e hyjnisë në figura, pasi Zoti nuk ishte "tjetër" veç së natyrshmes, përveç idealizimit të Tij përfundimtar. Realiteti përfundimtar, për të cilin merakoset myslimani, prej të cilit mundohet, vullnetin e të cilit ai është gjithmonë në kërkim për ta gjetur, urdhrin të të cilit ai mundohet kurdoherë që t'i bindet dhe përme ndjen e të cilit e ka kurdoherë në buzë nga mëngjesi gjer në mbrëmje, në thuajse çdo fjali, është një realitet transcendent, thelbi dhe përkufizimi i të cilit është se ai është krejt tjetër nga i gjithë krijimi, qoftë kjo pjesa e dukshme dhe e zbuluar e krijimit, qoftë pjesa e padukshme apo e pazbuluar e tij. Duke qenë se ky realitet qëndron në anën tjetër të krijimit, ai është "krejtësisht tjetër" dhe i papasqyrueshëm prej asgjëje në krijim. Por ndryshe nga çfarë kanë bërë çifutët, që, pikërisht për këtë arsye kanë hequr dorë krejtësisht nga përpjekja për estetikë, duke mëtuar se transcendenca hyjnore nuk lejon hapësirë për arte pamore, artisti mysliman i pranonte artet pamore dhe u njihte atyre si detyrë të parë të shpallurit se natyra nuk është një mjet artistik.⁴

Si stilizimi, ashtu edhe idealizimi e tjetërsojnë të natyrshmen dhe konkrete. Po, nëse idealizimi tjetërson aq sa për ta bërë më të natyrshëm, më përfaqësues të gjinisë së vet, stilizimi e tjetërson aq sa ta mohojë konkrete bashkë me gjininë e vet. Stilizimi e shndërron natyrën në një mënyrë të tillë, sa të mohojë natyrshmërinë e saj. Vetëm figura e stilizuar sugjeron atë që i përket figura. Figura është zbrazur nga përmbajtja e saj dhe mbetet një guaskë, përdorimi i së cilës është për të shprehur mohimin. E njëjta gjë është e vërtetë për figurat njerëzore dhe të kafshëve, për hardhinë, gjethen dhe lulen në artet e Islamit. Stilizimi i tyre është mënyra e artistit mysliman për t'i thënë jo natyrës, shembullit të saj konkret dhe formës së saj ideale. Ideja se asgjë në natyrë nuk përbën një mjet të përshtatshëm për shprehje artistike, që është qëllimi i dukshëm i të gjithë artit pamor islam, është i barasvler-

shëm me pjesën e parë të dëshmisë së besimit, në të cilën pohohet se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Zotit. Ashtu sikurse teologjia islame, që na ka treguar se asgjë, absolutisht asgjë në natyrë nuk është Zot, apo hyjnore në ndonjë mënyrë (i gjithë krijimi është krijimi dhe, si i tillë është profan), ashtu edhe artisti mysliman, në shprehjen e tij estetike, na tregon se asgjë në natyrë nuk mund të përbëjë një shprehje të Hyjnisë.⁵

Sa më shumë që artisti mysliman është përsosur në stilizim, aq më shumë ka feksur në të mendimi se transcendenca e Zotit kërkonte më shumë sesa stilizim, nëse ajo duhej të shprehej me sukses në estetikë. Kështu, ai zbuloi se tërësia e natyrës mund të mohohet *en bloc*, nëse ai e braktiste stilizimin e objekteve natyrore dhe u rikthehej figurave gjeometrike. Këto janë krejt e kundërta e natyrës për mënyrën si ajo kuptohet prej nesh. Në të vërtetë, ato qëndrojnë në një përfundim logjik të procesit të stilizimit, ku stilizimi i vreshtit, i kërcellit, i gjethes dhe i lulës arrin qëllimin e tij përfundimtar. Të ngresh figurën gjeometrike në mjet të vetëm të arteve pamore, është një vendim krejtësisht në përputhje me dëshminë *La ilahe il-la Allah*. Në tërësinë e krijimit nuk ka asgjë që të jetë Allah apo që

të jetë pjesë e Allahut apo që, në çfarëdo mënyre, të jetë e shoqëruar me Allahun.


Edhe *Katrori i zi* i Malevich-it mund të shihet si demonstrim *par excellence* i mohimit (jo refuzimit) të natyrës dhe sendores konkrete të saj si mundësi e pamundur.

Si qenie transcendente, Allahu nuk i nënshtrohet kurrë ndijimit dhe, në këtë mënyrë, nuk mund të bëhet kurrë objekt i një intuited ndjesore.

Për artistin, puna e të cilit është që të paraqesë një intuitë ndjesore

të subjektit, Zoti është një rast absolutisht i pamundur. Ndërgjegjja myslimane drithërohet ndaj çdo mendimi për paraqitjen ndjesore të Zotit. Pikërisht në këtë pamundësi dëshpëruese të artistit mysliman erdhi edhe zbulimi i madh. Duke pranuar se transcendenca e largonte Allahun përtej çdo përfaqësimi apo shprehjeje estetike, a është e njëjta dukuri e vërtetë edhe për papërfaqësueshmërinë apo pashprehshmërinë e Tij estetike? Përgjigjja është mohore. Zoti është vërtetë i pashprehshëm, por nuk është e tillë pashprehshmëria e Tij. Kjo pashprehshmëri u kthye në objekt të shprehjes estetike, si dhe në objekt të pavetëdijshëm të artistit mysliman. Stilizimi dhe baza e tij, figura gjeometrike, përbënin mjetin, të shprehurit e pashprehshmërisë së Zotit përbën qëllimin. Gjenisë artistike të myslimanit i mbetej të krijonte skicën që, pasi të zbatohet ndaj mjetit, të mbërrinte qëllimin e saj.

Kjo u përmbush përpara fundit të shekullit të parë islam, kur zejtarët ishin ende në pjesën më të madhe të krishterë që kishin lënë Krishtërimin, por ende të përkushtuar ndaj



4. Po aty, f. 63.

5. Po aty, f. 63-64.

formave artistike të Bizantit. Në pallatet e emevinjve të Jordanisë, në Kubenë e Shkëmbit në Jerusalem, si dhe në Xhaminë Emevije të Damaskut, të cilat datojnë nga gjysma e dytë e shekullit të parë hixhri, ka tregues të shumtë që tregojnë se zejtarët ishin bizantinë në zejtarinë e tyre, por islamë në një pjesë të punës së tyre. Gjithashtu, ata, ose *maître de travail*-i i tyre, duhet të jetë nxitur prej vlerësimeve fetaro-estetike, të ndryshme nga ato që nxitën Bizantin.

Arti krahinor bizantin dhe romak e kishte njohur si stilizimin, ashtu edhe figurën gjeometrike, por kompozimit të tyre u mungonte vrulli (*momentum*). Ai ishte statik. Artisti mysliman zhvilloi një kompozim, në të cilin vëzhguesi ndihet i detyruar të zhvendosej nga një lule, kërcell a figurë në një tjetër, për arsyen se pasuesja ishte në proces të formimit (domethënë, të të qenit e vërejtur) pikërisht në çastin kur segmentet e të pasuarës po shtyheshin në vetëdije. E thënë ndryshe, kompozimi ishte i tillë, që ishte e pamundur të perceptoje plotësisht figurën e parë pa përfshirë një pjesë të figurës së dytë, të krijonte një konceptim të plotë të së dytës, pa përfshirë një të tretë e kështu me radhë. Kjo krijonte vegimin e një *élan*-i apo të një vrulli (ecuri e qëllimshme) për të shkuar përherë e më tutje prej pikës në të cilën binte fillimisht shikimi. Përsëritja dhe simetria atëherë u zbuluan për të përforcuar këtë vrull duke i mundësuar atij që të shpërndahet në të gjitha drejtimet. Figura fraksionale, që bëhej e nevojshme prej sasisë së pamjaftueshme të hapësirës materiale, siguronte një shtytje për imagjinatën, që të rikrijonte fraksionet që mungonin përtej *objet d'art*-it material.⁶

Ndërthurja e stilizimit, e moszhuillimit, e joorganikes, e fraksioneve që nxisin imagjinatën të prodhojë plotësuesit, simetrinë dhe çastin e tyre që gjeneron përsëritje – të gjitha e shtrëngonin përfytyrimin e shikuesit të vëmendshëm që të riprodhojë gjithnjë e më shumë pamje në të njëjtin ritëm *ad infinitum*. Natyra jozhvilluese, joorganike e pamjeve, diktonte që prodhimi apo vazhdimi i skicës⁷ në imagjinatë të ishte i pafund, pasi nuk ka asnjë pikë në të cilën ajo, logjikisht, të mund të përfundonte.⁸

Kështu, *objet d'art*-i bëhej një fushë e pamjes, e prerë në mënyrë arbitrare prej kufijve të saj materialë nga një fushë e pafund; dhe, sikurse fusha e pamjes së një mikroskopi, dhuronte një perceptim të shtrirjes së pafund përtej saj.

Shtrirja e përtejshme dhe vazhdimi i modelit në të janë një ide e arsyes që ushtron trysni mbi përfytyrimin për ta prodhuar atë për vetëdijen. Sigurisht, nën efektin e të dhënës në fushëpamje dhe të vrullit që ajo ka gjeneruar, përfytyrimi e përmbush me aftësi urdhrin dhe fillon prodhimin. Nëse ai përfytyrim është i fuqishëm, do të mbahet për një kohë të konsiderueshme dhe në hapësirë të kon-

siderueshme, por, për nga natyra, ai nuk mund ta përmbushë atë që pritet prej tij, që do të thotë, vijimësinë e pafund. Ndaj edhe, herët a vonë, atij do t'i duhet të kuptojë se detyra e tij është e pamundur, se përpjekja e tij është e pashpresë, sepse e pafundmja është diçka që nuk mund të bëhet kurrë objekti i një intuited ndjesore, qoftë kjo edhe në përfytyrim. Në këto kushte, përpjekja e përfytyrimit rrëzohet dhe vetëdija fiton përmes rrëzimit një intuitë të shkakut të rrëzimit, të pamundësisë për të përmbushur synimin e përpjekjes. Një intuitë e tillë është intuita e pafundësisë dhe pafundësia është përbërësi thelbësor i transcencës.

Objet d'art-i në Islam është estetikisht, domethënë, nga pikëpamja e bukurisë, kompozimi që ai mbart. Kompozimi është quajtur "arabeskë" (*arabesque*). Është skicimi, si dhe parimet estetike, mbi të cilat vetë kompozimi është ndër-tuar. Arabeska nuk është vetëm një zbulim në një sipërfaqe të rrafshët, por parimi i mishëruar në një sipërfaqe të islamizuar, në ballinën e ndërtesës islame, në dyshemenë e saj, në kompozimin dhe në ngjyrën e qilimit, në faqen e stolisur të dorëshkrimit, në përshtatjen ritmike dhe tonike të një pjese të muzikës islame, në përshtatjen e lulëzimit

dhe/ose të pemëve plot lule në kopsht, të krojeve të akuakulturës që lindin e rrjedhin. Arabeska është quajtur "dekorim" prej historianëve të artit lindor. Si e tillë, ajo është parë si një flakërim hedonik i ngjyrës, një përsëritje monotone, një kompozim i zbrazët për të mbushur sipërfaqet, apo, së fundi, si një teknikë kompensuese për të kapërcyer frikën e ndërgjegjshme të zbrazëtisë së shkretët. Kur këta "dijetarë" shtojnë edhe anën teologjike, argumentojnë se gjenia myslimane u dha e tëra

pas stolisjes me arabeska, për arsyen se Islami e ndalonte riprodhimin e figurave. Ata nuk kanë as kohë e as energji për të pyetur se pse Islami e ndaloi paraqitjen e figuratives. Në të vërtetë, arabeska nuk është aspak dekorim. Ajo nuk është sipërfaqësore ndaj *objet d'art*-it, por është thelbi dhe bërthama e tij.

Në të vërtetë, të mbulosh çfarëdo objekti me arabeskë, do të thotë ta transsubstancializosh atë aq shumë, sa që arti i arabeskës, i të ashtuquajturit "dekorim", është, në fakt, arti i transsubstancializimit. Nën ndikimin e arabeskës, *objet d'art*-i humb materialitetin/sendoren, konkretësinë, patjetdukshmërinë, individualitetin e tij, kufijtë e vetë qenies dhe të real-ekzistencës së tij, edhe nëse do të kishim të bënim me ndërtesën më të rëndë, më të madhe dhe më të ngurtë. Ajo bëhet një erë-dritë, e tejdukshme, perde fluturuese e kompozimit dhe e ritmit, që shërben si një pistë mbi të cilën përfytyrimi ngrihet dhe nis fluturimin e vet – një fluturim, i cili përfundon në katastrofë për përfytyrimin, por në ndjesinë më të madhe e më të thellë të transcendentës së mundshme për njeriun.

Këtu qëndron edhe *mundësia* e qenësishme që na jep arti.



6. Po aty, f. 65-66.

7. Ose i modelit *sui generis*.

8. Po aty, 66.

ISTIKAME

Arjan Ymeraj

Istikame, në aspektin gjuhësor do të thotë drejtësi ose korrektësi. Ndërsa në terminologjinë islame, do të thotë qëndrimi i njeriut në shariatën e Allahut *subhanehu ue te-ala*, ashtu siç ka urdhëruar Ai. Parimi kryesor i kësaj është sinqeriteti ndaj Allahut.

Allahu i Madhëruar thotë:

“Prandaj, qëndro i patundur në udhën e drejtë, ashtu siç je i urdhëruar. Ashtu të veprojnë edhe besimtarët që janë me ty e mos i kaloni kufijtë. Sepse Ai, me të vërtetë, i sheh mirë ato që bëni ju.” (Hud, 112.)

Me këtë ligjërim, Allahu i Madhëruar i drejtohet të Dërguarit të Tij, *salallahu alejhi ue selem*, dhe dihet se, kur ligjërimi është i drejtuar për të, ai i është drejtuar edhe umetit të Tij (*popullit të Tij*), përveçse, nëse ka ndonjë argument që është specifik për të.

Prej argumenteve që tregojnë se ajeti është i veçantë vetëm për të Dërguarin e Allahut, *alejhi salatu ue selam*, është fjala e Allahut të Madhëruar, i cili thotë:

“Ne të kemi shpallur shtatë vargje, që përsëriten dhe Kuranin e Madhërishëm.” (Hixhr, 87.)

Pra, ky ajet ka të bëjë vetëm me të Dërguarin e Allahut, *alejhi salatu ue selam*. Sipas kësaj rregulle, fjala e Allahut të Madhëruar në suretu’l-Hud ajeti 112: **“Prandaj, shko i patundur drejt rrugës së drejtë, ashtu siç je i urdhëruar...”**, është e përgjithshme. Pra, për të Dërguarin e Allahut, *alejhi salatu ue selam* dhe për umetin e Tij.

Sipas kësaj, çdokush e ka obligim që të shkojë rrugës së drejtë, ashtu siç është urdhëruar në Kuran, duke mos ndryshuar, shtuar apo pakësuar asgjë prej fesë së Allahut të Lartësuar.

Në një vend tjetër të Kuranit, pikërisht në suretu’sh-Shura, ajeti 15, Allahu i Madhëruar ka thënë:

“Andaj, ti thirr dhe bëhu këmbëngulës, ashtu siç je urdhëruar dhe mos ndiq epshet e tyre...”

Allahu i Madhëruar thotë:

“Atyre që thonë: “Zoti ynë është Allahu.” Pastaj, qëndrojnë në të, u vijnë engjëjt (melekët) dhe u thonë: “Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni!” (Fussilet, 30-33.)

Me urdhrin e Allahut, engjëjt u vijnë kudo e kurdo njerëzve që besojnë Allahun dhe më pas qëndrojnë në këtë besim deri në vdekje dhe nuk devijojnë, madje edhe kur kanë frikë; e u vijnë atyre sidomos në agoninë e vdekjes, duke u dhënë lajme gëzuese (*sihariqe*) dhe duke u thënë: **“Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni!”** Pra, ata u thonë: “Mos u frikësoni nga ajo me të cilën do të ballafaqoheni dhe mos u pikëlloni për atë që u ka kaluar prej çështjeve tuaja; **“... por, gëzojuni xhenetit që ju është premtuar!”** Nuk ka njeri që të mos jetë i kënaqur, nëse është prej banorëve të xhenetit.

Xheneti i është premtuar çdokujt që thotë: “Zoti im është Allahu.” dhe është përqendruar në fenë e Tij. Prandaj atyre u thuhet: **“... por, gëzojuni xhenetit që ju është premtuar!”** Gjithashtu, atyre u thuhet: **“Ne jemi miqtë tuaj në jetën e kësaj bote dhe në botën tjetër.”** Sepse engjëjt janë miqtë e atyre që thonë: “Zoti ynë është Allahu.” Dhe pastaj, janë të përqendruar në fenë e Tij dhe i drejtojnë e i ndihmojnë ata edhe në botën tjetër. Engjëjt i presin *Ditën e Ringjalljes*, duke i përgëzuar me të mira, në vend të frikës dhe tmerrimit. Ata do të jenë banorë të xhenetit, ku do të kenë çfarë të duan. Madje prej Allahut, ata do të kenë edhe më shumë **“... Si shpërblim nga Ai, që fal dhe është Mëshirëplotë.”**

Ky argument është për rëndësinë e të qëndruarit të patundur në fenë e Allahut. Njeriu duhet të jetë i qëndrueshëm, të mos shtojë, të mos pakësojë apo të ndryshojë diçka në fenë e Allahut, i cili e përsosi me të Dërguarin e Tij



të fundit, *alejhi salatu ue selam*, e nuk la në të asnjë gjë të mangët për ta plotësuar apo ndryshuar ne. Korrektësia në fe dhe në aspektet e tjera të jetës, duhet të karakterizohet nga drejtësia dhe mesatarja në çdo gjë, madje edhe në të kundërtën e vetes, në mënyrë që të fitohet lumturia në të dyja jetët.

Ebu Amri - ose Ebu Amrete - Sufjan Ibën Abdullahu, *radijallahu anhu*, e pyet një ditë të Dërguarin e Allahut, *salallahu alejhi ue selem*: "O i Dërguari i Allahut! Më thuaj për Islamin atë, për të cilën nuk do të kem nevojë të pyes askënd përveç teje. Tha: "Thuaj: "E besoj Allahun." Pastaj vazhdo me *ngulm* (në këtë)!" (Muslimi, 38.)

Ebu Amri pyeti të Dërguarin e Allahut, *salallahu alejhi ue selem*, për diçka nga feja e tij, që të jetë gjithëpërfshirëse për të dhe të mos e ndjejë të nevojshme për ndonjë sqarim prej dikujt. Besimi këtu, duhet të jetë jo vetëm me fjalë, por të thuhet me gjuhë, duke e pranuar dhe besuar me zemër dhe duke e praktikuar me vepra: pra, duke qëndruar në fenë e Allahut, drejt dhe i patundur, pasi ka besuar në të.

Besimtari, pasi beson në legjisla-cionin e Allahut, në shpalljet e Tij dhe në çdo gjë që vjen nga Ai, atëherë duhet të qëndrojë i fuqishëm drejt dhe pa devijuar djathtas apo majtas, as duke shtuar apo pakësuar diçka. Duhet të bëjë durim dhe të qëndrojë i fortë, duke përballuar çdo vështirësi në adhurimet ndaj Zotit të tij, siç është namazi, zekati, haxhi dhe në tërë fenë e Allahut, *subhanehu ue teala*. Duhet, gjithashtu, të qëndrojë i sinqertë ndaj Allahut dhe në pasimin e të Dërguarit të Tij, *alejhi salatu ue selam*.

Nga Ebu Hurejre, *radijallahu anhu*, transmetohet të ketë thënë: "Ka thënë i Dërguari i Allahut, *salallahu alejhi ue selem*: "Mundohuni të punoni duke mos e tepruar dhe as duke lënë mangët. Mbahuni fort e veproni drejt. Dijeni se, vërtet, askush nuk do të shpëtojë me punën e tij." Ata thanë: "As ti, o i Dërguari i Allahut?" Tha: "As unë! Përveçse, nëse më përfshin Allahu me mëshirën e Tij." (Muslimi, 2816.)

Fjala "*el-mukarebe*", që rrjedh nga folja "*karebe*", në hadithin tonë vjen në mënyrën urdhërore "*karibu*", është qëllimi dhe vullneti në të cilin nuk ka teprim "*la guluvun fih*", e as neglizhim "*ve la taksirun*". Ndërsa fjala "*essedad*" që rrjedh nga folja "*seddede*" e në hadithin tonë vjen në mënyrën urdhërore "*seddidu*" është qëndrueshmëria "*el-istikame*" dhe korrektësia "*el-isabe*" në vepër, që përfshin ë gjitha sjelljet e njeriut.

Dijetarët kanë thënë se kuptimi i *istikame-s* është qëndrueshmëria në adhurim ndaj Allahut të Lartësuar dhe kanë shtuar se ajo është nga fjalët përmbledhëse të të Dërguarit të Allahut, *salallahu alejhi ue selem*, dhe rregulluese e çështjeve.

Ky hadith tregon se korrektësia apo *istikame-ja* është sipas mundësisë, siç thotë edhe i Dërguari i Allahut, *salallahu alejhi ue selem*: "Veproni, mundohuni dhe bëhuni të kujdesshëm që t'ia qëlloni (të kapni të drejtën)." Kjo do të thotë: veproni dhe zbatoni ato për të cilat jeni urdhëruar dhe kujdesuni sa më shumë që t'i afroheni udhëzimit tim. Sepse, sado i devotshëm të jetë njeriu, gjithsesi ka për të gabuar. Prandaj, ai duhet të ketë kujdes në veprat e tij, që të jenë sa më pranë të vërtetës, në bazë të mundësisë dhe rrethanave në të cilat ndodhet. Për këtë, Profeti, *alejhi salatu ue selam*, në një hadith thotë: "Çdo bir i Ademit (pra, çdo njeri) është gabues, por më të mirët prej gabuesve janë ata që pendohen."

Njeriu, sado të arrijë shkallë të lartë dhe pozitë tek Zoti i tij, prapëseprapë nuk do të shpëtojë me veprën e tij, sado e madhe të jetë bamirësia që bën; përderisa as Profetin, *alejhi selam*, sikur të mos e begatonte Allahu me dhuntitë e Tij dhe t'ia falte mëkatet e kaluara dhe të ardhmet, nuk do ta shpëtonte vepra e tij.

Nëse dikush thotë se ka citate prej Kuranit dhe Sunetit, që tregojnë se vepra e mirë të shpëton nga zjarri dhe të fut në xhenet, si fjala e Allahut të Madhëruar, i cili thotë: "**Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave të mira që ka bërë.**"

Si mund të bashkohet ky ajet me hadithin paraprak?

Përgjigjja për këtë pyetje është se këto dy çështje bashkohen, duke thënë se hadithi, mohues i hyrjes së njeriut në xhenet me veprën e tij, ka për qëllim të tregojë se vepra nuk mund të jetë përballë xhenetit si shpagim (për të gjitha gjynahet që ka bërë); ndërsa ajeti Kuranor pohues, tregon se vepra është vetëm shkak për hyrjen në xhenet dhe për shpëtimin nga zjarri e jo shpagim për të. Por vepra nuk është gjëja e vetme me të cilën njeriu hyn në xhenet, pasi mirësia dhe mëshira e Allahut, *subhanehu ue teala*, janë dy shkaqet për hyrjen në xhenet.

Si dobi të këtij hadithi duhet të përmendim se njeriu nuk duhet të mburret me veprën e tij, sado të mira të ketë bërë, pasi vepra është shumë e pamjaftueshme dhe e paktë në krahasim me obligimin ndaj Zotit. Dobi tjetër e këtij hadithi është se njeriu duhet të shpeshtojë përmendjen e Allahut dhe të lutet gjithnjë që Allahu ta përfshijë në mëshirën e Tij.

Në këtë hadith madhështor, shihet kujdesi i (*shokëve të Profetit*) sahabëve, *radijallahu anhum*, për diturinë. Ata nuk linin asgjë pa pyetur në lidhje me çështjet e ahiretit dhe të kësaj bote. Pasi e mësonin dhe jetonin, ua transmetonin të tjerëve duke përhapur kështu urtësinë profetike anekënd botës.

*D*ijetarët kanë thënë se kuptimi i *istikame-s* është qëndrueshmëria në adhurim ndaj Allahut të Lartësuar dhe kanë shtuar se ajo është nga fjalët përmbledhëse të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), dhe rregulluese e çështjeve.

Beteja e suksesit



Altin Torba

Realiteti qëndron se produkti i quajtur njeri është më i përsosuri që ka ekzistuar dhe do të ekzistojë ndonjëherë. Madje çdo produkt, sado i avancuar, prezent ose i ardhshëm i teknologjisë më të sofistikuar njerëzore, është vërtet primitiv, krahasuar me të; kjo duke qenë se Projektuesi i njeriut është vetë Zoti i Përsosur.

Përvijim i kulminacioneve vlerore të këtij produkti, është fakti se si atij i janë vënë në shërbim kushtet dhe udhëzimet optimale për të arritur suksesin.

Përsosmëria lidhur me produktin njeri kalon edhe përtej kulminacioneve, kur shohim se si Krijuesi e pajisi njeriun:

Së pari me logjikën, këtë superkapital të mbivlershëm sfidues dhe mbretërues të materies, që është një specifike dalluese vetëm e tij;

Së dyti, bëri që njeriu vullnetarisht ta administrojë në detaj veten e tij me dorën e vet.

Nisur nga sa më sipër, sukcesi për këtë produkt, nëse ndiqen udhëzimet e Atij që e krijoi, është jo vetëm i mundshëm, po pse jo edhe i garantuar.

Të qenët i vetëdijshëm për supervlerën e pallogaritshme të produktit që ai përbën dhe zotëron, është fillimi drejt horizonteve të kaltra të suksesit, për të cilin njeriu u krijua...

Për të arritur suksesin, dëshira nuk mjafton, teksa *de facto*, çdo gjë nga ajo fillon...

Transformimet që kanë kapluar botën, kanë bërë që "Eskorta e Lavdisë" të bëhet e pamundur të arrihet pa u përsosur në "Artin apo Teknikën e Suksesit". Personi që tenton të garojë në këtë garë, pa qenë i afirmuar në teknikën e suksesit, do t'i përngjante garuesit që vrapon me atlete guri. Për të arritur tek smeraldi "Lavdi", duhet patjetër të përvetësohet mirë mjeshtëria e zhytjes në thellësitë e "Oqeanit Sukses".

Mos e mendo suksesin një karamelë,

që e kullufit kur dëshiron,

Atë nuk e shijon,

kush lëpirjen e durimit s'e provon.

Ashtu si çdo industri tjetër edhe industria e suksesit është e themeluar mbi ligje dhe udhëzime fikse dhe unike... Ligjet e suksesit do bëjnë gjithnjë punën e tyre, duke favorizuar ata që i favorizojnë ato dhe injoruar ata që i

injorojnë...

Për të qenë garues në pistën sukses të jetës, nevojiten dy superelemente:

1. Durimi, i vlerësuar dhe si rripi i sigurimit në këtë rrugë plot sfida e kthesa;

2. Lëvizja, që presupozon fillimin e udhëtimit, përmes një startimi të vullshëm.

Sukcesi nuk është i pamundur, përveçse për ata që e mendojnë të tillë. Sukcesi është një gjë që mund të kryhet, është një art apo teknikë në të cilën mund të ushtrosh. Ai është metali thelbësor i ngulitur në zemrat e njerëzve të lumtur, është emblema e profetëve dhe pas tyre, e mbarë strategëve. Para se të fillojmë udhëtimin drejt suksesit, të ftoj të vendosësh rripin e sigurimit "durim" si dhe:

- Të na shoqërosh në këtë udhëtim hap pas hapi, me tërë qenien tënde, të hetosh në detaj rreth këtyre sekreteve kah destinacioni sukses, pse jo edhe duke shkruar dhe memorizuar herë pas here.

- Atë që do përfutosh nga ky udhëtim bëje kryefjalë të diskutimeve të tua me të tjerët, bëje shokun më të ngushtë; sepse kjo të pajis me aftësinë progresive të analizimit dhe konkludimit të ecejakut tënd dhe të tjerëve drejt suksesit.

- Para se të nisesh për në këtë udhëtim, të ftoj të meditosh mbi suksesin dhe mënyrën se si ti i qasesh atij, por në fillim, para çdo gjëje tjetër, ke nevojë të fiksosh konceptet dhe parimet bazë lidhur me të.

- Në çdo rresht nga rreshtat në vijim, do të shfaqet një sekret i qartë mbi suksesin dhe nga ti kërkohet vetëm t'i hapësh atij mendjen. Kur ai të vijë, ndalo dhe reflekto disa momente... Ke të bësh me momentet më të rëndësishme, që me lejen e Zotit, do të jenë transformueset e jetës tënde.

- Kam një këshillë, të cilën konsideroj dhuratë të çmuar nga unë. Nise tani këtë udhëtim, sa më shpejt, me seriozitetin maksimal dhe duke tërhequr përkrahu sa më shumë shokë të denjë, sepse shoku i mirë është karburanti më i mirë.

BETEJA PËR SUKSES

Jeta është e mbushur me beteja, teksa që të mbijetosh, duhet të hysh se s'bën në arenat e jetës, duhet se s'bën

të bëhesh personazh i betejës së afirmimit të vetvetes, betejës së parimeve, betejës ndaj preokupimeve të jetës dhe të tjera betejave, që së bashku përbëjnë atë që quhet beteja për sukses.

Që të mbijetosh, duhet domosdoshmërisht ta ëndërrësh suksesin dhe t'i këndosh atij. Suksesit i thur këngë çdo njeri, në çdo moment. Mos mendo se ndokush i dëshiron vetes mjerimin apo gëzohet me dështimin.

Po ç'është sukcesi? Ku gjendet ai?

Të shumtë qenë ata që e kërkuan suksesin, jo në vendin e vet, ashtu si kërkuesi i smeraldevë në shkretëtirë... U kthyen duarbosh, të dërrmuar, të lebetitur dhe shpresëvlarë.

Mos vallë sukcesi presupozon akumulimin e parasë dhe pronës? Të paktën kështu thonë dhe mendojnë shumica... Por, para se të dëgjosh se ç'thotë shumica e njerëzve, dëgjo se ç'thotë Krijuesi yt! **"Mos të të mahnisë pasuria dhe as fëmijët e tyre! Allahu me to do t'i ndëshkojë ata në jetën e kësaj bote e do t'ua marrë shpirtat duke qenë të pafe."** (Kuran, Teube: 55.)

Dëgjo se ç'thotë më tej Profeti i fundit i Zotit!

"...kush ka dynjanë brengë të tijen; atij Allahu ia pllakos varfërinë midis syve, e bën të jetë i hallakatur dhe prej dynjasë nuk ka për t'i ardhur, veç çfarë i është paracaktuar." (Hadith i saktë, i transmetuar nga Tirmidhiu.) Po! *"I mjerë është skllavi i parasë"* (Hadith, Transmetim i Buhariut.), fatkeq është gjithkush që ia ka dedikuar jetën grumbullimit të pasurisë dhe katandisë dhe që **"Bën hesap se pasuria e tij do ta bëjë të përjetshëm."** (Kuran, Humeze: 3.)

Dikush tjetër mendon se sukcesi vjen përmes famës dhe pushtetit. Por as kjo nuk qëndron, pasi sa e sa persona të pasur, të famshëm e me pushtet kanë rënë viktimë e depresionit dhe narkomanisë; sa e sa prej tyre kanë dështuar totalisht në planin familjar dhe atë shoqëror, kanë qenë simboli i dështimit në aspektin human dhe shpirtëror, fizik dhe mendor, madje jo të pakët kanë qenë ata që fundin e patën helm të hidhur, për të mos përmendur ata që e vulosën mjerimin, duke i dhënë fund jetës së tyre në forma nga më naivet...

Ndërkaq, nuk mund të mohohet fakti se pasuria, prona, fama dhe pushteti ndikojnë disi në dimensionimin e suksesit, por, gjithsesi, përgjigjja përfundimtare është se në realitet sukcesi është shumëdimensional, është pa limit... Sukcesi pa limit nuk kufizohet me sigurimin e pasurisë, edhe pse kjo e fundit duhet, as kufizohet me famën, fëmijërinë e katandinë, as me fjalët artificiale e të shtirura, por ai është i pakufizuar, duke qenë se buron nga brendia e pakufizuar e njeriut.

Për suksesin e vërtetë janë shprehur se ai, "Është abstrakt, nuk mund të perceptohet nga shqisat, është i pamatshëm në sasi, vëllim dhe nuk blihet me para." Ky është sukcesi i vërtetë. Buron nga shpirti dhe ashtu si ai është pa limit.

Ndërkaq, sukcesi fals është një sukses i limituar dhe i përkohshëm, është sipërfaqësor, i shtirur dhe nuk korrespondon me brendinë e njeriut; gjë që bëhet shkak që personi të bjerë në konfuzion shpirtëror dhe depresion. Ky është sukcesi i rremë. Buron nga materialja e limituar, ndaj dhe i këtyllë është.

UNË DHE SUKSESI

Kuptova se për të qenë i suksesshëm, më duhet të rend pas suksesit pa limit, joformal, që buron dhe i ka rrënjët e tij solide thellë brenda meje... Kuptova se një gjë e tillë nuk është e mundur, vetëm se duke dëgjuar zërin e brendisë sime dhe duke ua vënë veshin problematikave thellë brenda qenies sime humane, të personifikuara në njohjen e identitetit tim njerëzor...

Identifikimi i unit imponon dhënien përgjigje pyetjeve:

Kush jam unë? Çfarë aspiroj? Ç'rol kam në jetë? Si duhet të manovroj? Cilët duhet të bëj shokë dhe referencë? Për të marrë përgjigje për pyetjet në fjalë, lëre brendinë tënde të përgjigjet, lëre zërin tënd të brendshëm të jehojë... Është

vërtet e dhimbshme dhe lënduese, kur ky zë na demaskon faktin se ne jemi nga ata që gënjejnë veten për sa e sa çështje që i mendojmë thelbësore dhe parime tonat të pakontestueshme.

Ky zë do të përcjellë lakuriq tek uni yt sa e sa problematika, që nga ana e tyre do rrezatojnë tek ai një tejperceptim të brendshëm, drita e të cilit do vegojë, duke ndriçuar çdo përgjigje lidhur me çdo pyetje të mbetur pa përgjigje, për të zbuluar kështu para teje identitetin tënd.

Tejperceptimi shpie te njohja e vetvetes dhe drejtgjykimi i saj.

Personi që arrin sa në fjalë, pasi

njohu unin e vet, është i aftë të njohë dhe depërtojë edhe tek uni i të tjerëve. Dëgjoje zërin tënd të brendshëm, nëse do të triumfosh. Ky zë përcjell brenda çdo njeriu fuqinë e mrekullueshme të identifikimit të së mirës dhe së keqes, fuqinë e tejperceptimit bazuar në këto vibrime instiktive, që janë rezonanca stabile, të cilat rrezatojnë gjendjen reale të njeriut, jo paraqitjen e shtirur të tij.

ËSHTË E VËSHTIRË TË JESH VETVETJA

Vetëm pas tejperceptimit përmes jehonës së brendshme, do jesh vetvetja dhe jo dikush tjetër. Vetëm pas kësaj do marrin përgjigje pyetjet: Kush jam unë? Çfarë aspiroj? Ç'rol kam në jetë? Si duhet të manovroj? Cilët duhet të bëj shokë dhe referencë?

Ky zë do të të dërgojë tek e vërteta se "Atij që të krijoi i takon të t'urdhërojë". Pikërisht në vërtetimin të këtij zëri të natyrshmërisë sate, Krijuesi solli për ty udhëzime përmes dy standardeve: Standardit hyjnor të Zotit dhe standardit të Profetit të Zotit.





Refleksione morale në Kuran

Nexhat Ibrahimi

HYRJE

Ndër çështjet më të rëndësishme të historisë njerëzore, prej Ademit (a.s.) e deri në Çastin e Fundit, është *moral*, mirësjellja e njeriut. Shumë popuj në histori janë shkatërruar për shkak të sjelljeve të pamoralshme, gjë që nuk mund të thuhet për shkak të mosdijes apo për shkak të varfërisë së tyre. Për këtë arsye, krahas detyrës së besimit të drejtë, të gjithë pejgamberët kanë pasur përparësi përmirësimin e sjelljeve njerëzore dhe të çdo gjëje tjetër që rregullon cilësinë e jetës.

Të gjithë librat e shpallur (kutub'us-semavij) e, sidomos Kurani, i kushtuan rëndësi të jashtëzakonshme moralit. Këtë konstatim e konfirmon edhe struktura e ajeteve kuranore, ku nga mbi gjashtë mijë ajete, vetëm rreth 500 sosh prekin drejtpërdrejt apo tërthorazi çështjet juridike. Të gjitha ajete t e tjera flasin për çështje besimore dhe morale.

PËRKUFIZIMI I MORALIT

Ahlaku është fjalë arabe, që do të thotë natyrë, karakter, moral, gjendje shpirtërore. Pra, *ahlaku* është shkencë mbi gjendjen shpirtërore dhe mbi cilësitë e njerëzve, për mirësjelljen njerëzore etj. Është shkencë që shpjegon cilësinë e së keqes dhe së mirës, ndihmon vrotimin e tyre dhe mundëson përvetësimin e të mirave e braktisjen e të këqijave.

Në pajtim me këtë, *ahlaku* ndahet në dy grupe kryesore:

- *Ahlaku* hamide (cilësitë e lavdëruara, pozitive)
- *Ahlaku* dhemime (cilësitë e qortuara, negative)

Për atë që i ka cilësitë e mira, Muhamedi (a.s.), ka thënë:

"Ai që ka ahlak (moral) të mirë, unë siguroj se do të hyjë në xhenet."

Kurani, por edhe historia e pasur islame, na ofrojnë këshilla dhe norma të vlefshme morale. Këto norma kuranore-sunetike janë sendërtuar jo rrallëherë, gjatë historisë. Të gjitha veprimet e vullnetshme njerëzore mund të jenë të mira apo të shëmtuara, qoftë vetvetiu, qoftë sipas pasojave në rastet specifike apo të përgjithshme. Edhe shqisat edhe arsyeja mund ta përcaktojnë ç'është e mirë e ç'është e keqe, edhe pa ndihmën e frymëzimit direkt. Sepse vlerat morale, si nderi, drejtësia, dëlirësia, besimi janë vlera të lindura, të cilat Allahu i ka vendosur në zemrat njerëzore qysh në fillim. Këto vlera i ka përforcuar edhe Pejgamberi i Zotit (a.s.), me premtimet e Krijuesit për shpërblim në këtë botë dhe në botën tjetër. Sepse morali është religjion i transformuar në synime dhe rregulla të mirësjelljes, mirësjellje e vullnetshme e njeriut, harmonizuar me kuptimin e ekzistencës të Allahut (xh. sh.). Prandaj do të thuhet se moral të qëndrueshëm pa religjion nuk ka, sepse morali është rezultat i besimit në Absolutin, ndërsa çdo gjë tjetër

që ngjason në moral, është shprehur e fituar nga ambienti ku jetojmë apo veprojmë.

Shejh Muhammed El-Gazaliu egjiptian, thotë:

“Kurani fisnik mund të shpjegohet në katër mënyra:

1. Ajetet kuranore që përshkruajnë gjithësinë, krijimin e gjithësisë nga materia, karakterin kalimtar të saj dhe sekretet lidhur me të;

2. Ajetet kuranore që përshkruajnë këtë botë, përgjegjësitë dhe detyrimet tona, atë që do t’u ndodhë njerëzve, si dhe shkakun e sfidave dhe sproavave;

3. Ajetet kuranore që përshkruajnë popujt e kaluar: historinë e tyre, besimet dhe shtrembërimet në besim;

4. Ajetet kuranore që përshkruajnë Ditën e Gjykimit, shpërblimin dhe ndëshkimin.”¹

Me fjalë të tjera, Kurani është ai që e kultivon shpirtin dhe trupin, logjikën dhe idetë, dobitë dhe dëmet e jetës, kthimin në hijë, premtimet dhe kërcënimet, simpatitë dhe antipatitë.

SYNIMET E TEOLOGJISË MORALE

Synimi i moralit (ahlakut) është ta përkryejë njeriun në pikëpamjen morale-etike, ta bëjë atë të pavarur, të vetëdijshëm, të ndërgjegjshëm dhe të pjekur, që të rrezatojë në rrethin e ngushtë e të gjerë, në këtë botë dhe në botën tjetër. Morali në islam ka rëndësi parësore, pas besimit. Prandaj, të gjithë pejgamberët e Zotit, krahas mësimave besimorë, janë angazhuar në përmirësimin e sjelljes njerëzore. Edhe Muhamedi (a.s.), kështu e kuptoi misionin e tij dhe në një rast, tha:

“Padyshim, jam dërguar që t’i përsos virtytet e mira të moralit”. (Ahmedi).

Synimi kryesor i të gjithë pejgamberëve, dijetarëve të botës, ligjvënësve ka qenë përsosja dhe përmirësimi i moralit të njerëzve dhe në këtë pikëpamje, kanë qenë të palodhur, sepse morali është lidhja më e mirë ndërmjet anëtarëve të shoqërisë dhe vetëm me të mund të bëhet çdo ndryshim pozitiv në bashkësinë e njerëzve.²

KURANI DHE HADITHI PËR MORALIN

Ajetet e shumta kuranore për moralin e edukojnë njeriun dhe i forcojnë vlerat morale, duke e bërë personalitet të qëndrueshëm, të aftë ta ndajë dhe dallojë të mirën nga e keqja, të bukurën nga e shëmtuara, të dobishmen nga e dëmshmeja. Të gjitha ajetet kuranore kërkojnë që morali të jetë i pranishëm në të gjitha pikëpamjet njerëzore.

Çdo besimtar duhet të pajiset me virtyte morale, si: falënderimi, mëshira, dhembshuria, drejtësia, durimi, sinqeriteti

etë e të tjera dhe të shmangët nga veset e liga, si: lakmia, urrejtja, smira, mendjemadhësia etj.

Para Allahut jemi të barabartë, që do të thotë se prejardhja apo pasuria jonë, gjuha apo ngjyra jonë nuk janë vetvetiu përparësi, por përparësia konsiston në takvallëkun, vëmendjen e vazhdueshme të njeriut për të bërë mirë e për të shmangur të keqen. Çdo veprim yni, që e kënaq Allahun (xh.sh.), është i pranuar dhe çdo veprim që e hidhëron Atë, është i braktisur.

Këtë e pohon edhe Kurani, kur thotë:

“O ju që besuat! Përgjigjuni Allahut dhe të Dërguarit, kur ai ju fton për atë që ju jep jetë...” (El-Enfal, 24)

“Ju e kishit shembullin më të lartë në të Dërguarin e Allahut...” (El-Ahzab, 21)

“E bindjuni Allahut dhe të Dërguarit, që të mëshiroheni.” (Ali Imran, 132)

“...padyshim, ti je në pedestalin më të lartë të moralit.” (El-Kalem, 4)

Hadithi është burimi i dytë i moralit islam, kurse Muhamedi (a.s.), është shembulli i gjallë praktik, siç mund ta mësojmë nga vetë fjalët e Pejgamberit (a.s.):

“Padyshim, unë jam dërguar për t’i përsosur virtytet morale”. (Ahmedi, Tirmidhiu)

Aisheja (r.a.), e pyetur për Muhamedin (a.s.) dhe moralin e tij, thotë:

“Moralin e tij ka qenë Kurani.” (Ahmedi)

Suneti është praktikë pejgamberike e Muhamedit (a.s.), e shënuar dhe përcjellë nëpërmjet hadithit dhe paraqet burimin normativ të doktrinës islame

në përgjithësi dhe të etikës islame në veçanti.³

MORALI (AHLAKU) I PEJGAMBERIT MUHAMED (A.S.)

Para njerëzve, Pejgamberi i Allahut ishte një Kuran i gjallë. Në sjelljet e tij etike, në virtytet, në ibadetin e tij, në xhihadin, paqen, në vendbanimin e tij dhe jashtë, në shtëpi dhe publik, kur fitonte dhe kur humbte, kur ishte i sëmurë dhe i shëndoshë, kur ishte i varfër dhe i pasur, në çdo gjë ishte shembull që duhej pasuar.

Një herë u pyet Aisheja (r. anha), nga Katade. Ja si u zhvillua biseda:

- O nëna e besimtarëve! Më njofto për moralin e Pejgamberit të Allahut (a.s.)

Aisheja (r. anha), u përgjigj:

- A nuk e lexon Kuranin?

- E lexoj.

1. http://www.monteislam.com/index.php?akcion=columns&main_id=121.

2. Ibid.

3. Për burimet e etikës shih: Nexhat Ibrahim, Bazat e etikës islame, në: Vepra 5, Logos-A, Shkup, 2009, fq. 65 e tutje.

Ajo tha:

- *Padyshim, morali i Pejgamberit të Allahut (a.s.), është Kurani.* (Muslimi dhe Ebu Davudi).

Pejgamberi (a.s.), gjithnjë është sjellë drejtësisht dhe butësisht ndaj të gjithëve. Ka mbajtur fjalën e dhënë, ka respektuar dinjitetin e secilit, individ apo grup, madje edhe në çastet e vështira të jetës. Vetëm në luftë ka përdorur shkathtësinë e mashtrimit (strategjinë), sepse në këtë rast, e vetmja rrugë ishte të mbijetuarit e tij dhe të bashkësisë.

FARAONI, TIRANI MË I MADH I KOHËS

Kurani e përshkruan faraonin si tiranin më të madh. Ai pati kaluar çdo kufij në raportet e tij ndaj kundërshtarëve. Arroganca e tij bëri që ai të fillonte të mendonte se është vetë Zoti. Përmes dhunës sistematike që bënte nëpërmjet ushtrisë së mobilizuar, ua impononte njerëzve të vërtetat e tij rreth besimit, mirësjelljes, afarizmit etj. Çdo gjë që i përkiste Krijuesit, ai e përvehtësonte.

Përkundër kësaj dhune që ushtronte ndaj të pafuqishmëve, përkundër fuqisë ushtarake që kishte, faraoni tregojë i dobët përballë së vërtetës. Ai i frikësohej së vërtetës së Musait (a.s.), për fenë e vërtetë. Ai kishte futur tmerr edhe në mesin e qytetarëve, që të mos e besonin Musain (a.s.). Ja si e përshkruan Kurani këtë gjendje:

“Dhe Musait nuk i besoi askush, përveç një pakice nga populli i tij, nga frika se do t’i keqtrajtonte Faraoni dhe paria e tij. Faraoni ishte vërtet një tiran në tokë dhe në të keqe kalonte çdo kufi.” (Junus, 83)⁴

JUSUFI (A.S.), SHEMBULL I PASTËRTISË DHE MORALITETIT

Çdo pejgamber ka pasur specifikat e tij, varësisht rrethit dhe ambientit të jetës dhe veprimtimit. Isai (a.s.), ishte i madh në varfëri, Ibrahim (a.s.), në kundërshtimin rigoroz të idhujtarisë, Ejubi (a.s.), në durimin ndaj sëmundjes e të tjerë. Jusufi (a.s.), ishte simbol i dëlirësisë dhe nderit. Shembulli i tyre është forma më e mirë për t’iu kundërvënë anarkisë së shoqërive bashkëkohore:

“Por ajo, në shtëpinë e së cilës gjendej ai, nisi ta joshë në kundërshtim me dëshirën e tij. Ajo ia mbylli të gjitha dyert dhe tha: “Jam e gatshme për ty!” Kurse ai tha: “Allahu më ruajt! Me të vërtetë, Zoti im ka treguar kujdes për mua dhe, pa dyshim, keqbërësit nuk do të shpëtojnë kurrë.” (Jusuf, 23)

“Ajo e dëshiroi atë; por edhe Jusufi do ta kishte dëshiruar atë, sikur të mos kishte parë provën e Zotit të vet. Kështu e larguam nga e keqja dhe vepra e shëmtuar, sepse ai, në të vërtetë, ishte nga robërit Tanë të sinqertë.” (Jusuf, 24)

4. Ahmed Behxhet, Të Dërguarit e Allahut, Prishtinë, 2009/1430, fq. 285 e tutje.

“Që të dy vrapuan nga dera dhe ajo ia shqeu këmishën atij nga mbrapa. Te dera, ata hasën burrin e saj. Ajo tha: «Çfarë dënimi meriton ai që kërkon t’i bëjë të keqe gruas sate, përveç burgosjes apo dënimit të dhembshëm?»” (Jusuf, 25)

(Jusufi) tha: “Ajo provoi të më joshte”. Një i afërt i saj (që u gjend aty), pohoi: “Nëse këmisha e tij është shqyer përpara, atëherë ajo thotë të vërtetën, kurse ai gënjen.” (Jusuf, 26)

“Por, nëse këmisha e tij është shqyer prapa, atëherë ajo gënjen, dërsa ai thotë të vërtetën”. (Jusuf, 27)⁵

DISA ÇËSHTJE BASHKËKOHORE TË NJERIUT DHE TEOLOGJIA MORALE

Në botën bashkëkohore etika islame nëpërmjet teologjisë morale, duhet të nisë një varg çështjesh aktuale. Ndërmjet tradicionalistëve, të cilët prerazi thonë se nuk ka ç’të ndryshohet dhe modernistëve, të cilët thonë se duhen bërë ndryshime serioze, do të pohojmë se ndryshime nuk mund të ketë, por aksesit duhet të ndryshojë. Etikanët myslimanë, në bashkëpunim me juristët, duhet t’u japin përgjigje serioze çështjeve të eutanazisë, transplantimit, klonimit, maternalizmit dhe paternalizmit në rrafshin edukativ etj.

Për më tepër, ky angazhim duhet të intensifikohet, sepse vlerat morale janë të ngulitura në zemrat e besimtarëve dhe kjo natyrë kërkon të vihet në mbrojtje të tyre, sepse “vlera” e botës bashkëkohore, shekullarizmi, i lufton dy gjërat kryesore në zemrat e njerëzve: *mënjanimin* e fesë nga jeta politike, duke e çimentuar atë brenda mureve të faltoreve dhe *refuzimin* e vlerave kongjenitale, si themel për konstituimin e ligjëvënies.⁶

NË VEND TË PËRFUNDIMIT

Çdo njeri duhet të synojë ndërtimin dhe lartësimin moralo-etik dhe eliminimin e veseve të liga. Koha e sotme ka sidomos këto probleme, ndaj edhe Islami këmbëngul që t’u kthehem vlerave të neglizhuara, Kuranit dhe hadithit, si dhe të ngrihem në nivel të përgjegjësive që kemi (si halif) në botën ekzistenciale. Edhe pse Kurani dhe Hadithi kanë ofruar udhëzime konkrete, shumë shoqëri myslimane aktuale nuk e kuptojnë seriozitetin e problemit dhe nuk i kushtojnë rëndësi temës së trajtuar. Në këtë rrafsh, teologjia morale dhe teologët e moralit duhet të bëjnë shumë më tepër në zgjidhjen e problemeve apo në hapjen e mundësive për zgjidhjen e tyre, tashmë të rënda dhe mjaft komplekse.

5. Nexhat Ibrahim, Universi i Jusufit (a.s.), në: Vepra 2, Logos-A, Shkup, fq. 145-304.

6. Për problemet bashkëkohore të etikës islame shih: Nexhat Ibrahim, Vepra 5, Logos-A, Shkup, 2009.

CIVILIZIM PA DASHURI – DASHURI PA CIVILIZIM

Vehbi Vakasogllu

Niveli i një civilizimi është në proporcion të drejtë me vlerat që u jepen fëmijëve, grave dhe të moshuarve. Kur në një vend bëhet fjalë për civilizim, fëmijët jetojnë të gëzuar, gratë të lumtura dhe të moshuarit të qetë.

Por sot këto tri kategori të shoqërisë ndodhen në një gjendje të mjeruar. E gjithë bota ankohet nga abuzimi ndaj fëmijëve. Dhuna ndaj grave është në një nivel të frikshëm. Ndërsa të moshuarit konceptohen si teprica, ekzistenca e të cilëve është bërë shqetësuese. A mund të flitet për humanizëm dhe civilizim në shoqëritë ku ekziston ky lloj mentaliteti?

Shoqëritë më të njollosura në këtë çështje, gjenden në perëndim. Shoqëritë perëndimore, të cilat nuk imagjinojnë dot të tjera shoqëri të civilizuara përveç vetes së tyre, janë duke u përpëlitur në vorbullën e mungesës totale të dashurisë dhe mëshirës. Por më e keqja është se kjo sëmundje po përhapet anembanë botës.

Pasi filluam të mos jetojmë ashtu si besojmë, kjo sëmundje filloi të përhapet edhe tek ne. Ne, që dikur u dilnim për zot me një ndjenjë të lartë respekti prindërve, gjyshërve, madje të gjithë të moshuarve, grave, fëmijëve dhe të sëmurëve, sepse libri ynë i shenjtë Kurani, e ka deklaruar këtë si një adhurim të rëndësishëm. Gjithashtu edhe Profeti ynë (a.s.), gjatë gjithë jetës së tij ka qenë shembull i gjallë i këtij adhurimi.

Feja jonë na urdhëron që të tregojmë mirësi ndaj prindërve. Madje na ka ndaluar të themi qoftë edhe **“of”** për shkak të lodhjes apo mërzitjes që mund të ndiejmë gjatë shërbimit ndaj tyre. Gjithashtu, ajo na e ka bërë të qartë se, përveç përmbushjes së nevojave materiale që mund të kenë prindërit tanë të moshuar, duhet t’u japim rëndësi edhe nevojave të tyre shpirtërore.

Sipas islamit, fëmija që nuk mundohet t’i kënaqë prindërit e tij të moshuar me shërbim dhe mirësi, ngarkohet me gjynahe të mëdha. Ndërsa ata që marrin bekimin e prindërve, qoftë edhe me një gotë ujë, shtojnë edhe më shumë kapitalin e të mirave që u duhet për në botën tjetër.

JAZËK I QOFTË ATIJ!

Profeti ynë i dashur (a.s.), përsëriti tri herë në një mënyrë të ashpër: *“Jazëk i qoftë atij!”*. Sahabët pyetën të habitur: *“Kush është ai, o i Dërguar i Allahut?”*. Profeti (a.s.), thotë: *“Ai që, megjithëse të dy prindërit e tij ose njëri prej tyre plaken pranë tij, nuk hyn në xhenet, por meriton xhehenemin”*. (Muslim, Birr, 9.)

Ky ishte botëkuptimi i të parëve tanë. Për besimtarët, të mëdhenjtë ishin ata që u hapnin dhe u zgjeronin rrugët e xhenetit.

Në një hadith tjetër, Profeti ynë (a.s.), thotë:

“Sikur të mos ishin të moshuarit tuaj belkëputur, fatkeqësitë do të vërshonin mbi ju si një përrua”. (el-Cluni, Keshfu'l-Hafa, 2:163; Sujuti, Kenzu'l-Ummal, 9:167; Imam Gazali, Ihyau Ulumi'd-Din, faq. 341.)

Për këtë arsye, besimtarët e shohin respektin ndaj të mëdhenjve si një siguracion ndaj fatkeqësive dhe bëjnë ç'të mundën për t'i kënaqur ata.

Libri i saktë i Allahut, Kurani Kerim, na jep shembullin e Ibrahimit (a.s.), i cili i drejtohet babait të vet, duke i thënë: *“I dashur baba!”*. Atij babai, që atëherë gdhendte idhuj. Përsëri, libri i shenjtë na jep shembullin e Nuhut (a.s.), që i drejtohet të birit, i cili ishte bashkuar me jobesimtarët: *“Biri im i dashur!”*. Padyshim se këto ajete nuk janë veç për të na treguar gjendjen e së shkuarës, por në të njëjtën kohë edhe atë të çdo shekulli. Prandaj ai përmban mësim të çmueshme për të gjithë njerëzimin, deri në ditën e kiametit.

Në një shoqëri islame, të gjithë robërit nevojtarë dhe të varfër të Allahut kanë përfituar nga kjo mirësi në mënyrë të barabartë. P.sh., azili i pleqve që ngriti sulltani Abdulhamid Hani i II. dhe i cili vazhdon të funksionojë edhe sot e kësaj dite, është një nga shembujt më të bukur që pasqyron këtë fakt edhe në ditët tona.

Në këtë institucion, të gjithë të moshuarit e

vetmuar janë trajtuar në mënyrë të barabartë. Brenda kë-
tij azili është ndërtuar edhe një xhami, një kishë dhe një
sinagogë. Ky është një mësim i mirë humanizmi që i është
dhënë civilizimit perëndimor 115 vjet më parë.

PO TANI SI ËSHTË GJENDJA JONË?

Sot, për fat të keq, në azilet e pleqve nuk qëndrojnë
vetëm të moshuarit e vetmuar, por edhe ata që kanë të
afërm. Ata që janë të vetmuar, pavarësisht se në të vërtetë
kanë të afërm, janë më keq se ata që janë pa njeri. A mund
ta imagjinoni dot gjendjen shpirtërore të një njeriu që,
megjithëse përreth tij ka fëmijë, nipër e mbesa, përsëri
është i vetmuar? A do të jetë i lumtur e i qetë një njeri i
tillë që është i vetmuar në mes kaq shumë njerëzish, qoftë
edhe nëse qëndron në azilin më luksoz në botë?

Njeriu, shtohet dhe pasurohet me njeriun. Cili mund të
jetë ilaçi për atë njeri që është dënuar me vetmi në mes
të një kallaballëku të madh?

Njeriu është një qenie sociale. Ai ka
nevojë të bisedojë, të ndajë dhe të
kuptohet, po aq sa ka nevojë për të
ngrënë, për të pirë e për t'u veshur.
Për këtë arsye, njeriu që jeton në ato
ambiente ku shihet si i tepërt dhe i
panevojshëm, **"vdes"**. Ose më mirë të
themi, **"vritet"**.

Prandaj, ai evlat që i dënon me vetmi,
pra me "vdekje" prindërit e tij, është
një përbindësh me pamje njeriu. Si
është e mundur që një evlat t'i bëjë të
vuajnë kaq shumë njerëzit që duhen
dashur më shumë, siç janë nëna me
babanin?

Kjo ka të bëjë me vetëdijen, sepse
ai që nuk ka frikë Allahun, nuk është e
mundur të bëhet një evlat i mirë.

Ky është edhe problemi më i madh
i perëndimit në ditët e sotme. Njerëzit
interesaxhinj, që kanë në qendër egon
e tyre dhe që jetojnë me parimin "Secili për vete, Zoti për
të gjithë!", nuk duan të interesohen për askënd, qoftë edhe
për më të afërmit e tyre. Këto dy ditë të jetës së kësaj bote
duan t'i kalojnë vetëm për qejf të vet. Për ta, jeta e kësaj
bote, e cila është shumë e shkurtër, nuk ka vazhdim dhe
rinia është e vetmja kohë, kur ata mund të bëjnë qejf e
të argëtohen. Prandaj, sa të mundemi të hamë e të pimë
pa u kujdesur se është haram apo hallall dhe të shëtisim
e të argëtohemi në mënyrë shtazore, pa pasur frikë nga
Allahu.

Megjithëse ky lloj civilizimi u jep kënaqësi dhe lumturi
të rrejshme e të përkohshme, kurrë nuk e qetëson shpirtin
e tyre. Gjithmonë u lë një ndjenjë mangësie në botën
shpirtërore. Ndërsa ata mundohen të ngushëllohen e të
strehohen në shpresa boshe, duke pëshpëritur tekste kë-
ngësh si: "Nuk jam i lumtur, por kam shpresë!".

Të moshuarit e pafuqishëm, nga burgjet e hapura mo-

derne që janë azilet ose nga ndonjë qoshe tjetër vetmie,
i shohin këta të mjerë që përpëliten në probleme shumë
të ndryshme e të thella. Në fakt, ata shihen në çdo pro-
gram televiziv. A mund të presim më shumë se kaq nga një
civilizim që është ngritur në baza interesi material?

Shteti social i shekullit modern nuk e lë vetëm të mo-
shuarin, nuk e lë atë të uritur, por i mbledh të gjithë në një
vend dhe kujdeset për ta dhe besojnë se detyrën e tyre e
kanë kryer në mënyrë të përsosur. Nëse njeriu do të ishte
vetëm prej mishit, kockës dhe gjakut, do të ishim dakord
me këtë mendim. Por njeriu ka një zemër, një shpirt dhe
ndjenja të brendshme. Edhe ata kërkojnë dashuri, mëshirë
dhe dashamirësi. Për këtë arsye, pijet dhe ushqimet që nuk
janë dakord me këto ndjenja nuk mund të të ngopin. Edhe
veshjet që nuk u shtohen këtyre ndjenjave, nuk mund të
të ngrohin.

Një njeri, i cili do të bisedojë dhe të ndajë ndjenjat e
mendimet, nuk mund të jetë i lumtur as në një azil me
pesë yje, nëse aty nuk ka përzemërsi,
miqësi dhe mëshirë. Bota perëndimore,
mundohet që këtë boshllëk shpirtëror
të zgjidhë me para. P.sh., ata u sjellin
shoqërues me qira të moshuarve që
mërziten në azilet e tyre.

Këta shokë artificialë me qira, luajnë
rolin e të afërmeve, të cilët i ka marrë
malli për të moshuarit dhe kanë ar-
dhur t'i vizitojnë. Ata i përshëndesin
duke buzëqeshur, i pyesin për hallet
dhe gjendjen e tyre dhe ç'është më e
rëndësishmja, i dëgjojnë të moshuarit.
I dëgjojnë aq sa duan ose më mirë të
themi, aq sa paguhen.

Në fakt, më shumë se sa i dëgjojnë,
bëjnë sikur i dëgjojnë. I dëgjojnë pa
ndjerë asgjë, pa derdhur asnjë pikë lot
për tregimet e hidhura, pa ndjerë asnjë
lloj keqardhjeje brenda vetes. Pra, i dë-
gjojnë derisa të plotësojnë orarin e pu-
nës. Por këta njerëz të vetmuar, përsëri

ndihen më mirë përkundër faktit se këta janë dëgjues që
nuk ndajnë asnjë lloj ndjenje. Sa gjendje e hidhur, apo jo?

SHËRBIMI "ALO MIK!"

Në disa vende është hapur shërbimi "Alo mik!". Nëse
të vetmuarit kanë nevojë, telefonojnë shërbimin dhe me
mundësinë që u lejon xhepi, thërrasin dikë që t'i dëgjojë.
Ata që janë më të pasur, thërrasin psikologë dhe psikiatër
të diplomuar, të cilët mundohen t'u heqin vetminë.

Gjatë viteve që kam punuar në Gjermani, u njoha me një
nga këta të pasur. Ky njeri tepër i pasur, një ditë pësoi krizë
zemre. Kur i shkova për vizitë, vura re se ishte shumë i gë-
zuar. Sigurisht që nuk e përmbajta veten dhe e pyeta se si
mund të ishte kaq i gëzuar në këto çaste kaq të vështira.

Ai më tha: "Zotëri, ju këshilloj që edhe ju të kaloni një
krizë zemre sa më parë!" Ndërsa po mundohesha të kup-



toja se sa serioze ishte ajo që tha, ai shtoi: "Deri më sot jam sëmure shumë herë. Jam shtruar shumë herë edhe në spital, por asnjëherë nuk kam parë të afërm pranë meje. Kjo krizë zemre bëri që unë të jetoja diçka që nuk e kisha jetuar deri më sot. Shumë prej të afërmeve që jetojnë këtu, më erdhën për vizitë. Madje edhe djali im që jeton në Amerikë, të cilin nuk e kam parë prej nëntë vjetësh, erdhi dhe qëndroi tri ditë rresht. Ishte një gjë e mrekullueshme. Ata treguan dashamirësi dhe interes të madh për mua. Këto ishin gjëra që i jetova për herë të parë, prandaj dhe u lumturova jashtë mase. Nëse edhe ju dëshironi të ndjeni një lumturi të tillë, duhet që patjetër të kaloni një infarkt. Ju siguroj se dhimbjet dhe frika që do të ndjeni, do t'ia vlejnjë. Nuk të vjen kush për sëmundje të vogla, mor zotëri!"

Ky ishte një njeri i pasur nga një vend i pasur. Nuk dija ç'të thosha. Pas disa kohësh edhe unë u shtrova në spitalin e Berlinit për shkak të gurëve në veshka. Miqtë e mi nuk më lanë vetëm për gjatë gjithë kohës që qëndrova në spital. Sigurisht që vizitorët nuk i kisha me turma, por edhe vetëm nuk kam qenë. Një javë më vonë, më vizitoi shefi i spitalit dhe kërkoi të njihet me mua. Gjatë atij takimi, mësova edhe arsyen e vizitës si tij. Me habi të madhe më pyeti se çfarë pune bëja. Kur i thashë se përgjigja e kësaj pyetjeje ndodhet në regjistrat tuaj, tha:

- Regjistri thotë se ju punoni si mësues. Nuk m'u duk shumë bindëse, sepse unë kam vite që punoj në këtë spital dhe nuk më ka rënë rasti të shoh ndonjë të sëmure me kaq shumë vizitorë.

Kur dola nga spitali, u ktheva në krye të detyrës dhe zhvillova disa seminare me të rinjtë, ku fola gjerë e gjatë në lidhje me respektin dhe shërbimin ndaj të moshuarve dhe të sëmureve. Më vonë njëri prej të rinjve më tha:

- Mësues, përfituam shumë nga seminarët tuaja në lidhje me respektin dhe shërbimin ndaj të moshuarve dhe të sëmureve. Gjatë fundjavës punoja në një azil pleqsh për të përballuar shpenzimet. Puna ime ishte të shëtisja me një të moshuar dhe t'i plotësoja nevojat brenda katër orëve. Atje kishte edhe nxënës të tjerë që punonin si unë. Mirëpo, pas disa javësh, të moshuarit që kishin ngelur të kënaqur prej meje, kërkuan prej drejtorisë që t'u sillnin nxënës turq. Për këtë arsye, drejtori më tha që të sillja disa prej shokëve të mi turq. Tashmë aty punojnë vetëm të rinj turq.

- Kur e pyeta se pse i preferonin, ai më dha një përgjigje që më bëri të ndihem krenar për besimin dhe kulturën time.

- Të moshuarit na thonë se nuk na shihnin si të huaj që po u shërbenim me para, por si nipërit e tyre të vërtetë.

Ajo që i ndante ata nga të rinjtë e tjerë, ishte se ata punonin me dëshirë dhe jo si të detyruar. Ata sillleshin me mirësjellje dhe dashuri ndaj të moshuarve dhe nuk u thoshin kurrë "jo", qoftë edhe për gjëra të cilat nuk i kishin për detyrë t'i bënin. Pra, çështja është të hysh me shpirt në një botë ku nuk ka shpirt.

Më vonë edhe unë u njoha me ata të moshuar. Dëshira e të gjithëve mund të përmbledhet vetëm me disa fjalë: Na lini në dorë të fëmijëve turq. Veçoria e vetme që i ndante nga të tjerët, ishte se ata ishin myslimanë.

Në të njëjtën mënyrë jam habitur kur kam parë disa gjermanë të moshuar, që blinin në dyqanet e turqve. Përse blinin në dyqanet e turqve, kur kishte dyqane të tjerë më të lirë dhe me më shumë lloje mallrash? Përgjigja që iu dha kësaj pyetje nuk ndryshonte fare:

- Në market nuk të përshëndet njeri. Madje nuk mund të bisedosh me askënd. Çdo gjë është e fokusuar tek shitblerja, pra tek paraja. Ndërsa dyqanet turke nuk janë ashtu. Aty njerëzit bëhen si të afërm. Ata na pyesin për hallet tona dhe ne i pyesim për hallet e tyre. Madje bisedat më të përzemërta i bëjmë në këmbë në ato dyqane. Aty gjithmonë të presin me fytyrë të qeshur dhe gjuhë të ëmbël. Prandaj, gjatë blerjes në dyqanet turke, ndiejmë se jemi njerëz dhe jo robotë.

Në fakt, të moshuarit, me pretekstin e blerjes, më tepër vrapojnë për dashuri dhe butësi. Vallë, a thua se nuk kanë fëmijë apo të afërm? Kanë, por nuk kanë! A s'është më e hidhur kjo?

A mund ta mendoni një prind në këtë gjendje? Përshtohet dhe harrohet nga fëmijët e tij, që i ka rritur në pëllëmbë të dorës gjatë gjithë jetës. E çfarë mund të jetë më e hidhur se kjo në sipërfaqen e tokës?..

Ndonjëherë, këtë e bëjnë ata që nuk mund ta ndajnë dashurinë për bashkëshorten nga dashuria për prindërit. Si mund ta kërkojë një gjë të tillë një bashkëshorte? Si mund të thotë: "Sa të jem unë, ata s'kanë vend këtu!?" A nuk e di se nesër do ta gjejë atë që po bën sot? I nderuari Mevlana thotë: "Çfarë u mboll e nuk u korr?." A mund të korrë dashuri, ai që mbjell urrejtje?

Nëna ime e moshuar, e cila me vite të tëra është e sëmure dhe ka zënë shtratin, thotë:

- Duhet të jesh nënë, që të kuptosh nënën!

U martova, u bëra baba dhe i thashë nënës:

- Nënë nuk u bëra, por baba u bëra. A mund ta kuptoj nënën tani?


- Jo mor bir, jo. Nuk mund ta kuptosh nënën, pa u bërë nënë!

Ja pra, për këtë arsye, detyra e fëmijës është të mundohet të kuptojë nënën dhe babanë. Të mundohesh që t'i kuptosh ata, të hysh në zemrën e tyre dhe të marrësh bekimin e tyre, është detyra e çdo fëmije. Sigurisht që kjo detyrë duhet bërë pa neglizhuar bashkëshorten dhe fëmijët. Madje pa lënë punën dhe, mbi të gjitha, pa lënë detyrat si besimtar. Në fakt edhe përkujdesja për prindërit është një adhurim më vete.

Sot ka prindër që nuk i nxënë as shtëpitë e gjera. Më parë, me ta mund të jetoje edhe në një shtëpi me dy dhoma. Po sot, pse nuk i nxënë as shtëpitë e stërmëdha? Sepse u zmadhuan shtëpitë, por u zvogëluan zemrat.

Më parë duhet të zgjerohet shpirti me dashurinë e vërtetë. Por shpirti nuk zgjerohet përveçse me besim. Atëherë, prindërit që duan mirësi prej fëmijëve të vet, duhet që më parë t'i edukojnë ata që të bëhen robër të Allahut dhe umet i Muhamedit (a.s.). Nëse nuk mund të bëhen robër të Allahut dhe umet i Muhamedit (a.s.), nuk mund të bëhen as fëmijë të mbarë.





DITË TREGU NË PAZARIN
ESHKODRËS, 1932

FOTOJA E MUJAJIT

Nga duhet të fillojmë që ta lexojmë dhe mësojmë islamin? -2-

Mustafa Erish

Kjo është ngjarja, largimi i njerëzve/shoqërive nga shpallja, pozicionimi i tyre kundër saj dhe devijimi i tyre si rezultat i këtij fenomeni, apo qëndrimi i shpalljes në një luginë dhe i atyre në një luginë tjetër.

Për shkak se ky proces funksionon me kohë të gjatë dhe pa zë, krahas këtij largimi dhe qëndrimi në luginë të ndryshme vazhdon derisa njerëzit/shoqëritë, pa e kuptuar mendojnë se janë në rrugë të drejtë, mendojnë se konceptimi dhe jetesa e tyre fetare është në përputhje me shpalljen, se e ruajnë identitetin e tyre dhe se e kënaqin Allahun duke mashtruar veten.

Siç ishte kështu gjendja e popujve të mëparshëm, që kishin devijuar nga shpallja edhe struktura e popullit arab në kohën e xhahilijetit, kur Hz. Muhamed u bë Pejgamber nuk kishte ndonjë ndryshim nga ajo. Edhe ata pohonin se akoma janë në rrugën e Hz. Ibrahim dhe se janë të lidhur ndaj fesë së tij. Por Kurani thotë se Hz. Ibrahim ishte Hanif/i lidhur me fenë e tevhidit, se nuk ishte prej politeistëve. I paralajmëron ata se janë në rrugë të gabuar dhe se mendojnë shumë gabim. Allahu Teala, thotë:

“Me të vërtetë, Ibrahim ka qenë prijës shembullor (me të gjitha virtytet e mira), i përlulur para Allahut, me besim monoteist dhe nuk ka qenë prej idhujtarëve.” (16 en-Nahl, 120.)

E d h e

gjendja e ehli kitabit nuk ka ndonjë ndryshim me ato që thamë më sipër. Ata pohonin se ishin në rrugën e Hz. Ibrahim dhe se rridhnin nga soji i tij. Këtë e thonë shpesh edhe zëdhënësit e mbledhjeve të “Dialogut Ndërfetar” që organizohet në seri kohët e fundit.

Edhe pse Kurani thotë se fetë e tyre janë manipuluar dhe se ky fakt është i vërtetuar edhe me përmbajtjen e librave të tyre, ata e shohin kristianizmin dhe judaizmin si vlerë të njëjtë me Kuranin, thonë se janë ithtarë të së njëjtës fe dhe se janë fëmijët e Pejgamberit Ibrahim.

Ndërsa Kurani thotë qartë se pohimet e atyre nuk janë të vërteta, përkundrazi ata po mashtrojnë veten e tyre. Allahu i Madhëruar, thotë:

“Ibrahimi nuk ka qenë as hebre, as i krishterë, por ka qenë besimtar i vërtetë (monoteist) i përlulur ndaj Allahut dhe nuk ka qenë prej politeistëve.” (3 Ali Imran, 67.)

“A nuk i sheh ata (hebrenjtë) që u është dhënë një pjesë e Librit?! Atyre u bëhet thirrje të vijnë te Libri i Allahut për t’u gjykuar, por një pjesë e tyre kthejnë shpinën, duke mos ia vënë veshin. Kjo, sepse ata thonë: “Neve nuk do të na prekë zjarri i Xhehenemit, përveçse disa ditë”. Shpifet që bënin, i kanë mashtruar ata në besimin e tyre.” (3 Ali Imran, 23-24.)

Kjo është gjendja e përgjithshme e gjithë gjeografisë islame. Megjithëse emri dhe identiteti është islam, ky është shkaku që mësimet e shpalljes janë në një luginë, ndërsa shumica dërmuese e myslimanve jetojnë në një luginë tjetër dhe kanë rënë në gjendjen e sotme.

Miku ynë i nderuar, Umer Shevki Hotar, e shpreh kështu faktin se myslimanët gabojnë, kur konceptimet fetare nuk i marrin drejt nga Kurani, por së pari nga rrugë dhe burime të tjera:

“Shkaku kryesor i kontradiktave të njerëzve në çështjen e islamit, qofshin myslimanë apo ithtarë të feve të tjera, është konceptimi i gabuar ndaj fesë

dhe rruga e gabuar që ndiqet për të mësuar fenë islame.

Çdo fe, çdo ideologji, çdo mendim filozofik, madje çdo dije teknike, në formën më të saktë mësohet nga burimi i saj.

Për të mësuar se çfarë është kristianizmi, Ungjilli që e ka përhapur jep të dhënat më të sakta para librave që janë shkruar rreth kristianizmit. Judaizmin mund ta mësoni në mënyrën më të qartë dhe direkte nga Dhjata e Vjetër ose Talmuti, Torah dhe Mishna që përbëjnë mentalitetin e sotëm çifut, Marksizmin nga veprat e Karl Marksit dhe kapitalizmin nga ekonomisti Anglez, Adam Smith.

Nëse përpiqeni që këto të dhëna t'iu merrni nga dora e dytë apo e tretë, së pari do të zgjatni rrugën dhe së dyti shtohet mundësia për të marrë të dhëna të gabuara, për shkak se në to përzihen komentimet e personave të dytë apo të tretë.

Të mësosh kristianizmin nga një prift, ndërkohë që në dorë keni Ungjillin e sotëm, është një rrugë e lehtë por e gabuar, sepse ajo që do të mësoni, më shumë se kristianizmi, është komentimi i atij prifti rreth Ungjillit apo rreth kristianizmit. Këto komentime mund t'ju devijojnë në çështjen e kristianizmit.

Kjo metodë, krahas feve, mendimeve filozofike dhe ideologjive, është e vlefshme edhe për njohjen dhe vlerësimin e njerëzve. Nëse doni të dini për një njeri, në vend që të vendosni sipas atyre që thuhën, flisni ballë për ballë me të, sepse kjo është rruga më e saktë.

Ndërkohë që ky rregull më i lehtë logjik pranohet teorikisht, për fat të keq në praktikë nuk përdoret aq shumë..."

Një shkrimtar tjetër, i cili është miku ynë, e shpreh kështu faktin se në çdo konceptim, në çdo mënyrë jetese, në çdo vlerësim dhe në çdo përcaktim, Kurani nuk duhet të jetë objekt por subjekt:

"Të nxjerrësh Kurandin nga subjektiviteti duke e objektivizuar, ta nxjerrësh nga të qenët përcaktues në pozitën e atij që përcaktohet, të vërtetojmë paragjykimet tona me Kuran dhe t'ia afrohem atij për të aprovuar mendimet tona, përsëri përbën një vlerësim tjetër të gabuar, i cili është i përhapur.

Kurani duhet të mbahet gjithmonë në qendër, në pozitën e subjektit dhe në pikën e autoritetit përcak-

tues, në mënyrë që mendjen, besimin, personalitetin dhe jetën tonë, ta ndërtojë me masat e shpalljes. Të na pastrojë, të na japë nder e krenari dhe të na bëjë që të fitojmë kënaqësinë e Zotit.

Nëse nuk veprojmë kështu, por i afrohem Kuranit me një mendje që e kanë ndotur e kushtëzuar paragjykimet, me synimin për të qëndruar larg ndriçimit të tij dhe për të kërkuar dispozita që mund të mbështesin mendimet tona, të cilat janë produkt i epsheve, Kurani nuk do të na i hapë thesaret e tij, nuk do të na udhëzojë dhe nuk do të na ndriçojë.

Përkundrazi, për të aprovuar përvetësimet që kemi, ne duhet t'iu kuptojmë mirë ajetet e Allahut, të vërtetojmë të drejtën tonë dhe dëshirat t'ia përshtasim Kuranit. Por nëse përpiqemi që Kurandin t'ia përshtasim dëshirave tona, ai do të jetë shkaku kryesor për të na zvarritur në pozita të poshtëruara dhe të trishtuara.

Zoti i Madhëruar na ruajtë të gjithëve, që të mos zvarritemi në gjendje të tilla devijuese dhe mos na bëftë prej atyre që nuk përfitojnë nga Kurani, për shkak të një konceptimi të gabuar, ndërkohë që e lexojmë atë çdo ditë. (Fundnot: Mehmet Pamak, Kulluk Eksenli Hayatta Ramazan ve Kur'an, 34-35, İlim ve Kültür Yayınları, Ankara, 2005, Botimi i tretë).

Mund të shtrohet pyetja: "I kuptuam ata që mjaftohen duke e lexuar Islamit

nga të tjerët, por a është kështu edhe mjaftimi me leximin e tefsirit për të kuptuar Kurandin?" Pa e zgjatur fjalën, në mënyrë të kushtëzuar mund të them "po", sepse ata që mjaftohen me komentimet e komentuesve, pa u përpjekur për ta kuptuar Kurandin vetë, pa i testuar fjalët e komentuesve me të dhe që me këto formojnë shabllonet e konceptimit e të vlerësimit, shumë mësimet të Kuranit janë të detyruar t'iu kuptojnë në mënyrë të përshtatshme me shabllonet që kanë në kokën e tyre.

Këtë mund ta kuptojmë nga fakti se kometuesi i njohur Fahreddin Razi, ajetet që flasin për shefatin në Kuran, i ka kuptuar dhe shfaqur sipas konceptimit të një medhhebi të caktuar, i cili është formuar si rezultat i kontradiktave ndërmjet medhhebeve të tjera. Një studiuues e vlerëson kështu shpjegimin që u bën Razi ajeteve, në të cilat përmendet shefati duke marrë për bazë mendimin e një medhhebi të caktuar:



Shefati për të cilin po flasim, është bërë objekt debati në shkallë përkrahësish të kundërt. Kështu është bërë shkak që tema të kalojë nga dimensionin e konceptimit në dimensionin e mbrojtjes.

Kjo situatë, i ka nxjerrë ajetet në fjalë nga konceptimi brenda kornizave të tërësisë së temës e të mendimit ndaj kësaj bote që ka formuar Kurani dhe i ka vënë plotësisht në pozitën e mbrojtjes sipas konceptimeve dhe përvetësimeve fraksionale. Kjo në vetvete, është bërë shkak për disa qorrsoke.

Fjalët e Fahreddin Razit në lidhje me ajetin 110 të sures Taha, mund t'i japim si shembull për këtë çështje. Sipas Raziut, për kë të jetë bërë shefati, atij i jep dobi, sepse veçimi që bëhet me anë të nefjit (negatives), do të thotë vërtetim.

Kur Razi i tha këto, nuk e mori parasysh kontekstin e ajetit në fjalë dhe duke e tërhequr debatin në një fushë teorike ndërmjet ehli sunetit e mutezilesë dhe duke pohuar se do të ketë shefat e se patjetër ai ka dobi, e sjell problemin te pika nëse shefati vlen apo jo për njeriun mëkatar dhe si mendim i ehli sunetit i drejtohet faktit se mëkatarin mund të përfitojë nga shefati. Për këtë arsye, ai arrin në rezultatin që **thamë** më sipër, duke e vërtetuar këtë nga veçimi negativ.

Por dy kushtet e ndryshme të veçimit në ajet, që janë: "Leja e Allahut dhe kënaqësia nga fjala", në kuptimin konceptual, duke mos u marrë parasysh se çfarë vendi zënë brenda tërësisë së Kuranit, shprehet se, kush thotë fjalën "lailahe illallah" do të përfitojë nga shefati, për shkak se ka thënë një fjalë prej të cilës Allahu është i kënaqur.

Ne mund të themi se ajo gjë që e imponon Raziun të bëjë kaq komentim dhe të qëndrojë në bazën e konceptimit, i cili e shkëput nga tërësia, është refleksi i mbrojtjes së mendhhebit. Ajetet për të cilat flitet në një mjedis të tillë, bëhen temë e polemikave aktuale duke u shkëputur nga bota e kuptimit të Kuranit.

Në lidhje me këtë çështje, Ibnu'l-Kajjim el-Xhevziije thotë: "Ti e pranon Kurantin sikur të ketë zbritur në përputhje me mendimet, pohimet dhe fraksionet e të gjitha grupeve të devijuara. Apo sikur Kurani është

një xehmi te xehmitë, një mutezili te mutezilitë, një kaderi te kaderitë dhe një rafidi te rafiditë."

Ndërkohë, gjëja që komentuesi duhet të ketë parasysh nuk është mbrojtja e medhhebit dhe qëndrimin të tij, por përpjekja për të kuptuar synimin e Allahut, sa të jetë e mundur.

Kurani Fisnik nuk është një libër për të vërtetuar apo refuzuar mendimet e këtij apo atij medhhebi, por është një shpjegim hyjnor për të shfaqur një kuptim botëror për botën e ekzistencës, në mënyrë që njerëzit të formojnë një metodë sjelljeje të përshtatshme me të, duke kuptuar përgjegjësitë që kanë. (Shënim: Yaşar Düzenli, Kur'an ve Şefaaf, 285-286, Pinar Yayınları, Stamboll, 2006).

Siç dihet, sado që një komentues i Kuranit të qëndrojë larg faktorëve negativë të kulturës, e cila vazhdon si një trashëgimi, në fund komenton me të dhënat e asaj kulture, duke u ndikuar nga ajo.

Për këtë arsye, nuk ka asnjë tefsir që të mos jetë ndikuar nga anët negative të kulturës, e cila ka filluar nga shekulli i parë e deri më sot, të mos ketë bërë vlerësime subjektive dhe të mos përfshijë të dhëna të pasakta apo të paaprovuara.

Kjo është një gjendje normale, sepse sado që njeriu të ketë dije, së fundi është njeri dhe njeriu është një krijesë që harron, gabon, mëson gabim, merr të

dhëna të gabuara, është i kushtëzuar, bën vlerësime të mangëta etj. Shkurtimisht, njeriu nuk është i pagabueshëm. Për këtë arsye, komentuesit në librat e tyre japin shumë të dhëna si rivajete/hadithe apo tregime/histori nga historia e popujve të mëparshëm. Krahas atyre të cilët i kanë filtruar këto me filtrën e Kuranit, shumica dërmuese bëjnë komentime nga aspekti i këndvështrimit fraksional, imitojnë gjërat e njëri-tjetrit, tregojnë shumë rivajete e histori, të cilat njihen si israilijat (tregime të pasakta të marra nga feja e çifutëve) dhe këto ua shfaqin lexuesve, duke i përvetësuar sikur të ishin shpjegimet e ajeteve.

Kështu, me këto gjëra formohen e drejtohen të dhënat dhe kultura e lexuesve. Edhe pranimet apo refuzimet e tyre bëhen sipas këtyre. Shembuj për këtë ka kaq shumë, sa që nuk mund të numërohen.

Për shembull, cilësitë "Rahman" dhe "Rahim" që

Kurani Fisnik nuk është një libër për të vërtetuar apo refuzuar mendimet e këtij apo atij medhhebi, por është një shpjegim hyjnor për të shfaqur një kuptim botëror për botën e ekzistencës, në mënyrë që njerëzit të formojnë një metodë sjelljeje të përshtatshme me të, duke kuptuar përgjegjësitë që kanë.

gjenden në suren el-Fatiha dhe në ajetin e 30 të sures en-Nahl, janë dy cilësi që shprehin madhësi. Njëra shpreh fatkin se Allahu i Lartësuar është shumë i mëshirshëm, ndërsa tjetra tregon se kjo cilësi është e pandashme nga ai.

Kurse komentuesit për cilësinë “Rahman” thonë se është e përgjithshme në këtë botë, për besimtarët dhe për qafirët, ndërsa cilësia “Rahim” do të thotë se Allahu Teala në ahiret do të mëshirojë vetëm besimtarët.

(Shënim: Shik. Shembullin: “Rahman do të thotë, Ai (Zoti), i cili u jep prej mirësive të tij në këtë botë njerëzve, pa bërë ndonjë dallim, qoftë i mirë apo i keq, qoftë besimtar apo qafir.

Ndërsa Rahim do të thotë, Ai (Zoti), i cili në ahiret u jep prej mirësive të tij vetëm besimtarëve.” (TDV. Kur’anı Kerim ve Açıklamalı Meali, Sureja el-Fatiha, VIII, Ankara, 2005; Elmalılı, Hak Dini Kur’an Dili, 1/51, 53, 54; Abdullah Parlayan, Kur’anı Kerim ve Özlü Tefsir, Besmeleja dhe Sureja el-Fatiha, Damla Ofset, Konja).

Edhe ata që i lexojnë tefsiret apo përkthimet e Kuranit që janë bërë në këtë mënyrë, mësojnë se të dy fjalët gjithmonë kanë këto kuptime. Ndërkohë, as Kurani, as suneti dhe as gjuha nuk thonë se cilësitë “Rahman” e “Rahim” mbartin këto kuptime. Ata që shkruajnë se kanë këto kuptime, përsërisin të njëjtin gabim, duke imituar njëri-tjetrin në ato që shkruajnë.

Ebu’l-Kasim el-Hui, i cili tregon se fjalët Rahman dhe Rahim nuk kanë këto kuptime, thotë kështu:

“Mënyra failun, tregon cilësitë që ka një qenie dhe të cilat nuk ndahen prej tij. Edhe urtësia që fjala Rahim ka ardhur pas fjalës Rahman, është kuptuar në këtë mënyrë, sepse fjala Rahman shpreh përgjithësinë dhe gjerësinë e mëshirës, por jo pandashmërinë nga qenia.

Fjala Rahim ka ardhur pas saj për të treguar se cilësia e mëshirës është një cilësi e pandashme nga qenia e Allahut Teala. Retorika e Kuranit ka synuar të shprehë edhe këto dy qëllime, në këtë ajet të begatë. Allahu është Rahman në kuptimin “mëshira e tij ka përfshirë çdo gjë” dhe është Rahim në kuptimin “atributi mëshirë nuk ndahet kurrë prej tij”.

Shumë prej komentuesve të Kuranit, për shkak se nuk e kanë perceptuar këtë gjë delikate, me justifi-

kimin se shumica e shkronjave në fjalë argumenton gjerësinë e madhe të kuptimit, kanë pandehur se kuptimi i fjalës Rahman është më i gjerë se kuptimi i fjalës Rahim. Por ky është një justifikim qesharak, sepse argumentimi i fjalëve është i lidhur me kuptimin e parë që ka fjala dhe nuk ka asnjë lidhje me pakicën apo shumicën e shkronjave. (Shënim: Ebu’l-Kasim el-Hui, el-Bejan fi Tefsiri’l-Kur’an, 438, Muessesetu’l-A’lemi, Bejrut, 1974, Botimi i tretë).

Gabimin për ta mësuar islamin nga e kundërta, nga islami i shoqërisë apo nga mësimet e shkencave teologjike, në vend që të lexohet dhe të mësohet nga Kurani, Muhamed Gazaliu e tregon kështu, në shembullin e leximit pak nga Kurani dhe shumë nga hadithi:

“Të lexosh pak nga Kurani dhe shumë nga hadithi, nuk siguron një konceptim të drejtë për islamin. Kjo i ngjan ushqyerjes së keqe, sepse ndërmjet faktorëve që ushqejnë mendjen dhe trupin, duhet të ketë një ekuilibër. Le ta shpjegojmë me shembuj këtë:



San’ani thotë se nezri (kurbani që bëhet për të mbajtur zotimin) është haram, duke u mbështetur në transmetimin e Ibn Umerit, i cili shpreh: “I Dërguari Allahut e ka ndaluar flinë dhe ka thënë”: «Ajo nuk ka ndonjë dobi, vetëm pakëson pasurinë e kopracit». (Shënim: Buhari, ejman, 26/2, kader, 6, Muslim,

kader, 2-6, Ebu Davud, ejman, 18, Tirmidhi, nuzur, 11, Nesai, ejman, 24-26, Ibn Maxhe, keffarat, 26/2, Ibn Hanbel, dhe në shumë vende të tjera.)

Por nezri që nuk ka dobi, ashtu siç veprohet në ndërrim tek punët tregtare, është nezri që bëhet në këtë mënyrë: Nëse shërohem apo nëse biri im bëhet i suksesshëm, do të bëj këtë gjë për Allahun. Por përderisa të jetë i saktë nga aspekti juridik, nuk ka ndonjë problem që të bësh nezr duke synuar bindjen ndaj Allahut.

Ne duhet të pyesim: Si mund të thuhet se nezri si parim është haram, ndërkohë që Allahu i lartësuar, kur i cilëson dhe i lavdëron njerëzit e mirë, thotë: **“Ata e zbatojnë premtimin dhe i frikësohen Ditës (së Kiametit), tmerri i së cilës përhapet gjithkund.”** (76 el-Insan, 7.), dhe në një vend tjetër: **“Pastaj, haxhinjtë le të pastrojnë trupin e tyre, le t’i kryejnë zotimet e tyre dhe le t’i bëjnë tavaf Qabes.”** (22 el-haxh, 29.)



Një Ajet

*Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!*

“Kur disa djelmosha u strehuan në shpellë dhe thanë: “O Zoti ynë, na jep mëshirë nga ana Jote dhe na përgatit për sjellje të drejtë!” (Kehf, 10)

Një nga suret e Kuranit është surja Kehf (shpella) në hyrje të së cilës flitet për një grup djemsh që strehoheshin aty (tek shpella). Si në çdo tregim të Kuranit edhe në këtë tregim nuk jepet informacion se ku dhe kur ka ndodhur ngjarja, sepse qëllimi i Kuranit nuk është informacioni historik, por shpalosja e së vërtetës universale të esencës njerëzore dhe fetare. E shprehur ndryshe, të kontribuojë në njerëzishmërinë e njeriut dhe në ngritjen e tij shpirtërore.

Nëpërmjet tregimeve, Kurani i mëson njeriut edukatën e komunikimit. Kurani nuk i pranon debatet dhe polemikat që nuk sjellin asnjë dobi, siç ndodh shpesh sot. Prandaj, Kurani nuk i trajton fare detajet e parëndësishme, si numrin e djelmoshave dhe kohën që qëndruan në shpellë. Preokupimi me tema që nuk sjellin asnjë lloj dobie në këtë botë dhe botën tjetër, në njëfarë mënyre është shmangie nga vetvetja. Kurse Kurani fokusohet tek njeriu, duke tërhequr vëmendjen në dobësitë, me të cilat mund të përballtet njeriu në çështjet e besimit dhe moralit.

Sipas tregimit, një grup djemsh strehohen në një shpellë dhe i luten Allahut: **“O Zoti ynë, na jep mëshirë nga ana Jote dhe na përgatit për sjellje të drejtë!”**. Si përgjigje ndaj kësaj lutjeje të sinqertë, Allahu i udhëzoi dhe i ngriti shpirtërisht.

Sipas komentuesve të Kuranit, këta djelmosha jetonin në një shoqëri pagane, ku besimtarët shtypeshin në mënyrë arbitrare. Për të mbrojtur besimin monoteist nga rreziku i shfarosjes, djelmoshat strehohen në shpellë, duke shpresuar në mëshirën e pakufishme të Allahut fuqiplotë. Ata ishin të bindur se krenaria, nderi dhe fuqia nuk fitohen me pasuri dhe me pozita, por duke u lidhur sinqerisht tek besimi në një Zot. Në asnjë çast nuk lejuan të shuhej drita e besimit që ndriçonte zemrat e tyre.

Ata nuk ishin peygamberë, por ishin të mbrojtur me moralin e profetëve, kështu që, për të mbajtur një qëndrim fisnik përballë vështirësive, nuk është kusht të jesh peygamber, mjafton të jesh i lidhur pas së vërtetës dhe të jesh njeri i ndershëm.

Këta djem braktisën çdo gjë të kësaj bote për besimin e tyre, duke u strehuar në një shpellë të ngushtë, të errët, por që gjetën dritën dhe gjerësinë e besimit. Hapësira e gjerë e tokës, atyre u vinte e ngushtë dhe ngushtësia e shpellës u dukej pafundësisht e gjerë. Nëpërmjet këtij besimi pengesat e hekurta zhduken, vetmia shndërrohet në gëzim dhe çdo gjë përreth kapohet nga qetësia dhe prehja.

Shpirti sakrifikues është tipar i çdo njeriu, pa dallim, por është realitet që ky shpirt tek të rinjtë shfaqet ndryshe. Sepse rinia është një periudhë, ku kultivohen, marrin formë dhe zhvillohen ëndrrat, dëshirat dhe idealet. Është periudha ku hidhen hapat e guximshëm drejt përparimit, drejt së resë. Është periudha ku bëhen përpjekje për gjetjen e kuptimit të vërtetë të jetës. Të rinjtë e duan të mirën, sepse nuk e njohin të keqen, besojnë bindshëm, sepse nuk janë mashtruar. Kurani na tregon se shumë njerëz kanë luftuar në rrugën e drejtë së bashku me Peygamberët. Kontributi që kanë dhënë ata në përhapjen e dritës së besimit, është i madh. Këta mund të kenë jetuar në vende dhe kohë të ndryshme, por u përkasin të gjitha kohërave. Sepse ata përfaqësojnë shpirtin e lidhur fort pas Allahut të madhërishtëm. Ata i karakterizon sakrifica për hir të Allahut.

Një Hadith

*Transmetohet nga Ebu Hurejra (r.a.)
se Resulullahi (s.a.v.s.) i ka pyetur shokët:*



“A e dini kush është i falimentuar (i varfër)? Sipas nesh, i falimentuar është ai që nuk ka para dhe kapital. Muhamedi (a.s.), tha se i falimentuar në mesin tonë është ai që vjen në ditën e gjykimit me sevapet e namazit, agjërimit dhe zekatit, por ka fyer, ka trilluar lloj-lloj shpifjesh, ka ngrënë mallin e tjetrit me të padrejtë, ka derdhur gjakun e dikujt, ka rrahur dikë. Këtij njeriu do t’i merren të gjitha të mirat dhe t’u jepen atyre që kanë pësuar padrejtësi dhe, nëse i mbarojnë të mirat, pa shlyer detyrimet ndaj tyre, atëherë mëkatet e atyre që kanë pësuar padrejtësi, i kalojnë këtij dhe përfundimisht hidhet në zjarr.”

Muhamedi (a.s.), ka shpjeguar se i varfër nuk është ai që përkufizohet rëndom në mesin e njerëzve si një njeri që nuk ka pasuri, por i varfri i vërtetë është ai që vjen në ditën e gjykimit siç shpjegon hadithi. Këta janë plotësisht të falimentuar në ditën e gjykimit. Të gjitha të mirat që kanë, do t’u jepen atyre që u kanë bërë padrejtësi. Sikur të mos mjaftojë kjo, do t’i ngarkohen edhe gjynahet e tyre, pastaj do të hidhet në xhehenem.

Pejgamberi (a.s.), u drejtohet me pyetje, jo për të mësuar kuptimin që dihej nga të gjithë, por për t’i udhëzuar që i falimentuari i vërtetë është në botën tjetër.

Nëpërmjet namazit, zekatit, agjërimit dhe ibadeteve të tjera, njeriu përfiton sevape të mëdha. Por për të hyrë në xhenet, këto nuk janë të mjaftueshme. Përveç këtyre, duhet të ketë kujdes të ruhet nga çdo gjë që ka ndaluar Allahu (xh.sh.), veçanërisht cenimit të së drejtës së tjetrit. Allahu nuk i fal këto lloj mëkatesh, pa i falur më parë ai që ka vuajtur padrejtësinë.

Të gjitha sjelljet e lartpërmenduar në hadith, si fyerja, ofendimi, trillimi, shpifja, vrasja dhe padrejtësia fshijnë çdo të mirë që fitohet nëpërmjet adhurimeve.

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Duhet pasur kujdes nga çdo gjë e ndaluar.
2. Të drejtat që zotërojnë njerëzit mund të jenë materiale ose jomateriale.
3. Adhurimet nuk janë të mjaftueshme për të hyrë në xhenet.
4. Cenimi i të drejtave të të tjerëve fshin të gjitha të mirat e fituara nga adhurimet.
5. I falimentuari i vërtetë është ai që ka sevape, por që mbi vete mban padrejtësitë që u ka bërë të tjerëve dhe, kur të mirat që ka u jepen atyre, e ka merituar xhehenemin.

Nga lulishita e zemrës

Osman Nuri Topbash



Nga morali shembullor i të dashurve të Allahut

TË MOS HARROSH PËRKOHSHMËRINË

Një nga pengesat më të mëdha që duhen kaluar në jetën e kësaj bote, është **iblisi** (shejtani), ndërsa tjetri është **nefsi** (egoja). Në përgjithësi, kur flasim për nefsin, na vijnë në mend tendencat negative të njeriut. Një pjesë e madhe e anëve negative të nefsit, e kanë burimin tek **“kryeneçësia ndaj përkohshmërisë”** dhe dëshira **“për të qenë i pafund”**.

Dhe me të vërtetë, njeriu nuk e dëshiron kurrë zhdukjen e të mirave që zotëron dhe gjithmonë dëshiron pafundësi dhe pavdekësi. Dikush e kërkon pafundësinë e vet tek fëmijët dhe dëshiron që soji i tij të vazhdojë deri në ditën e kiametit. Dikush tjetër e kërkon tek dhënia dhe mania pas trupit të vet dhe dëshiron të jetojë me shekuj. Dikush tjetër e kërkon tek fama, duke lënë vepra të pavdekshme dhe dëshiron që fama e tij të njihet edhe pas vdekjes. Dikush tjetër e kërkon tek grumbullimi i pasurisë dhe mbështetet tek fuqia e pasurisë së tij, duke e konsideruar atë si tregues të ekzistencës së vet. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Mjerë për çdo përqeshës - shpifës që grumbullon pasuri dhe e ruan, duke menduar se ajo do ta bëjë të pavdekshëm!” (el-Humeze, 1-3.)

Mirëpo të kërkosh pafundësi në këtë botë të përkohshme ose të kujtosh se ditët e lumtura nuk do të mbarojnë kurrë dhe se të mirat që zotëron nuk do të zhduken, është një shpresë e kotë dhe i ngjan mashtrimit me mirazhet që shfaqen në shkretëtirë. Sa bukur shprehet një poet:

“Mos kërkko pafundësi nga kjo botë! Ajo nuk e zotëron as vetë, që të ta japë edhe ty!”

Prandaj, nuk duhet të harrojmë kurrë se në këtë botë jemi veçse mysafirë, se koha e jetës do të mbarojë një

ditë papritur dhe se jeta e vërtetë dhe e pafundme është jeta e botës tjetër. Në fakt, nuk ka asnjë krijesë që Allahu Teala ta ketë përjashtuar nga përkohshmëria. Të harrosh përkohshmërinë, është shprehje mendjelehtësie dhe i ngjan atij që zhyt kokën në rërë, duke kujtuar se në atë mënyrë do të shpëtojë nga rreziku. Mirëpo për fat të keq, në të shumtën e rasteve, koncepti i njeriut për vdekjen nuk është shumë më i ndryshëm. Shumë prej njerëzve, në vend që ta zbukurojnë vdekjen e tyre me nënshtrim fisnik ndaj Allahut, bëjnë një jetë të shkujdesur nën frikën e vdekjes.

DY SHFAQJE TË KUNDËRTA

Vehbi bin Munebbih (Allahu e mëshiroftë!) tregon:

Kur një mbret dëshiroi të shkonte diku, midis shumë veshjesh zgjodhi më të bukurën dhe midis shumë kuajve zgjodhi më të pashmin dhe më të fuqishmin. Pastaj doli për udhë me njerëzit e tij, duke ecur me krenari dhe mburrje. Në rrugë i doli përpara një njeri i mjerë dhe e kapi kalin prej kapistre. Mbreti bërtiti me ashpërsi:

-Kush je ti që më del përpara? Largohu nga rruga!

Ndërsa njeriu i mjerë, me butësi i thotë:

-Kam disa gjëra për të të thënë! Është diçka me rëndësi për ty...

Mbreti, me kureshtje të madhe, tha:

-Pa na i thuaj!

-Është diçka e fshehtë. Përkulu pak, që të ta them në vesh!

Mbreti u përkul dhe njeriu i tha:

-Unë jam Azraili, kam ardhur të të marr shpirtin!



Mbreti u shastis dhe me panik të madh filloi t'i lutej:

-Të lutem, më jep pak kohë!..

Azraili i thotë:

*-Jo! Për ty nuk ka më kohë!
Nuk ke për t'u takuar as me
familjen tënde!- dhe ia mori
shpirtin në vend.*

Sa kuptimplote është kjo
këshillë e Ebu Bekrit (r.a.):

*"Ik prej famës, që të të
ndjekë nderi. Përgatitu për
vdekjen, që të të falet për-
jetësia".*

Më vonë Azraili, vazhdoi
rrugën dhe u takua me një
njeri besimtar. Pasi i dha se-
lam, i tha:

*-Kam një punë me ty. Do
të ta them fshehtas,- dhe iu
afrua te veshi duke i thënë
se ishte Azraili. Besimtari u
gëzua dhe tha:*

*-Mirë se erdhe! Kam kohë që
të pres. Jam munduar shumë
për t'u pastruar nga mangë-
sitë e të metat dhe për ta bërë
më të bukur çastin e vdekjes.
Gjithmonë kam jetuar duke
menduar për frymën e fundit
dhe duke u përgatitur për të.*

Azraili thotë:

*-Atëherë, plotësoje punën
që je duke bërë.*

*-Puna ime më e rëndësishme është bashkimi me Allahun,-
tha besimtari. Pas kësaj, meleku i vdekjes i thotë:*

*-Do të ta marr shpirtin, kur ti të jesh në gjendjen që dë-
shiron.*

-A është e mundur kjo?- pyet besimtari.

*-Po, kështu jam urdhëruar të veproj me ty,- tha mele-
ku.*

Pas këtyre fjalëve, besimtari tha:

*-Mirë atëherë, të marr ab-
dest, të filloj namazin dhe
ma merr shpirtin kur të jem
në sexhde. Dhe me të vër-
tetë ashtu ndodhi. (Gazali,
Ihja'u-Ulumi'd-Din, Vol. 4,
faq 834-5.)*

Sa bukur e përshkruan
Mevlana Xhelaledin Rumi,
vdekjen e të dashurve të
Allahut:

*"Për njerëzit e së fshehtës,
vdekja e trupit është dhu-
ratë hyjnore. A humbet gjë
floriri i pastër nga prerja me
gërshërë?"*

Nga një anë, shohim pa-
noramën e fundit të tmerr-
shëm të një jete të shkuj-
desur... Dhe nga ana tjetër,
shohim çastin e një fryme
të fundit, e cila e ka pranuar
përkohshmërinë dhe, duke
jetuar çdo moment me mi-
rësi, është e gatshme për
vdekjen larg prej hidhëri-
mit e panikut... Ja pra, për
dikë vdekja është një makth
i vërtetë e për dikë tjetër
është siç e quan edhe Mev-
lana i nderuar, një "sheb-i

arus"(natë dasme) i lumtur...

Ne duhet të meditojmë shumë mbi këtë fakt. Vallë, si
do të jetë panorama e takimit tonë të sigurt me melekun
e vdekjes? A do të takohemi me të kur të jemi në sexhde
apo kur të jemi duke bërë ndonjë gjynah? Vallë, cila do
të jetë fjalja e fundit që do të dalë nga buzët tona?..



*Të harrosh përkohshmërinë, është
shprehje mendjelehtësie dhe i ngjan
atij që zhyt kokën në rërë, duke kujtuar
se në atë mënyrë do të shpëtojë nga
rreziku. Mirëpo për fat të keq, në të
shumtën e rasteve, koncepti i njeriut për
vdekjen nuk është shumë më i ndryshëm.*

MOS QAJ PËR TË VDEKURIN, POR PËR VETEN!..

Hasan Basriu (Allahu e mëshiroftël), thotë:

"Azraili merr shpirtin e atij, të cilit i ka mbaruar risku dhe i është plotësuar jeta. Ndërsa familja e të vdekurit qan e hidhërohet. Azraili me gjuhën e tij, thotë:

- Përse qani? Këtij personi nuk i kam ngrënë as riskun, nuk i kam prerë as jetën. Risku i tij mbaroi, jeta i përfundoi, ndodhi caktimi i Allahut, erdhi urdhri i Tij dhe i mora shpirtin. Mos qani kot. Unë do të vij vazhdimisht këtu dhe nuk do të lë asnjë prej jush."

Hasan Basriu vazhdon, duke thënë:

Nëse familja e të vdekurit do ta shihte Azrailin dhe do të dëgjonte ato që thoshte, do ta harronte të vdekurin dhe do të qante për veten!"

Allahu i Madhëruar ka krijuar çdo gjë me urtësi. Prandaj, me qëllim që të mos e harrojmë vdekjen, por të jemi gjithmonë të gatshëm për atë moment dhe të mos lëmë pas dore as këtë jetë, e ka fshehur çastin e vdekjes. Kjo është prej mëshirës së Tij ndaj njerëzve.

Nëse një njeri do ta dinte më parë çastin e vdekjes, për shkak të hidhërimit të madh, do ta braktiste punën, madje edhe familjen e tij para çastit të vdekjes dhe jeta do të humbiste rregullin dhe harmoninë e vet. Nëse njerëzit do t'i dinin më parë ato që do të ndodhin, nuk do ishin të lumtur dhe nuk do të gjenin paqe prej halleve të shumta të jetës. Nëse një nënë do ta dinte se fëmija i saj do të vdiste në lule të rinisë, ose që do të bëhej një njeri i keq, nuk do të gjente kurrë paqe në jetën e saj. Me një fjalë, mosnjohja e çastit të vdekjes nga ana e njeriut, është një mirësi e madhe hyjnore, sepse Allahu e ka krijuar jetën e kësaj bote me urtësinë e sprovës dhe po me atë urtësi, e ka bërë të panjohur "kaderin" (caktimin) dhe "exhelin" (çastin e vdekjes). Prandaj, prej nesh kërkohet që të jemi gjithmonë të gatshëm për çastin e vdekjes.

Në një ajet të Kuranit fisnik urdhërohet:

"Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen dhe pastaj të gjithë do të ktheheni tek Ne". (el-Ankebut, 57.)

Ky ajet dhe shumë të tjerë të ngjashëm me të, të cilët përsëriten shpesh në Kuran, janë paralajmërime hyjnore, që nuk na lenë të mbytemi në vorbullën e dëshirave të egos sonë.

Të parët tanë i kanë ndërtuar varrezat në mes të qyteteve dhe përballë xhamive, me qëllim që ata të cilët kalojnë aty, të mos harrojnë përkohshmërinë, të shohin të ardhmen e tyre, të marrin mësim dhe të përmirësojnë gjendjen e tyre.

Sigurisht që edhe ne duhet të marrim mësim prej ndodhive të vdekjeve që dëgjojmë dhe shohim dhe të mos harrojmë se një ditë edhe ne do ta përjetojmë një moment të tillë. Vetëm në këtë mënyrë mund të shpëtojmë nga shkujdesja dhe të shkojmë drejt Allahut me shpirt të qetë.

Profeti ynë i dashur (a.s.), ka thënë:

"Kujtojeni shpesh atë që ju pret si thikë gëzimet e kësaj bote!" (Tirmidhi, Zuhd, 4.)

Ndërsa në një hadith tjetër, ka thënë:

"Fale namazin, si namazi i atij që po ndahet nga kjo botë!.." (IbënMaxhe, Zuhd, 15.)

Me anë të këtyre këshillave, Profeti (a.s.), ka treguar anën edukative të meditimit të vdekjes. Riti i namazit është udhëtimi shpirtëror nga kjo botë për në botën tjetër. Pesë kohët ditore të namazit tregojnë nënshtrimin, dorëzimin, besnikërinë dhe devotshmërinë ndaj Allahut Tealla. Namazi është një disiplinë shpirtërore që të bashkon me

Allahun, duke qenë se në këtë botë njeriu ndodhet në një lloj kurbeti shpirtëror.

Nga kjo pikëpamje, namazi është një lloj miraxhi midis kësaj bote dhe botës tjetër. Besimtari, i cili kthehet në jetën e përditshme pasi e ka falur namazin në mënyrë të rregullt dhe i përqendruar thellësisht, vazhdon të jetojë sikur është kthyer përsëri në jetë, pasi ka vdekur njëherë. Një namaz i tillë, e ruan njeriun nga gjynahet. Namazi, i cili kryhet në mënyrë të përsosur, është një mësim i vërtetë rreth vdekjes.

Besimtari që fal namazin e tij, siç e fal njeriu i cili po ndahet nga kjo botë, çdo gjë e sheh dhe e përjeton sikur po sheh nga dritarja e botës tjetër. A mund të jenë



bashkudhëtarë me iblisin në jetën e kësaj bote ata që zotërojnë një shpirt të tillë? A mundet që pasionet e kësaj bote t'ua pushtojnë zemrën?..

Një herë, Ibrahim bin Et'hemin e pyetën:

- Pse nuk na pranohen duatë?

Ai u përgjigj:

"Allahun e njihni, por urdhrat e Tij nuk i zbatoni! Profetin e njihni, por sunetin e tij nuk e veproni! Kuranin e lexoni, por me të nuk punoni! Hani nga të mirat që u ka falur Allahu, por nuk falënderoni! Xhenetin e dini, por nuk mundoheni ta fitoni! Xhehenemin e dini, por nuk shqetësoheni! Thoni se ka vdekje, por nuk përgatiteni! Baballarët dhe nënat tuaja i vendosni në varr me duart tuaja, por nuk merrni mësim! Kur puna është kështu, si të pranohet duaja e dikujt që është kaq i shkujdesur!?" (Tedhkiretu'l-Evlia.)

MISTERI MË I RËNDËSISHËM: FRYMA E FUNDIT

Jeta e të dashurve të Allahut kalon duke meditaruar mbi vdekjen, pjekurinë shpirtërore dhe duke u shqetësuar për misterin e frymës së fundit. Kjo, sepse ata e dinë shumë mirë se shejtani, i cili mundohet t'ia rrëshqasë njeriut këmbën gjatë gjithë jetës, në frymën e fundit të njeriut, i vërsulet besimit të tij me një egërsi edhe më të madhe. Ai i nxjerr nga rruga ata, në zemrat e të cilëve ka dyshim dhe i hedh në kyfyr (mohim). Më pas largohet dhe, njeriun të cilin e ka mashtruar, e lë kokë më kokë me fatkeqësinë e tij. Në një ajet fisnik urdhërohet:

"...shejtani i thotë njeriut: "Mos besoj!". Por, kur ky bëhet mohues, shejtani i thotë: "Unë nuk kam të bëj me ty! Në të vërtetë, unë i frikësohem Allahut, Zotit të botëve!"" (el-Hashr, 16.)

Për këtë arsye, i lutemi Allahut të Madhëruar që të na ruajë sinqeritetin tonë, sidomos në frymën e fundit. Në udhëtimin e jetës, kthesa e fundit në shtegun e exhelit, është shumë e fortë dhe e rrezikshme. Prandaj, gjëja më e rëndësishme, halli dhe shqetësimi ynë më i madh, duhet të jetë kalimi i suksesshëm i kësaj kthese. Në një ajet fisnik urdhërohet:

"O besimtarë! Kijeni frikë Allahun, ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!" (Al-i Imran, 102.)

Një nga sahabët, që ishte i njohur për përkushtimin

që kishte ndaj adhurimit, Uthman ibën Madh'un (r.a.), ndërroi jetë në qytetin e Mendines, në shtëpinë e një gruaje, të quajtur Ummu'l-Ala. Kjo grua tha:

- O Uthman! Beto hem se në këtë moment Allahu Teala po të gostit me të mira.

Profeti i Allahut (sallallahu alejhi uesellem), ndërhyri dhe tha:

-Nga e di ti se Allahu është duke e gostitur?

Kur grua ja iu përgjigj:

- Beto hem për Allahun, që nuk e di!

Profeti (a.s.), urdhëroi e tha:

-Shikoni! Uthmani ndërroi jetë. Unë personalisht për të shpresoj të mirën prej Allahut. Mirëpo, megjithëse jam Profet, as unë nuk e di se çfarë do të ndodhë me mua dhe me ju.

Ummu'l Ala thotë:

"Beto hem për Allahun, se pas kësaj ndodhie, nuk fola më në lidhje me askënd". (Buhari, Tabir, 27.)

Nga kjo kuptojmë se çështja e gjendjes në të cilën vdesin njerëzit, është mister. Të gjallët duhet të tregohen të kujdesshëm dhe të mos flasin në formë të prerë, në lidhje me dikë që ka vdekur, por të bëjnë dua për të ndjerin dhe të kërkojnë

mëshirë për të.

Në një hadith fisnik thuhet:

"Njeriu vdes ashtu siç ka jetuar dhe ringjallet ashtu siç ka vdekur". (Munavi, Fejzu'l-Kadir, V, 663.)

Në përgjithësi, kështu ndodh. Mirëpo, përveç profetëve dhe atyre të cilët janë përgëzuar prej tyre, nuk ka garanci në lidhje me frymën e fundit. Pra, njeriu nuk duhet t'i besojë mënyrës së drejtë të jetesës dhe të mirave që ka bërë deri në atë çast. Ai duhet të jetë gjithmonë i vetëdijshëm se vendi i vetëm ku mund të strehohet, është Allahu Teala dhe se duhet të kërkojë strehim tek Ai, duke u munduar që të fitojë kënaqësinë e Tij me punë dhe vepra të mira.

Nuk duhet të harrojmë se edhe adhurimet dhe veprat tona të sinqerta kanë nevojë të pranohen ashtu siç pranohen duatë tona. Në një hadith tjetër, Profeti (a.s.), në lidhje me misterin më të rëndësishëm të robit, frymën e fundit, shprehet:

"Dikush, për një kohë të gjatë bën punë të xhenetlinjve,

më vonë, puna e tij përfundon me një vepër të xhehenem-linjve. Ndërsa një tjetër, për një kohë të gjatë bën punë të xhehenemlinjve, më vonë, puna e tij përfundon me një vepër të xhenetlinjve". (Muslim, Kader, 11.)

Tregohet se njëri prej të dashurve të Allahut, Ali Beka, nofkën "Beka", pra "që qan shumë", e ka marrë prej kësaj ndodhie:

Ali Beka kishte një shok të singertë dhe të dashur të Allahut, si vetja. Shoku i tij ishte njeri i urtë dhe zotëronte aftësi të jashtëzakonshme. Një herë, po udhëtonin bashkë për të shkuar në një vend, largësia e të cilit ishte një vit udhëtim në këmbë. Por me aftësitë e tyre të jashtëzakonshme, këtë rrugë e bënë për një orë. Shoku i tij i la një amanet: "Unë do të vdes në filan çast, në filan vend. Prandaj m'u gjend pranë në atë moment". Mirëpo shoku i tij, e dha frymën e fundit si jobesimtar. Për këtë arsye, Ali Beka, nga frika se nuk do ta arrinte kurrë kënaqësinë e Allahut Teala dhe se nuk do ta shpëtonte dot besimin e tij në frymën e fundit, qante shumë.

Prandaj, në lidhje me çështjen e frymës së fundit, zemra e besimtarit duhet të jetë në pikën e ekuilibrit midis frikës dhe shpresës. Ahmed bin Asim Antaki (Allahu e mëshiroftë!), u ka thënë atyre që i kanë kërkuar këshilla:

"Frika më e dobishme, është ajo që e ndalon njeriun prej gjynaheve, e largon atë nga gjërat që nuk i pëlqejnë Allahut Teala, e shqetëson për çështjen e botës tjetër dhe e bën të mendojë thellë në lidhje me pjesën e jetës që i ka mbetur dhe frymën e fundit".

Ndërsa, i nderuari Muhamed Masum Faruki, ka thënë:

"Frika për frymën e fundit është një mirësi e atillë, sa që i ka kapur të gjithë të dashurit e Hakut".

Ata që e jetojnë jetën e kësaj bote, duke i shtuar dashurisë së besimit, paqes së adhurimit dhe moralit të bukur edhe frikën dhe shqetësimin për frymën e fundit, do të jenë të ruajtur nga frika dhe hidhërimi, në ditën e kiametit. Ky është një premtim hyjnor, i cili shprehet në këto ajete fisnike:

"Me të vërtetë, atyre që thonë: "Zoti ynë është Allahu", e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t'u zbresin melekët (para vdekjes) e do t'u thonë: "Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Gëzojuni xhenetit që ju është premtuar". (Fussilet, 30.)

SI DO TË JETË FUNDI YT?..

Shejh Ahmed Harbi kishte një komshi të moshuar me emrin Behram, i cili ishte mexhusi, pra adhurues i zjarrit. Një ditë, Ahmed Harbi e këshilloi Behramin në lidhje me besimin. Mexhusiu i moshuar, tha:

-O i madhi i myslimanëve! Do të të pyes për tri gjëra. Nëse do të mund t'u përgjigjesh, do t'i besoj fesë tënde.

-Pyet!- tha shejh Ahmed.

-Përse i krijoi Allahu njerëzit? U dha atyre çdo gjë dhe i furnizoi. Po përse i bën të përjetojnë vdekjen? Përse i ringjall?

Shejh Ahmedi u përgjigj:

-Njerëzit i krijoi që të njohin ekzistencën dhe njëshmërinë e Tij, të kuptojnë Fuqinë Hyjnore dhe shfaqjet madhështore. I furnizoi, që të shohin Furnizimin dhe Mëshirën e Tij. I vdes, që të njohin Fuqinë absolute të Tij. I ringjall, që të njohin Pafundësinë e Tij. Shkurtimeisht, që të kuptojnë se Ai është mbikëqyrësi absolut në çdo ndodhi dhe ngjarje të jetës.

Kur Behrami i dëgjoi këto, pranoi islamin. Mirëpo papritur, shejh Ahmed Harbi frikësohet jashtë mase dhe i bie të fikët. Kur erdhi në vete, e pyetën:

-Ç'të ndodhi, o shejh?

-Dëgjova një zë që më tha: "Behrami ishte një mohues që adhuronte zjarrin, tash shtatëdhjetë vjet dhe tani u bë mysliman. Ndërsa ti je mysliman tash shtatëdhjetë vjet, por a e

di se çdo të bëhet me ty në frymën e fundit?.. (Tedhkiretu'l-Evlija.)

Prandaj duhet që çdo frymë tonën ta harxhojmë në mënyrë të atillë, që çasti ynë i fundit në këtë botë të jetë i mirë. Përveç kësaj, duhet që gjithmonë të kërkojmë strehim tek mëshira e Allahut, që të arrijmë shpëtimin e përvetshëm.

Khunejd Bagdadi (Allahu e mëshiroftë!), kur ishte duke shëtitur në shkretëtirat e Jemenit, pa një qen gjahu. Ai vuri re se dhëmbët e tij kishin rënë, në putrat e tij, me të cilat dikur sulmonte luanët, s'kishte më fuqi, ishte dobësuar dhe ishte bërë si dhelpër e plakur. Një herë e një kohë u vërsulej demave të egër dhe drerëve, ndërsa tani kishte filluar të sulmohej edhe nga delet.

Kur Khunejdi e pa qenin në atë gjendje të mjeruar dhe të këputur, i dha një copë bukë prej ushqimit të vet dhe

me keqardhje për qenin, tha këto fjalë:

"O qen! Nuk e di se cili nga ne të dy do të dalë më mirë nesër. Me sa shoh tani, sot, meqenëse unë jam njeri, jam më i mirë se ti. Mirëpo, nuk e di se çdo më sjellë kaderi në të ardhmen! Nëse besimit tim nuk i rrëshqet këmba, do të vë në kokë kurorën e faljes së Allahut Teala. Por, nëse më bie veshja e urtësisë që zotëroj, do të jem edhe më poshtë se ti, sepse një qen, sado i keq të jetë, nuk do të çohet në xhehenem".

Ja pra, besimtari që ka në zemër ndjenja të tilla, jeton me një kujdes të veçantë, sikur të jetë duke ecur mbi një fushë të minuar. Me qëllim që konaku i fundit i kësaj bote, ku do të strehohet, të jetë një kopsht prej kopshteve të xhenetit, ai i nënshtrohet me gjithë shpirt udhëzimit të heshtur të varrezave. Urtësia e përgatitjes për vdekjen nuk është t'i përgatitësh vetes varrin, por të përgatitësh veten për në varr.

Pasi i nderuari Shah Nakshibendi ndërroi jetë, një prej atyre që e kishin dashur shumë, e pa në ëndërr dhe e pyeti:

-Çfarë pune duhet të bëj, që të arrij shpëtimin?

Shah Nakshibendi iu përgjigj:

-Bëj atë punë, të cilën do ta bëje në frymën e fundit!

Kur vjen çasti i fundit edhe duart më të afta nuk hyjnë më në punë. Pas kësaj, njeriu as djersitet, as lodhet, as ka ftohtë dhe as ngurron më. Pra, zhduket çdo arsyesim që e pengon njeriun nga adhurimi, shërbimi dhe munda në rrugë të Allahut. Mirëpo tashmë, nuk është koha për adhurime dhe punë, por koha për të dhënë llogari përpara Allahut. Jeta e kësaj bote është e vetmja kohë për të bërë punë të mira për hir të Allahut. Nëse të ikën ky rast, nuk ka më kthim mbrapa. I nderuari Xhunejd Bagdadi thotë:

"Një ditë e kësaj bote është më e mirë se njëmijë vjet të botës tjetër, sepse në një ditë të kësaj bote ke mundësinë të korrësh kënaqësinë hyjnore. Por në botën tjetër nuk ke mundësi të bësh punë të mira dhe të fitosh. Atje do të bëhet vetëm llogaria e jetës".

Sipas kësaj, besimtarët e përsosur jetojnë duke e konsideruar këtë botë si arën e botës tjetër dhe duke qenë të vetëdijshëm se jeta e kësaj bote është thjesht një kohë, e cila u është dhënë për të bërë vepra të mira.

Sipas një transmetimi, kur Iljasi (a.s.), takohet me melekun që merr shpirtat, rrënoqethet paksa. Për këtë arsye, Azraili (a.s.), thotë:

"Ti je një profet, o Iljas! U frikësove nga vdekja?"

Iljasi (a.s.), përgjigjet:

"Jo, nuk u frikësova nga vdekja. Por u hidhërova nga fakti se më mbaroi jeta. Unë e kam kaluar jetën time duke bërë adhurime e duke ligjruar dhe ndjeja ëmbëlsi të madhe prej të qenit rob i Allahut. Mirëpo tani, do të jem peng në varr, deri në ditën e kijametit. Për këtë arsye, u pikëllova".

Sa bukur e ka përmbledhur poeti mënyrën e jetesës që duhet të bëjë një besimtar:

Ditën kur nëna të lindi e të nxori në botë,

Ti qaje, ndërsa bota qeshte mënjanë.

Tani jeto, që kur të vdesësh të qeshësh,

Ndërsa pas teje të shtohen njerëzit që qajnë...

Ja pra, e rëndësishme është që ta mbyllësh defterin e kësaj jete me punë të mira dhe të sinqerta, duke lënë një zë të këndshëm në kupën e qiellit. Të arrish tek Haku me këtë gjendje shpirtërore, me ndërgegje të pastër, me zemër të qetë dhe fytyrë të ndritur, është lumturia më e madhe.

Një fjalë e urtë thotë: "Qesh mirë, ai që qesh i fundit". Kup-timi i kësaj është se nuk ka buzëqeshje më të bukur se sa buzëqeshja e njeriut në çastin e frymës së fundit, kur të ngrihen perdet dhe t'i tregohet vendi ku do të shkojë. Buzëqeshja e atij çasti, është buzëqeshja më e bukur, më kuptimplote dhe më e lumtur e robit në këtë botë.

Allahu i Madhëruar me bujarinë e Tij të pafundme, na bëftë të gjithëve prej atyre që do t'u qeshë fytyra në frymën e fundit. Zoti ynë na e bëftë të mundur që me urtësi të llogaritim veten tonë dhe të përmirësohemi. Na e bëftë të mundur që në frymën e fundit të shijojmë takimin e përjetshëm dhe në ditën e kijametit të dalim të qetë, të lumtur e të çliruar prej frikës dhe hidhërimit, si në një mëngjes bajrami!..

Amin!..



Edukimi Si brezit të ri me moralin fetar

“Besimtarët duhet
të ndërgjegjësojnë të tjerët
se shoqëria nuk mund
të jetojë pa fe.”

Murad Hofman

Zamira Bushati

Edukimi i brezit të ri është detyrë për çdo prind, familje dhe shoqëri. Ky edukim është edhe sfida kryesore për çdo civilizim, sepse sa më kujdes t'i kushtohet edukimit të brezit të ri, aq më shumë zhvillohet dhe emancipohet jeta në atë vend. Një brez i mirëedukuar, do sigurojë në të ardhmen një shoqëri të shëndoshë.

Një poet arab thotë:

*Popujt janë të tillë sa morale të kenë
Në u zhdukshin moralet, popujt më nuk do jenë*

Rritjes dhe edukimit të brezit të ri po i kushtohet një kujdes i veçantë, si nga ana fizike, ashtu edhe nga ana mendore, por po harrohet dhe po anashkalohet kujdesi që duhet treguar ndaj anës morale dhe shpirtërore të tij.

Problemet që po kalon shoqëria sot, janë vërtet shqetësuese. Ato kanë tronditur jetën tonë dhe do të trondisin e do vënë në krizë edhe të ardhmen e fëmijëve tanë. Fenomene të tilla, si shpërbërja e familjes, krimet brenda saj, të cilat hapin edicionet e përditshme informative, mosmarrja e përgjegjësive që i takojnë secilit, përdorimi i drogës, bixhozit, prostitucionit etj., vërtetojnë se vlerat e moralit të mirë janë tronditur dhe se ne nuk jemi duke treguar kujdes ndaj këtyre vlerave morale, sidomos tek të rinjtë tanë.

Megjithëse shoqëria ka vendosur ligje dhe ka ndërtuar një numër të konsiderueshëm strukturash administrative, mbrojtëse dhe ndëshkuese, përsëri këto dukuri po shtohen dita-ditës.

Meqenëse ligjet njerëzore nuk po arrijnë që të ndikojnë tek njeriu për t'u bërë një individ më i mirë, atëherë ne kemi nevojë edhe për diçka tjetër.

Natyrshëm lind pyetja: Çfarë i mungon shoqërisë sot, që këto probleme të zgjidhen ose të paktën, të minimizohen?

Përgjigjja është: Morali dhe edukata fetare. Ky moral është i nevojshëm dhe i domosdoshëm t'i jepet njeriut që në fëmijëri për mirërritjen dhe mirëedukimin e tij.

Por çdo të thotë moral dhe nga e ka prejardhjen kjo fjalë?

Fjala “moral” rrjedh nga fjala latine mos, moris dhe në kuptimin etimologjik domethënien e ligjit, të së zakonshmes, traditës, mirësjelljes, dëlirësisë. (Ekrem Murtezai, Fjalori i filozofisë, 1995, fq. 462)

Ndërsa fjala “moral” në islam vjen nga fjala “ahlak”, që është shumësi i fjalës “huluk” dhe kupton prirjen e lindur, karakterin, mënyrën e sjelljes me botën, cilësitë shpirtërore dhe morale që përcaktojnë mënyrën e sjelljes njerëzore. (Ahmet Muhammed El-Hufi, Min ahlak-in-nebevijj, Kajro, 1979, fq. 42)

Pra, siç vihet re nga këto përcaktime, morali është një nga përbërësit themelorë në formimin e njeriut, të personalitetit të tij, të normave të sjelljes, të cilat rregullojnë të gjitha marrëdhëniet individ-individ, individ-shoqëri.

Këtë vlerë të madhe të moralit në ndërtimin e shoqërisë, e ka skalitur Allahu i Madhëruar përmes Kuranit dhe sunetit të Pejgamberit tonë (a.s.).

Lexoni me vëmendje radhët më poshtë.

Në ajetin 4, të sures El-Kalem, Allahu (xh.sh.), i është drejtuar Profetit tonë me fjalët:



“Me të vërtetë, ti je në shkallën më të lartë të moralit.”

(El-Kalem, 4)

Në hadithin profetik: *“Jam dërguar të përsos bukuritë e moralit”*, (Et-Tajalisi në Musned) si dhe në hadithin tjetër *“Besimtarët më të përsosur në fe, janë ata që kanë moralin më të mirë”* (Tirmidhiu), theksohet rëndësia që ka morali në rregullimin e jetës së njeriut.

Morali islam përfshin dashurinë, përkushtimin, sakrificën, mëshirën, tolerancën dhe paqen. Një mysliman me moral të lartë është një njeri i sjellshëm, i thjeshtë, i drejtë, i besueshëm, me të cilin është e lehtë të krijohen marrëdhënie të mira dhe të ndihen mirë të gjithë ata që jetojnë rreth tij. Të gjesh një njeri të tillë në ditët e sotme nuk është e lehtë, sepse shumë prej këtyre vlerave po humbasin.

Vetëm nëpërmjet moralit dhe edukatës fetare, individi rregullon marrëdhëniet e tij me Krijuesin, vetveten dhe shoqërinë, i mundëson atij arritjen e një qetësie shpirtërore dhe ndihmon në përballimin e sfidave të jetës.

Në këtë aspekt, medresetë po japin një kontribut të çmuar në formimin e brezave me edukatën fetare dhe qytetare. Në këto shkolla, krahas dhënies së njohurive shkencore, etike etj., një rëndësi të veçantë i jepet dhënies së edukatës fetare, njohjes me individin e edukuar sipas moralit të lartë fetar, gjë që është shumë e rëndësishme për krijimin e një modeli të shëndoshë, ku fëmija mund të mbështetet dhe të plotësojë personalitetin e tij.

Më poshtë po radhis disa nga dobitë që sjell edukimi i brezit të ri me moralin fetar:

1. Ndhmon në zhvillimin e gjithanshëm të fëmijës.
2. I njeh fëmijët me moralin e bukur fetar, përmes normave fetare.
3. I ndihmon të respektojnë dhe të duan veten, prindërit dhe të tjerët.
4. Ndhmon në krijimin e vetëkonceptimit pozitiv, në lidhje me botën që e rrethon, duke vendosur raporte të drejta midis tij dhe komunitetit.
5. Krijon premisa për ndërtimin e një baze të shëndoshë morali dhe etike, të cilat e aftësojnë fëmijën për ndërtimin e një jete të shëndetshme në të ardhmen.
6. Parandalon dukuritë e rënda që kanë prekur shoqërinë njerëzore, si përdorimi i drogës, alkoolit, bixhozit, prostitucionit etj.

Po t'i hedhim një sy eksperiencës së shteteve të Evropës, në lidhje me moralin dhe edukatën fetare në shkolla, do shohim se shumica e këtyre vendeve kanë përfshirë në sistemin arsimor dhe po zhvillojnë në shkollat e tyre mësimin e lëndës së “Edukatës fetare”. Në disa shtete ajo zhvillohet si lëndë e detyruar e në disa të tjera si lëndë

me zgjedhje.

Në Angli, Gjermani, Austri, Irlandë, Finlandë, Danimarkë e Belgjikë lënda e “Edukatës fetare” është lëndë e detyruar në programin mësimor.

Në këto vende, jo vetëm po jepet lënda e “Edukatës fetare” sipas përkatësisë fetare të shumicës së popullatës, por u jepet mundësia edhe pakicave kombëtare që të zhvillojnë këtë lëndë sipas besimit të tyre përkatës.

Një eksperiencë të shkëlqyer në këtë fushë po japin Austria dhe Belgjika, ku si pjesë e “Edukatës fetare” po jepet edhe lënda e “Edukatës islame” për popullsinë myslimane.

Në Austri, pjesë të këtij procesi mësimor kemi edhe një numër të konsiderueshëm të teologëve që po japin mësim lëndën e “Edukatës islame”, me të cilët edhe mund të krenohemi.

Nga parashtrimi i të gjitha të mirave që sjell edukata fetare tek formimi pozitiv i nxënësve, si dhe nga përvoja që kanë shumica e shteteve më të zhvilluara evropiane në praktikimin e mësimin të edukatës fetare në shkolla, mendoj se edhe tek ne ka ardhur koha që brezin e ri ta rrisim me edukatën dhe moralin fetar.

E shoh shumë të nevojshme që në kurrikulën e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, të futet lënda e Edukatës fetare, si një lëndë më vete dhe të shikohet mundësia e zhvillimit të saj sipas përkatësive fetare të nxënësve. Duhet të marrim dhe të përfitojmë nga këta shembuj të mirë dhe pozitivë, që shoqëritë e zhvilluara i kanë përqafuar me kohë në edukimin e fëmijëve të tyre.

Duke marrë për bazë ato që parashtrova më lart, e shoh të nevojshme të dal me këto rekomandime:

1. Të bëhen përpjekje nga të gjitha komunitetet fetare për të bashkëpunuar për një studim në lidhje me domosdoshmërinë e edukimit të brezit të ri me normat e moralit fetar.
2. Paraqitja e një plan-projekti nga komunitetet fetare Ministrisë së Arsimit, në lidhje me këtë çështje.
3. Sensibilizimi i njerëzve për rëndësinë e edukimit fetar në zhvillimin pozitiv të fëmijës dhe nevojën e futjes së lëndës së edukatës fetare, sipas përkatësisë fetare të fëmijës, në programin mësimor në shkolla.

Mendoj se të gjithë pajtohemi për rëndësinë dhe domosdoshmërinë e moralit dhe edukatës fetare në shkolla, e cila ruan shoqërinë nga përhapja e rreziqeve dhe dukurive negative.

Allahu na bëftë prej atyre që janë stolisur me moralin e bukur islam dhe që përpiqen që këtë moral t’ia transmetojnë brezit të ri.





Dhikri

PËRMENDJA E ALLAHUT

Abdullah Byjyk

7. Rrahmani, Allahu Teala: **“Në çfarëdo pune që të jesh, çfarëdo gjëje që të lexosh nga Kurani dhe çfarëdo pune që të bëni (o njerëz), Ne jemi dëshmitarë, kur ju të thelloheni në të. Zotit tënd nuk i fshihet asnjë grimë peshe, në Tokë e në qiell; as më pak nga ajo e as më shumë nuk mbetet pa u shënuar në Librin e qartë”.** (Junus, 61)

Pra jeta, e cila do të jetohet nën dritën e këtyre shtatë ajeteve që i përmbledhëm më lart, është jeta më e ndershme, më e mirë dhe më e begatë. Nëse njeriu si krijesë, e përkujton vazhdimisht Krijuesin e tij, e vërteton dhe e pranon se Ai (Allahu) është gjithmonë pranë tij, pra është më afër se sa damari i qafës së tij, atëherë ai bën një jetë cilësore dhe të kënaqshme. Ndërsa arsyeja e arritjes së kësaj mirësie është shumë e qartë. Pra, që njeriu si krijesë, të mos e harrojë kurrë ekzistencën e Krijuesit të tij.

Por nuk është vetëm njeriu, i cili e përmend Allahun Teala.

“Atë e madhërojnë shtatë qiejt, toka dhe gjithçka gjendet në to. Dhe nuk ka asgjë që nuk e madhëron Atë, duke e lavdëruar, por ju (o njerëz) nuk e kuptoni madhërimin që i bëjnë ata...” (Isra, 44)

Këtu ka diçka që na tërheq vëmendjen. Në Kuran, përmendja e njeriut shprehet me fjalën “dhikr”, ndërsa përmendja e të gjitha krijesave të tjera, shprehet me fjalën “tesbih”. Kjo çështje do të bëhet edhe më e qartë me disa ajete, të cilat do t’i japim më poshtë:

“A nuk e vërejnë ata se si hija e të gjitha atyre që ka krijuar Allahu, anon djathtas e majtas, duke iu falur Atij dhe duke iu përlulur?” (en-Nahl, 48)

“A nuk e vëren ti, se Allahun e lavdëron çdo krijesë që ndodhet në qiej dhe në Tokë, madje edhe shpezët krahëhapur?! Çdokush e di se si t’i falet e ta lavdërojë. Allahu e di mirë çfarë bëjnë ata.” (en-Nur, 41)

“...Ne i nënshtruam malet dhe shpendët që, bashkë me Dautin, të bënin tesbih (të thurnin lavde për Allahun). Ishim Ne që i bëmë këto.” (el-Enbija, 79)

“Ne ia nënshtruam malet që, bashkë me të, t’i bënin tesbih Allahut, në mbrëmje dhe në mëngjes edhe shpendët e tubuar. Të gjithë i drejtoheshin Atij.” (Sad, 18-19)

“Beto hem në erërat që çojnë (pluhurin), në retë e ngarkuara rëndë, në ato që lundrojnë lehtë dhe në engjëjt që shpërndajnë urdhrat.” (edh-Dharijat, 1-4)

Një njeri që i thotë vetes mysliman, nuk mund të ketë një mënyrë jetese të çfarëdoshme. Pra, bëhet fjalë për qëllimet, synimet dhe rezultatet e jetës së tij. Lidhja e tij me Zotin nuk është e kufizuar në kohë apo vende të caktuara. Pra, duhet ndërtuar niveli devotshmërisë ndaj Allahut të Madhëruar.

Çështja e dhikrit (përmendjes së Allahut), është një çështje, e cila theksohet shumë në Kuran dhe hadith dhe lidhet ngushtë me të gjithë universin. Kjo është një mirësi, e cila ka aftësinë të parandalojë çdo lloj boshllëku të mundshëm midis Allahut të Madhëruar dhe njeriut. Dëshirojmë që përmbajtjen e kësaj teme kaq të rëndësishme ta ndajmë me ju, nën dritën atyre që kemi mësuar dhe dëgjuar. Prandaj, disa çështje që kanë lidhje me dhikrin, në fillim do t’i shqyrtojmë, pastaj do të nxjerrim përfundimin. Ne na takon të punojmë, ndërsa sukcesi është prej Allahut.

Çdo njeri besimtar beson se bën një jetë nën kontrollin hyjnor.

Ka shtatë dëshmitarë, të cilët do të dëshmojnë në lidhje me robërit e Allahut:

1. Koha dhe 2. Vendi: **“Atë Ditë ajo do të tregojë lajmet e saj!”** (ez-Zelzele, 4)

3. Gjuhët tona: **“Dy engjëj i rrinë atij nga e djathta dhe e majta dhe, për çdo fjalë që ai thotë, ka pranë vetes një mbikëqyrës të gatshëm (për ta shënuar atë).”** (Kaf, 17-18)

4. Duart dhe këmbët tona: **“Atë Ditë që do të dëshmojnë kundër tyre gjuhët, duart dhe këmbët e tyre për çfarë kanë bërë”.** (en-Nur, 24)

5. Dy melekët, të cilët shkruajnë veprat e njeriut: **“Ndonëse mbi ju ka rojtarë (që ju vëzhgojnë), shënues të nderuar që dinë gjithçka që bëni”.** (el-Infitar, 10-12)

6. Libri i veprave që do të jepet në ditën e gjykimit: **“Ky është Libri Ynë, që do t’ju tregojë të vërtetën. Ne i kemi urdhëruar (engjëjt) që të shkruajnë të gjitha çfarë keni bërë”.** (el-Xhathije, 29)

Rëndësia e kohës dhe e tokës mbi të cilën jetojmë.

Çdo njeri besimtar duhet ta dijë këtë të vërtetë. Devotshmëria ndaj Allahut realizohet në këtë botë (mbi këtë tokë). Për këtë arsye, kjo tokë është bërë mesxhid (xhami, vend faljeje) për këtë umet. Çdo punë që bëjmë, vepër e mirë apo shërbim ndaj njerëzimit, realizohet në një pikë ku kryqëzohet koha me vendin (tokë). Shembujt që kemi dhënë më poshtë, jo vetëm që do ta përforcojnë këtë të vërtetë, por do të vënë në pah edhe rëndësinë e çështjes së dhikrit.

Rezultatet e kryqëzimit të kohës me vendin.

Punët, veprat, detyrat dhe shërbimet, që duhet të bëhen në pikën ku kryqëzohen koha dhe vendi, janë adhurime që bëhen për hir të Allahut.

Përmendja e Allahut gjatë kryerjes së detyrave që duhen përmbushur në pikat ku kryqëzohen koha dhe vendi, është dhikër.

Realizimi i këtyre detyrave në pikat ku kryqëzohen koha dhe vendi, sipas rregullave të caktuara nga Allahu, është ihsan (mirësi).

Realizimi i këtyre detyrave në pikat ku kryqëzohen koha dhe vendi me dashuri dhe sinqeritet, është ihlas (bërja e

Devotshmëria ndaj Allahut realizohet në këtë botë. Për këtë arsye, kjo tokë është bërë mesxhid për këtë umet. Çdo punë që bëjmë, vepër e mirë apo shërbim ndaj njerëzimit, realizohet në një pikë ku kryqëzohet koha me vendin (tokë).

punëve vetëm për hir të Allahut).

Realizimi i këtyre detyrave në pikat ku kryqëzohen koha dhe vendi, së bashku me vëllazërit tanë myslimanë, është vëllazëri në fe.

Dhe së fundi, vendet ku realizohen këto detyra dhe adhurime, janë xhami për myslimanët.

Siç shihet, nëse mënyrën e jetës sonë e mbajmë nën kontroll në mënyrë të vetëdijshme, elementet e devotshmërisë për të cilat jemi të ndërgjegjshëm, do të fitojnë grada dhe vlerë të madhe tek Allahu Teala.

Tani le të kalojmë në një temë tjetër, e cila do t'i rrisë edhe më tepër këto vlera. Mjafton që çështjen e dhikrit ta kuptojmë mirë dhe të bëjmë çdo gjë që kemi për detyrë.

Çdo krijesë qëndron përballë Krijuesit me dashuri dhe respekt.

Në gjithësi, çdo qenie qëndron përballë Krijuesit duke thurur lavde të pafundme, duke falënderuar dhe duke shfaqur respekt të pasqorë. Siç e dimë, pjesa më e vogël e materies, është atomi.

Çdo gjë përbëhet prej atomeve. Elektronet që ndodhen përreth bërthamës së atomit, rrotullohen në mënyrë të vazhdueshme dhe të rregullt. Kjo gjë shprehet si tesbih

(përmendje, lavd) ndaj Allahut. Por fatkeqësisht, kur asnjë prej krijesave nuk e pakëson tesbihin ndaj Allahut, njeriu tregohet neglizhent në këtë çështje. P.sh:

Krijuesi i Madhëruar ka urdhëruar bletën që të bëjë mjalte. Si rrjedhojë, detyra e bletës është të bëjë mjalte. Çfarë do që të hajë bleta, qoftë lule apo sheqer, e thartë apo e hidhur, ajo që bën bleta është vetëm mjalte. Vazhdimësia që tregon bleta në prodhimin e mjaltit, do të thotë *tesbih* i vazhdueshëm ndaj Allahut Teala.

Krijuesi i madhëruar, ka urdhëruar gjarprin kobra të prodhojë helm. Pra, tesbihi që bën kobra ndaj Krijuesit të tij, është të prodhojë vazhdimisht helm.

Detyra që i është dhënë krimbit të mëndafshit, është të prodhojë mëndafsh. Prodhimi i mëndafshit është tesbihi që bën krimbi i mëndafshit ndaj Krijuesit të tij.

Ja pra, krijesat mbi tokë dhe në të gjithë universin, përmbushin detyrat e tyre, pa lënë pas dore asgjë. Ky është edhe tesbihi që i bëjnë ato Krijuesit të tyre.

Ndërsa njeriu, Krijuesi i Madhëruar i ka dhënë urdhrin "më adhuro vetëm Mua". Nëse njeriu i përgjigjet pozitivisht këtij urdhri, çdo gjë që vepron, që kur fillon të kryejë adhurimet prej herës së parë, konsiderohet si adhurim. Çfarë do adhurimi që të kryejë, nëse e kujton Krijuesin e tij dhe këto detyra i kryen me vetëdijen se është nën vëzhgimin dhe kontrollin e Tij (Allahut), ajo që bën ai është dhikri më i madh.

Por këtu ka një çështje e cila kërkon vëmendjen tonë.

"Xhinet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë." (edh-Dharijat, 56)

Meqenëse qëllimi i krijimit të xhindëve dhe njerëzve është vetëm adhurimi ndaj Allahut, a mundet që gjatë gjithë jetës deri në vdekje të kryhen vetëm adhurimet farz (të detyruara)? Kjo realizohet vetëm atëherë kur adhurimet mbushin çdo fushë të jetës.

Por adhurimet në këtë mënyrë mund t'i kryejnë vetëm melekët, të cilët Allahu i Madhëruar i ka krijuar prej nurit (dritës). Për njeriun nuk është e mundur që gjithë kohën ta kalojë me adhurime.

"...Ata që janë tek Ai (engjëjt), nuk ngurrojnë ta adhurojnë Atë e nuk ndiejnë lodhje, por e lavdërojnë (Atë) natën dhe ditën, paprerë." (el-Enbija, 19-20.)

"...melekë të fuqishëm e të ashpër, të cilët kurrë nuk i kundërshtojnë urdhrat e Allahut, por i zbatojnë menjëherë ato." (et-Tahrim, 6.)

Kjo është çështja në të cilën rëndësia e dhikrit na e tërheq vëmendjen. Çështja e përmendjes, e cila realizohet mbi dimensionin e kohës dhe vendit, pra detyra e dhikrit ndaj Allahut, në një farë mënyre nuk lë asnjë boshllëk në jetën tonë. Futja në veprim e dhikrit të zemrës, aty ku mbaron dhikri i gjuhës, e zgjidh këtë çështje që në rrënjë.

Çështja e dhikrit, e cila përmendet shumë herë në librin tonë të devotshmërisë, në Kuranin Kerim, është një çështje e cila u intereson të gjithë njerëzve që i besojnë Allahut. Konsiderimi i detyrës së dhikrit si një detyrë e cila i takon vetëm një pjesë të caktuar njerëzish, është fyerja më e madhe që i bëhet dhikrit.

Allahu na bëftë prej atyre që e përmendin vazhdimisht Atë dhe i japin hakun detyrës së dhikrit. Amin!

Durimi në sprovimin me mirësi

Hatixhe Jëlldëz

Dëshiroja të vizitoja një shoqen time, të cilën kisha kohë të gjatë pa e parë. Kërkoja çdo qoshe të shtëpisë, por nuk gjeta ndonjë dhuratë të përshtatshme për të. Në treg nuk kisha kohë dhe mundësi për të dalë.

Në mendje më erdhi papritur tefsiri i një ajeti, të cilin e lexova një ditë më parë dhe prej të cilit u ndikova shumë. Shpirtin ma kaploi një qetësi e ëmbël. Menjëherë i bëra një fotokopje dhe e futa në çantë, duke thënë: "Përse të mos i bëj dhuratë këtë?"

Në fund të një mëngjesi të mrekullueshëm ia shpjegova gjendjen shoqes dhe i thashë se i kisha sjellë një dhuratë të ndryshme. Fillova ta lexoja. U habita shumë kur pashë se ajo e ndjeu tej mase emocionin që ngjallte ajeti që po lexoja.

"Çdo njeri do ta shijojë vdekjen. Ne ju vëmë në provë me të keqe e me të mirë dhe së fundi, te Ne do të ktheheni." (Sureja el-Enbija, 35.)

Ndërkohë që vazhdoja ta lexoja tefsirin e ajetit nga libri Fi Dhilali'l-Kur'an, ndjeja se ajo qetësohej. Bisedën tonë e vazhduam me kënaqësinë që jepte dhurimi.

Të sprovohesh me të keqen, është diçka e kuptueshme. Ajo bëhet me synimin për të nxjerrë në pah dimensionin e fuqisë së rezistencës të njeriut, të durimit në momente të vështira, të shkallës së lidhjes me Zotin dhe shpresës që besimtari ka te mëshira e Tij.

Edhe pse disa njerëz mendojnë se sprovimi me mirësi është më i lehtë se sprovimi me të keqe, përsëri sprovimi me mirësi është më i rëndë.

Ka shumë prej atyre që e durojnë sprovimin me të keqe, por janë shumë të paktë ata që u rezistojnë vështirësive të sprovimit me të mirë.

Ka shumë njerëz që i përballojnë torturat e mundimet dhe që durojnë pa u kapluar nga frika. Ka shumë njerëz që rezitojnë pa iu trembur syri ndaj kërcënimeve dhe kanosjeve. Por të kesh pajisje, fuqi dhe armë të mjaftueshme dhe, krahas kësaj, të bësh një jetë të sigurt, është një lloj prove

shumë e vështirë për t'ia dalë mbanë.

Në këtë situatë, ka shumë pak njerëz që qëndrojnë pa i bërë të tjerët robër apo skllevër të dëshirave të tyre dhe pa u mposhtur përballë rehatisë, që i zvarrit njerëzit në dembelizëm dhe këputje.

Sprovimi me vështirësi vë në lëvizje ndjenjën e madhësisë. E shton durimin, forcon nervat dhe gjithë forcën e njeriut e përgatit për të përballuar vështirësitë që mund të vijnë në të ardhmen.

Por rehatia i dobëson nervat, i zbut dhe e bën njeriun që ta humbë aftësinë e zgjuarsisë dhe të qëndrësës.

Për këtë arsye, shumë njerëz, edhe pse i kalojnë me sukses fazat e vështira, kur arrijnë në pak qetësi, e humbin sprovën. Kjo është vetia themelore e njerëzve. Përveç atyre që i mbron Allahu Teala... I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, thotë kështu për ta:

"Çështja e besimtarëve është shumë mahnitëse, sepse çdo punë e tij është mirësi. Askush tjetër nuk është si besimtari. Nëse besimtari arrin bollëkun, falënderon dhe kjo është e mirë për të. Nëse bie në vështirësi, duron dhe kjo është e mirë për të." (Muslim) Por numri i këtyre është i pakët.

Kur njeriu sprovohet me mirësi, duhet të jetë shumë më i zgjuar se në kohët kur sprovohet me të keqe. Garancia për t'ia dalë mbanë në të dyja gjendjet, është lidhja me Allahun."

Kur tema u shtjellua plotësisht, ajo përpiquej të fshinte me shami lotët që i rridhnin rrëke nga sytë, duke thënë:

"Më ke sjellë një dhuratë kaq të bukur, sa nuk mund ta imagjinosh. Ti ke ndriçuar errësirën në të cilën gjende-sha prej dy ditësh. Allahu qoftë i kënaqur me ty!"

Nga ato që po thoshte, pasi u qetësua një çikë, kupto-



hej se kishte disa probleme në vendin ku punonte me plot dëshirë.

Ndërkohë që po përpiquej për të fituar ushqimin e kësaj bote e të botës tjetër, me shpirtin e saj human, si profesioniste në një fondacion shoqëror civil, një çast e kishte gjetur veten të përfshirë në një thashethem. Zemra e saj shumë delikate, kishte ngrirë menjëherë.

Ajo kishte ngelur ndërmjet zemrës së thyer dhe shpirtit të saj human. Në një anë, zemra e thyer, për shkak se i ishte bërë padrejtësi, në anën tjetër, lutjet dhe kënaqësitë e njerëzve të varfër, që u kishte shërbyer me gjithë zemër si nënë e si motër...

Kaluan disa ditë pa e kuptuar se çfarë duhej të bënte. Pikërisht atë ditë, dëgjoji se po i fliste Allahu dhe ndjeu ngrohtësinë e atyre fjalëve... Kjo është kënaqësia më e madhe...

Gjëja që kishte përjetuar ishte diçka e pahijshme, që përjetohet shumë shpesh në fondacionet shoqërore civile në vendin tonë.

Te ne shumë njerëz formojnë shoqata dhe vakëfe, duke u bashkuar me synime e ideale të bukura, por nuk shpëtojnë dot të qenët në shenjestër, pa gjetur shansin për të arritur rezultatin e dëshiruar. Kjo ndodh për shkak të thashethemeve, të smirës dhe mosbesimit ndërmjet anëtarëve, në një kohë të shkurtër.

Pengesa më e madhe në formimin e një mjedisi të suksesshëm pune në fondacionet shoqërore civile, është ndjenja e egoizmit, që bëhet qëllim më vete, duke zëvendësuar qëllimin e vërtetë.

Planifikimi dhe programimi i suksesshëm për ta përdorur sa më mirë kohën dhe fuqinë materiale-shpirtërore, është rruga më e mirë për të arritur rezultatin që synohet. Kështu, të gjithë, amatorë e profesionistë, duke punuar me ndërgjegje ndaj fuqisë materialo-shpirtërore që kanë fondacionet, arrijnë më shumë sukses dhe jeta shoqërore bëhet më e qetë.

Fondacioni i mirë është ai që përputhet me strukturën sociale të shoqërisë. Por në këto punë mund të përballësh edhe me rreziqe, si shfrytëzimi nga të tjerët dhe largimi nga qëllimi i vërtetë, duke u përdorur nga njerëz apo fondacione të padobishme. Për këtë arsye, anëtarët e fondacionit duhet të jenë të zgjuar dhe duhet të përpiqen shumë për të mos u larguar nga synimi.

Nëpër fondacionet shoqërore civile, anëtarët po spro-

vohen me mirësi. Njerëzit që kanë vlera të tilla të larta, duhet t'i kuptojnë mirë dhe t'i praktikojnë rregullat etike, që të jenë të përgatitur kundrejt vështirësive që u dalin përpara, duke duruar në mirësi.

Një shkak i rëndësishëm i mosfunksionimit, është neglizhimi për t'u aktivizuar, me mentalitetin: "sidoqoftë, dikush po punon, kështu që, edhe nëse nuk jam unë, puna do të përparojë".

Shumë herë, kjo sjellje lind prishjen e qetësisë ndërmjet anëtarëve. Rruga më e bukur për të arritur suksesin, është mosneglizhimi i punëve me mentalitetin: "Nëse nuk jam unë, nuk është asnjë" dhe shfaqja e një emocion pozitiv në çdo fazë të arritjes së qëllimit.

Dhimbja e shpifjes me të cilën u përballua Hazreti Ebu Bekri, radijallahu anh, në ngjarjen e Ifkut, si një mik i sinqertë dhe si një baba, ishte shumë e madhe. Mbi të gjitha, një i afërm, të cilin e kishte ndihmuar me gjithë zemër në çdo aspekt, vazhdonte të përhapte thashetheme ndërmjet njerëzve.

Kur Mistah b. Esase (r.a.), u bë njëri nga besimtarët që bënë thashetheme, duke u besuar shpifjeve të hipokritëve, Hazreti Ebu Bekri, radijallahu anh, u betua se do t'ia ndërpriste ndihmën.

Hazreti Aishe, radijallahu anha, e tregon kështu këtë ngjarje:

Babai im, Ebu Bekri, radijallahu anh, i cili e ndihmonte Mistah bin Esasen materialisht, tha: "Tashmë, nuk kam për ta ndihmuar kurrë Mistahun, për shkak të shpifjes që ka thënë për Aishen." Allahu i Lartësuar zbriti menjëherë këtë ajet fisnik:

"Njerëzit e ndershëm dhe të pasur ndër ju, të mos betohen se nuk do t'u japin të afërmeve, të varfërve dhe të mërguarve në rrugën e Allahut; le t'i falin ata dhe të mos ua marrin për keq! Vallë, a nuk doni që t'ju falë Allahu? Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë." (Nur, 22.)

Babai im, Ebu Bekri, radijallahu anh, tha: "Po! Për Zotin dua që Allahu të më falë." Pastaj filloi ta ndihmonte përsëri Mistahun dhe tha: "Këtë ndihmë nuk do ta ndërpres asnjëherë."

Ky ajet ua bën të ditur Ebu Bekrit (r.a.) dhe besimtarëve të tjerë se kanë bërë gabim dhe se Allahu dëshiron që t'i falë ata. Atë që dëshirojnë për vete, le ta dëshirojnë edhe në marrëdhëniet me njëri-tjetrin. Besimtarët nuk duhet të betohen se nuk do t'i ndihmojnë ata të cilët e meritojnë ndihmën, edhe nëse kanë bërë ndonjë faj apo ndonjë ligësi.

"Vallë, a nuk doni që t'ju falë Allahu? Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë."



KRIZA GLOBALE NË EKONOMI ËSHTË KRIZA E MODERNIZMIT

Ali Bullaç

Më datën 2 tetor 2008, shtetet e komunitetit evropian u mbledhën në pallatin presidencial të Francës. Në përfundim të kësaj mbledhjeje, secila nga shtetet e fuqishme evropiane pranoi vendimin që të mbështeste tregun, duke dhuruar përkatësisht: Gjermania 470 miliard dollarë, Franca 360 miliard dollarë, Spanja 100 miliard dollarë, Anglia 39 miliard dollarë, Austria 85 miliard dollarë. Para kësaj mbledhjeje edhe presidenti Obama u shpreh se do të transferonte 825 miliard dollarë në treg pasi të zgjidhej. E gjitha kjo do të thotë afërsisht 2 trilion dollarë, por vetëm prej tetorit deri tani, në treg janë hedhur 3,5 trilion dollarë. Me sa duket, kjo ka për të vazhduar kështu. Në qoftë se Amerika do të hedhë në treg vlerën prej 825 miliard dollarësh ka bërë të ditur se vlera e përmendur do të përdoret në këtë mënyrë: 275 miliard do t'i ndahet shtresës nevojtare si dhe firmave me buxhet të vogël dhe mesatar, në mënyrë që të mos kenë nevojë të ulin numrin e punëtorëve, ndërsa 550 miliard do të shpenzohen për shërbime publike, për energjinë e pastër, arsim, infrastrukturë dhe punësim nëpunësish. Masa e dytë e rëndësishme, e bërë publike nga shteti amerikan, është reformimi i Bankës Botërore, FMN dhe Organizatës Tregtare. Mbështetja e tretë e masës së shprehur nga Obama është bashkëpunimi me shtetet e varfra dhe në zhvillim e sipër.

Pika që më tërheq më shumë vëmendjen në gjithë këto që u thanë, është ndërhyrja e shtetit, jo vetëm në treg, por edhe në fushat e arsimit dhe shëndetësisë. Gjatë një krize ekonomike shteti ndërhyr hapur në treg. Vetëm se njëra nga tri vlerat më të rëndësishme që nxo-

rën në skenën e historisë SHBA dhe Bashkimit Evropian si vendlindje e liberalizmit, janë Kriteret e Kopenhagës dhe ekonomia e tregut të lirë. Ndërkohë që në të dy këto fusha shteti është duke derdhur sasi të konsiderueshme parash. Vallë, a do të mjaftojë vetëm kjo ndërhyrje që të kalohet kriza ekonomike, të cilën jemi duke përjetuar? Kjo është një pyetje shumë e rëndësishme. Unë mendoj se këto masa nuk kanë për të qenë të mjaftueshme në kapërcimin e krizës, nga dy aspekte. Njëri prej tyre është mosinteresimi për burimet e vërteta të krizës. I dyti për faktin se, sado në pamje të parë duket sikur para ja do të derdhet në treg, në ndihmë të nevojtarëve në mënyrë të rregullt, ajo prapëseprapë ka për të rrjedhur në sajë të përdorimit të mekanizmave të caktuar dhe instrumenteve të ndryshëm, përsëri në arkën e të pasurve. Një shembull konkret i kësaj pandehme është marrëveshja prej 20 miliard dollarësh që Turqia firmosi me FMN. Kjo, para që do të merret, do të derdhet në treg, do t'u jepet bizneseve të vogla dhe të mesme, punëtorit dhe pensionistit apo të papunëve? Apo do të derdhet sërish në shtresën e caktuar të të pasurve? Ky është themeli i debatit të sotëm në Turqi.

Këtë e them për dy arsye. E para, kemi të bëjmë me një zhvillim të rëndësishëm që tregon se liberalizmi është duke u tërhequr nga skena e historisë, me gjithë supozimin e tij bazë dhe këtë nuk mund ta nënvleftësojmë. Së dyti, Fukujama që shprehur se, pas shkatërrimit të sistemit sovjetik, bota do të vijë në fundin e filozofisë dhe për të nuk do të ketë asnjë alternativë tjetër, përveç demokracisë liberale dhe kapitalizmit liberal. Sot

shpallet fundi i filozofisë, por në të vërtetë ajo që po shkatërrohet është fjala e fundit e Perëndimit. Dëshiroj të prek një nga shkaqet e rëndësishme që çuan drejt kësaj krize. Lufta e SHBA në Afganistan dhe në Irak. Sipas një llogaritjeje të bërë në vitin 2006 në SHBA, pushtimi i Irakut do t'i kushtonte Amerikës 2 trilion dollarë, po aq sa do të ishte fitimi që do të kishte Amerika dhe Anglia nga nafta e Irakut. Si të thuash, jek e jek. Sot thuhet se po shkon drejt vlerës prej 3 milion. Pra, llogaria nuk ka dalë. SHBA ka shpenzuar 2 trilion për pushtimin e Irakut. Fitimi i naftës që vjedh prej Irakut është po dy trilion. Do të mendoni, çfarë fitoi SHBA që nisi këtë luftë? Kjo varet se nga cili aspekt e bëni ju këtë pyetje, sepse 2 trilion dollarët e caktuar për përgatitjet ushtarake për pushtimin e Irakut, u mblodhën nga xhepat e popullit amerikan, nga taksat që paguanin ata. Dy trilionët që u fituan nga nafta e Irakut, hynë në xhepat e firmave të naftës, firmave të armëve dhe lobingjeve të ndryshme. Në fakt, ky është një ndër shkaqet e rëndësishme të krizës ekonomike sot. Kjo e vërtetë fshihet në mënyrë sistematike. Sorosi i famshëm shprehet se: "Nuk është e mundur të shohësh fundin e kësaj krize. Më përpara kriza kishte formë U-je, ajo fillonte, prekte fundin dhe pastaj ngrihej lart. Kriza e sotme po ndodh në formë L-je. Kriza vazhdon, ndërkohë që ne nuk mund t'i shohim fundin." Sorosi pohon se kjo krizë është më shkatërrimtare sesa kriza e vitit 1929 dhe shton: "Po merr fund ekonomia liberale që iu imponua botës në kohën e Reganit dhe Theçërit. Kjo krizë nuk është vetëm ekonomike, por një krizë që do të sjellë përfundime thelbësore në politikë." Në qoftë se do të pyesnim se çfarë kuptojmë nga këto fjalë, do të nënvizonim këto pika:

1. Kjo është një krizë globale, baza social-ekonomike e së cilës është në SHBA, ndërsa baza intelektuale dhe filozofike gjendet në Evropë.

2. Kjo është një krizë në të cilën ka hyrë brenda vetë modernizmi.

3. Kjo është kriza ku nuk mund t'i jepet kuptim një lëvizjeje të re humane. Pra sot, rruzulli tokësor përjeton një lëvizje të re dhe të thellë humane, së cilës bota moderne nuk di t'i japë kuptim. Deri më sot bota ka njohur vetëm tri lëvizje humane të mëdha. Njëra prej tyre është kalimi nga jeta nomade në jetën sedentare. Së bashku me hixhretin e profetit Muhamed (a.s.) dhe më pas me politikën e ndjekur nga Omeri, bedevitë u vendosën në vendbanime të përhershme. Lëvizja e dytë e madhe hu-

mane filloi me revolucionin industrial. Kjo qe një lëvizje e popullsisë nga fshatrat drejt qyteteve të mëdha. Ndërsa sot, në këtë pikë që ka ardhur shekulli i XXI, shohim një lëvizje nga lagjet e skajshme të qyteteve drejt qendrave të tyre. Kjo lloj lëvizjeje paraqet shumë rëndësi. Këtu modernizmi është duke shkrepur këtë lëvizje të tretë nëpërmjet centralizimit të politikave industriale, zvogëlimit të bujqësisë, fatkeqësive ekologjike që nuk dinë të ndalin, shtimin e emigrantëve nga lindja drejt perëndimit, shtimin e fajeve politike dhe luftërat. Për shembull, pas pushtimit të Irakut nga SHBA, 4 milion e gjysmë irakenë u detyruan të emigronin përjashta Irakut. Dy milion njerëz emigruan brenda për brenda Irakut. Afërsisht, 400 mijë boshnjakë nuk janë kthyer ende në shtëpitë e tyre në Bosnjë. Në Çeçeni, 4 mijë çeçenë ndërruan vend, si dhe një milion njerëz në Azerbajxhan për shkak të luftës së Karabagut. Në Afganistan 4 milion dhe 100 mijë njerëz u shndërruan në emigrantë. Në Sudan 700 mijë eritreanë, po kështu. Arsyeya që po zgjatet me shifrat



është se popullsia e globit do të kapë shifrën 7 miliard në vitin 2012. Kjo është një shifër e madhe, ndërkohë që 200 mijë njerëz vendosen në qytete çdo ditë. Në vitin 2008, sipas publikimit që bëri zyra e popullsisë pranë Kombeve të Bashkuara, 50 për qind e botës jeton nëpër qytete. Në një të ardhme jo shumë të largët, Republika Popullore e Kinës dhe India do të zënë 40 për qind të popullsisë

së botës. Popullsia që transferohet drejt qyteteve nga zonat rurale apo nga periferia në drejtim të qendrës së qyteteve, nxjerr në pah këtë problem.

E para, do të lindë një luftë e madhe në lidhje me ndarjen e të ardhurave. Së dyti, do të përshpejtohen konfliktet etnike. Së treti, do të fitojnë rëndësi lëvizjet margjinale. Së katërti, do të vijë duke u rritur potenciali i dhunës në zemrën e gjithë qyteteve. Në fakt, kriza në të cilën jemi duke hyrë, sado që duket me dimension ekonomik, në bazë ka një infrastrukturë të tillë socio-politike dhe demografike.

Këtu shohim se çështja fokusohet në tri pika. Kur kalojmë njërin prej tyre që është shtresa socio-politike dhe hyjmë pak më shumë në fushën më epistemologjike, më ontologjike dhe strukturën e njeriut, shohim se është duke vazhduar me gjithë fuqinë që ka, një proces i thellë tëhuajësimi. Pra në krijesë, njeriu është duke përjetuar humbjen e kuptimit të tij. Me fjalë të tjera, njeriu jeton i pasigurt dhe pa një qëllim, nga aspekti epistemologjik, i



shkëputur nga qendra. Modernizmi i premtonte tri gjëra bazë njeriut, lirinë, vetëbesimin dhe prosperitetin. Bota moderne sot nuk arrin të realizojë asnjërën prej tyre. Nga aspekti moral-etik, duket se ka dalë nga boshti. Nga aspekti shoqëror dhe ai politik, njeriu është duke shkuar zvarrë drejt një kaosi të thellë. Një prej shkaqeve më të rëndësishme të kësaj situatë, është fakti që ideologjia e rritjes është ende në gjendjen më dominante. Në pikën që kemi ardhur, vetë rritja ka ardhur deri në limitet e saj financiare dhe fizike. Me fjalë të tjera, rruzulli tokësor nuk mund të përjetojë një rritje më të madhe se sa kjo, si financiarisht, ashtu edhe fizikisht. Një rritje më e madhe çon drejt konsumimit të më shumë burimeve dhe rritjes së popullsisë së qyteteve, ndërkohë që konsumimi i madh dhe rritja e popullsisë ka nevojë për një rritje më të madhe. Ky është një rreth vicioz në të cilin ka hyrë njeriu, nga i cili e ka të vështirë të dalë.

Problemi konsiston në përkufizimin dhe perceptimin modern që ka marrë ekonomia. Ekonomia moderne e përkufizon vetveten në këtë formë: ekonomia është shkenca nëpërmjet së cilës vendoset një ekuilibër mes nevojave dhe kërkesave të pafund të njeriut dhe burimeve të limituara të natyrës. Në të vërtetë, nevojat e njeriut kanë një fund, kërkesat dhe dëshirat e tij nuk kanë fund.

Ekonomia moderne nxit dëshirat e njeriut, ndërkohë që burimet materiale të natyrës janë të pamjaftueshme dhe për më tepër nuk ndahen në mënyrë të drejtë. Për këtë arsye, ky realitet mban përbrenda një potencial konflikti. Atëherë ne duhet që të bëjmë një hulumtim dhe t'i kërkojmë llogari vetë sistemit ekonomik.

Vallë, shkenca e ekonomisë duhet të vendosë në raport të drejtë dëshirat e njeriut me burimet e natyrës apo duhet të harmonizojë nevojat e njeriut me burimet në fjalë? Pika e dytë që na bën të gënjim është vendimi i marrë nga takimi mbarë global i Kombeve të Bashkuara, që u organizua në Brazil, vendimi për një zhvillim të qëndrueshëm. Në të vërtetë, zhvillimi i qëndrueshëm është vetëm një këllëf për zhvillimin

e pakontrollueshëm. Duhet të marrim në llogari vetë format e zhvillimit. Zhvillimi është një ideologji dhe një politikë. Ai nuk është një dukuri teknike dhe ekonomike. Megjithatë, ekonomistët modernë, nëse mund të shprehemi edhe kështu, janë duke na bërë të besojmë atë që nuk është në realitet. Ideologjia e zhvillimit është e pamundur dhe nuk është reale. Për shembull, popullsia e SHBA është 302 milion banorë. Nëpër rrugët automobilistike të SHBA lëvizin miliona makina në një shifër që, për shtetet e tjera, as që mund të mendohet. Popullsia e Kinës është një miliard e 300 milion banorë, ndërsa popullsia e Indisë është një miliard. Kina dhe India janë duke bërë përpara në rrugën e zhvillimit. Le të mendojmë një çast se në Kinë dhe në Indi do të përdreshin aq mjete automobilistike sa përdoren në Amerikë. Atëherë jeta e gjallë në rruzull do të ndalonte brenda një jave. Ne nuk mund t'i bindim kinezët që të mos përdorin mjete automobilistike, ashtu si amerikanët dhe gjermanët. Kina sot e thotë fjalën e saj në jetën ekonomike, duke u zhvilluar me shpejtësi, por kinezët nuk konsumojnë shumë gjëra. Ata vetëm prodhojnë dhe shesin. Në qoftë se vjen dita dhe ata vendosin të njihen në skenën e historisë si konsumatorë, atëherë ne mund ta paramendojmë që tani situatën në të cilën do të bjerë planeti ynë.

Ky model i rritjes u hap rrugën pabarazive shumë të thella. Hap rrugën e një pabarazie të thellë mes shteteve, trevave dhe klasave shoqërore. Së dyti, ky model rritjeje është duke e tronditur prej themelesh ekuilibrin ekologjik, duke e shndërruar ambientin ku jetojmë në hapësira, ku njeriu nuk mund të jetojë. Së treti, kjo lloj rritjeje është duke shkaktuar konflikte dhe varfërim më të madh të popullsisë së globit. Sot, 17 për qind e popullsisë së botës kontrollon 80 për qind të popullsisë së botës.

Këtë situatë mund të kërkojmë ta kuptojmë duke shtruar nga qasje të ndryshme pyetjen: "Ku jemi duke shkuar kështu?". Për shembull, turqit mund të bëjnë mbi një bazë kombëtare pyetjen në formën: "Për ku është

duke shkuar Turqia?”. Hollanda dhe Jordania mund ta bëjnë këtë pyetje nga aspekti i tyre. Mund të pyesni edhe në formën: “Ku është duke shkuar bota islame, Bashkimi Evropian, Nato-ja, madje vetë rruzulli tokësor?” Në të vërtetë, unë mendoj se jemi duke shkuar drejt një krize që përbëhet nga tre rrahë, që janë të kapur me njëri-tjetrin. Unë do ta krahasoja situatën për ku shkojmë, në këtë mënyrë: Hëna është sateliti i Tokës, ajo sillet rreth saj, ndërsa toka së bashku me hënën sillen rreth diellit, i cili kryhen lëvizjen e tij, duke rrjedhur drejt një sistemi që quhet ylli Vega. E vërteta është se Hëna, Toka dhe Dielli janë duke shkuar të tre drejt të njëjtit vend. Tërvat dhe rruzulli tokësor janë duke shkuar drejt të njëjtit vend. Ky zhvillim mund të shndërrohet në situatë pozitive, në qoftë se njeriu mban një qëndrim të drejtë, në të kundërt, kiameti i kësaj popullsie do të jetë i pashmangshëm. Ashtu siç shpreheshin edhe mistikët myslimanë (sufi): “Kur priset njeriu, priset edhe gjithësia, ndërsa kur njeriu reformohet, vihet në vijë edhe rruzulli.”

Ne si myslimanë, kemi përpara tri pyetje, të cilave duhet t’u japim përgjigje:

1. Si mund ta kontrollojmë këtë rritje? Në të vërtetë, myslimanët e vrasin mendjen se si mund të rriten edhe më shumë në ditët e sotme dhe i studiojnë burimet e tyre të fesë, Kuranin dhe Sunetin, në mënyrë që të

gjejnë përgjigje për këtë pyetje që ata i drejtojnë vetes. Ky lloj studimi është i gabuar. Së dyti, ata i mbështesin ideologjitë e tyre politike më shumë mbi zhvillimin.

2. Duhet t’u japim përgjigje pyetjeve të mëposhtme: Si mund të bashkëjetojmë? Si mund të bashkëjetojmë si njerëz? Si do ta ndërtojmë drejtësinë e duhur për këtë lloj bashkëjetese? Ku do t’i gjejmë format e vërteta të kësaj të drejte? Cilat janë urtësitë e lirisë, moralit dhe krijimit të njeriut? Si mund të bashkëjetojmë pa gjetur përgjigjen e saktë për këto pyetje?

3. Si do ta kontrollojmë nefsin tonë? Kjo është njëra nga pyetjet më të rëndësishme, sepse ajo gjë që quhet liberal kapitalizëm, është një sistem i tillë që nxit gjithë dëshirat, kërkesat dhe epshet e nefsit, që mban gjallë të gjitha dëshirat e pangopura të tij, duke bërë që edhe dinamika edhe ana e dobët e këtij sistemi të mblidhet në një pikë. Kjo pikë është rritja. Sistemi forcohet duke u rritur dhe dobësohet kur rritja ndërpritet. Pasionet

dhe dëshirat e nefsit shkaktojnë dinamizmin e vërtetë që mundëson këtë rritje, prandaj nefsi duhet të jetë përherë në gjendje ngacmimi. Në qoftë se do të mund të gjenim instrumentet dhe rrugët e kontrollit të nefsit, atëherë mund të gjejmë edhe një zgjidhje ndaj kësaj ideologjie të rritjes.

Në të vërtetë, kjo krizë është edhe forma e daljes në pah të një konflikti të thellë që zhvillohet brenda njeriut. Në këtë moment njeriu është në konflikt me veten e tij, me tjetrin, me natyrën dhe me vetë Zotin. Atëherë, paradigma që do të na nxirrte prej kësaj krize, është ajo që do të arrijë të na vërë në paqe me vetë ekzistencën tonë dhe me njerëzit e tjerë që na rrethojnë, të cilët mund të mos mendojnë si ne dhe mund të mos besojnë tek ajo që ne besojmë, por ne mund të bashkëjetojmë me ta brenda një kornize juridike. Ne duhet të gjejmë një rrugëdalje, që do të na vërë në paqe me natyrën, krijesat e tjera dhe me vetë Zotin.

Njeriu nuk do të dalë nga kjo krizë, duke e restauruar apo duke e reformuar kapitalizmin. As nuk mund të dalë nga kjo krizë, duke u kthyer pas në socializëm apo duke marrë hua prej tij. Përfundimi ka hyrë brenda një rrjedhe shumë të rrezikshme. Tani ose do të dilet prej kësaj, ashtu siç ngjau në luftën e parë dhe të dytë botërore, duke e paguar krizën me humbjen e jetës së miliona njerëzve të pafajshëm, reflekset e shtetit

pas perdeve në SHBA parashikojnë një luftë të re, gjithëpërfshirëse, në hapësirat ku jetojnë myslimanët, e cila do të kushtojë miliona jetë myslimanësh dhe jo paqen. Përfundimi kështu i ka kaluar krizat e mëdha, duke bërë të shpërthejnë luftëra të mëdha. Ose ashtu si me rastin e profetit Jusuf, pas një periudhe bollëku që zgjati shtatë vjet, kemi hyrë në shtatë vitet e skamjes, të cilat mund t’i kalojmë vetëm në sajë të urtësisë dhe diturisë. Burimi i kësaj dijeje dhe urtësie është vahji (shpallja hyjnore). Këtë shpallje na e ka komunikuar profeti Muhamed dhe ai sot gjendet në Kuran dhe në Sunet. Të mos harrojmë edhe traditën e pasur të dijetarëve myslimanë dhe trashëgiminë e tyre intelektuale, të cilat duhet t’i marrim në konsideratë. Problemi i myslimanëve buron nga fakti se ne e lexojmë Kuranin, Sunetin dhe traditën, për të gjetur përgjigje për problemet dhe sfidat që na shtrën përpara modernizmi. Ne duhet të shpëtojmë nga kjo gjendje. Unë jam i mendimit se ne duhet ta rilexojmë traditën myslimane nga një perspektivë e ndryshme.

Një prej shkaqeve më të rëndësishme të kësaj situatë, është fakti që ideologjia e rritjes është ende në gjendjen më dominante. Në pikën që kemi ardhur, vetë rritja ka ardhur deri në limitet e saj financiare dhe fizike. Me fjalë të tjera, rruzulli tokësor nuk mund të përjetojë një rritje më të madhe se sa kjo, si financiarisht, ashtu edhe fizikisht.



DASHURI dhe VËLLAZËRI ME QENDER BESIMIN

Islami paraqet organizmin social si një strukturë me qendër besimin dhe me themel dashurinë dhe vëllazërinë. "Rruga për të hyrë në Xhenet", si një objektiv i largët i një myslimani, kalon përmes dashurisë dhe vëllazërisë. Andaj dhe i Dërguari i Allahut ka thënë: "Nuk mund të hyni në Xhenet pa besuar. Pa dashur njëri-tjetrin nuk mund të besoni. A t'ju tregoj një vepër që, nëse e bëni, do të bëhet sepse që të doni njëri-tjetrin? Përhapni selam-in ndërmjet njëri-tjetrit!" (Muslimi, Iman, 93.)

Ashtu siç shprehet në këtë hadith raporti mes besimit, dashurisë dhe vëllazërisë, po ashtu edhe në ajetet fisnike (3/103) thuhet që besimtarët që ndajnë të njëjtin besim me njëri-tjetrin, duhet të kapen fort pas litarit të Allahut, të përqafojnë mirë Islamin dhe Kuranin dhe të mos përçahen mes tyre. Vëllazëria dhe dashuria e shoqërisë islame reflektohet ngrohtësisht në çerdhen familjare. Andaj dhe ymeti, sipas qasjes islame, është krahasuar me një çerdhe të ngrohtë familjare, ku Pejgameberi (a.s.), është konsideruar babai, gratë e tij nëna (33/6) dhe besimtarët si vëllazër, fëmijët e këtyre prindërve. (Ibn Maxhe, Tahara, 16.)

Në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut e krahason

Prof. Dr. Hasan Kamil Jëllmaz

organizmin e shoqërisë myslimane me një trup të vetëm. Ashtu si sëmundja apo shqetësimi i një organi të vetëm sëmur tërë trupin, po ashtu edhe shqetësimet individuale apo të një grupi të tërë, shqetësojnë individët apo grupet e tjera të shoqërisë. (Buhari, Edeb, 27.). Ky botëkuptim është shembulli i të qenit i vetëdijshëm për vëllazërinë sociale të mbështetur në besim dhe dashuri.

Për arsye të dallimit social, ekonomik dhe gjinor të njerëzve, kur shohim përbërjen sociale të periudhës paraislame, vërehet se ata kacafyteshin dhe dhunonin njëri-tjetrin. Trysnia dhe dhuna që ushtronin fisnikët ndaj skllëvërve, të fortit ndaj të pafuqishmëve dhe meshkujt ndaj grave e vajzave në Mekë, kishte shkaktuar një shqetësim dhe një tension të përgjithshëm.

Botëkuptimi social që solli islami, bazohej mbi dashurinë me qendër besimin dhe vëllazërinë. Ky botëkuptim që vuri themelin e barazisë sociale, ka bërë

që njerëzit të jetojnë të lirë, ashtu siç kanë lindur dhe me të drejtat e tyre humane.

Kjo atmosferë që ka krijuar islami në Mekë, ka luajtur një rol të rëndësishëm për të ndërtuar një shoqëri të re islame në Medine. Islami, nga njëra anë i dha fund hasmërisë së hershme mes fiseve Evs dhe Hazrexh dhe nga ana tjetër, me një projekt vëllazërie, bëri vëllëzër muhaxhirët me ensarët. Kurani e shpjegon kështu këtë ngjarje historike:

“Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në sajë të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllëzër. Dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj.” (Ali Imran, 103.)

Sikurse bëhet e ditur edhe në ajet, dashuria dhe vëllazëria e bazuar në besim, është ajo që ngroh zemrat e mbushura me hasmëri dhe urrejtje. Besimi i bashkon besimtarët, ua ngroh zemrat dhe i bën të bien dakord mbi fjalën e Allahut. Në sajë të këtij besimi për hir të Allahut, u bënë vëllëzër që i duan të mirën dhe mëshirojnë njëri-tjetrin.

Ndjenja e vëllazërisë bën që të lihet mënjanë çdo lloj dallimi mes besimtarëve dhe të njësohen zemrat e tyre, që t’i drejtohen Allahut. Në Mesnevi-në e tij, Mevlana e përkufizon kështu hasmërinë dhe urrejtjen që kishin mes njëri-tjetrit fiset Evs dhe Hazrexh në Medinen paraislame: “armiq të përbetuar, saqë mund t’i pinin gjakun njëri-tjetrit”. Besëlidhja që u krijua në Medine, duke ndjekur formulën profetike **“Besimtarët janë vëllëzër. Atëherë, rregulloni marrëdhëniet e vëllëzërve tuaj.”** (el-Huxhurat, 10.), bëri që të zhdukeshin urrejtjet mes njëri-tjetrit. Kështu, ata u bënë një, si kokrrat e rrushit në vile.

Në një vile rrushi mund të ketë kokrra me shije të ndryshme. Disa mund të jenë të athëta e disa të ëmbla. Kur shtrydhen, shija e të athëtave përzihet me shijen e të ëmblave dhe në fund del një shije e mrekullueshme. Myslimanët medinas kur u shtrydhën me iman-in, u përzien me shijen e të athtëve; si përfundim doli në pah një vëllazëri e shijshme. Në sajë të kësaj, ymeti islam i përbërë nga muhaxhirët dhe

ensarët, të cilët ishin pjesë e Evs-it dhe Hazrexh-it, shijuan unitetin dhe vëllazërinë.

Sa bukur e shpjegon Mevlana përfundimin e unitetit dhe të bashkëjetesës me shembullin e kokrrave të një vileje të rrushit. (*Mesnevi*, II/3699-3715). Kur rrushi është i pabërë, të rrudh buzët prej shijes së athët. Shumë njerëz që nuk kanë fort kuptim individualisht, mbulojnë hapësirat, duke u bërë të vlefshëm në shoqëri. Me një shije dhe aromë tjetër zënë vendin e tyre në unitet.

Ata që ftojnë njerëzit në unitet, janë si ata që i ftojnë për në diell. Dielli një është, por kur rrezet e tij hyjnë në shtëpi nga dritaret, bëhen me mijëra. (*Mesnevi*, IV/415.) Në mendjen e njerëzve, sa ka shtëpi aq ka edhe diell. Por, kur shohim rrezet e diellit në shtëpi dhe prej aty shohim diellin, vërejmë se ai është vetëm një. Prandaj, ata që kërkojnë dritën, vetëm kur kërkojnë ndriçimin arrijnë në unitet, në unitetin e diellit.

Kur njeriu vëren burimin, sado shumë dhe në sasi qoftë gjithçka përreth, aty shikon njëshin dhe unitetin, gjë që e bën të mos i shikojë të tjerët apo veten të ndryshëm, pasi tek të gjithë ka një frymë hyjnore të njëjtë. Andaj, çdo njeri është i çmuar. Ky shpirt është ai që e shpie njeriun për tek ideja e unitetit. Kurse shpirti shtazor nuk ka ndonjë pasion të tillë për unitetin.

Islami solli bazat kryesore të shuarjes së dallimit mes arabit dhe joarabit, mes të bardhit dhe të ziut, mes shërbëtorit dhe zotërisë së vet (Muslimi, Haxh, 147.); duke ndaluar çdo lloj shfaqjeje të klasifikimit shoqëror mes njerëzve dhe diskriminimit racor dhe duke shpallur se, më të dalluarit janë vetëm ata që kanë përkushtim devotshmërie ndaj Allahut. Asnjë qeveri e krijuar gjatë 14 shekujve të historisë islame, nuk ka vepruar asnjëherë sipas qasjes së diskriminimit racor.

Të jesh pjesë e një race apo fisi nuk është në vullnetin e njeriut. Askush nuk pyetet para se të vijë në këtë botë se “fëmijë i cilës familje dëshiron të jesh?” apo “pjesë e cilës racë dëshiron të bëhesh?”. Kësisoj, aq sa është e pakuptimtë mburra e njeriut me atë çfarë nuk e ka pasur në dorë, po aq e pakuptimtë është



edhe përbuzja e tjetrit me atë çfarë nuk ka zgjedhur vetë të jetë.

Cilësia që i bën dobi më shumë besimtarit në dynja dhe ahireti, është të dojë dikë për hir të Allahut dhe atë që nuk e do, të mos e dojë për hir të Allahut. I Dërguari i Allahut e vlerëson këtë veçori si manifestim i përsosmërisë së besimit, duke treguar se ai që ka arritur në një besim, do ta shijojë shijen e besimit. (Buhari, Iman, 9, 14). Në Ahiret do të përfundojnë të gjitha miqësitë, afrimitetet, dashuritë dhe lidhjet, duke u bërë të gjithë armiq të njëri-tjetrit. Me një përjashtim të vetëm: ata do të jenë të devotshmit. (Zuhruf, 67.)

Prandaj dhe *atë që do, duaje për hir të Allahut*, është një portë e lartë dhe një status madhështor etik. Dashuria e sinqertë krijohet pas pastërtisë së brendshme. Zemrat që kanë harmoni ndërmjet njëra-tjetrës, dëlirësohen. Nëse nuk gjendet një harmoni shpirtërore mes zemrave, atëherë bashkëjetesa mes njerëzve mbetet vetëm në varësi të interesave. Vetëm harmonia dhe dashuria me qendër besimin mes zemrave, formojnë terrenin e mirësisë dhe bukurisë.

Ato çfarë përbëjnë identitetin e shoqërisë islame, janë vlerat fetare dhe njerëzore. Kurrë nuk është bërë shkak garimi, dallimi mes gjuhëve dhe racave. Komunikimi me gjuhë të ndryshme i ushtarëve që ruajnë atdheun, kurrë nuk ka krijuar problem.

Në Epokën e Lumturisë, përreth Profetit Muhamed (a.s.), ishin shkrirë nën çatinë islame si myslimanë; si arabi ashtu edhe iraniani, ebisnasi, romaku, jemenasi dhe të tjerë me kombësi, racë e fe të ndryshme. Gjatë këtij procesi, nga Epoka e Lumturisë gjer më sot, nuk është bërë kurrë problem përkatësia e feve dhe gjuhëve të tjera.

Ideja e kombësisë dhe e shtetit, që filloi që me revolucionin francez, u bë më pas fundi i shumë perandorive dhe shteteve të mëdha, duke dominuar me teoritë nacionaliste.

Perëndimorët pushtuan dhe më pas, me idetë shtetërore me qendër nacionalizmin, nuk arritën kurrë të

ngopen duke copëzuar tokat osmane, duke krijuar shtete të vogla. Sot, në Irak u kanë dhënë mundësinë të krijohen tre shteteve të tjera të vogla, në tri zona të ndryshme. Ka prej atyre që janë përveshur që këtë ta bëjnë edhe me Turqinë, për të ndezur marrëdhëniet mes njëri-tjetrit. Këta duan të krijojnë kaos, duke sjellë konfliktin turk-kurd për të prishur bashkëjetesën historike mijëra vjeçare.

Këto plane nuk do të arrihen, sepse bashkëjetesa jonë është me bazë respektin dhe vëllazërinë me qendër besimin. Imani dhe Islami janë komponentët kryesorë të këtij populli që jeton mbi këtë tokë. Që prej kohës së Salahadin Ejubit, janë imani dhe vëllazëria ato që i kanë bërë këta njerëz të bëhen bashkë.

Idrisi Bitlisi është një lider i rëndësishëm kurd, i cili bashkë me kurdët e tjerë myslimanë suni që kishte përreth, iu bashkuan Sulltanit Javuz Selim, duke e futur kështu këtë vëllazëri që rrjedh prej shekujsh, nën një çati të përbashkët. Ky proces i bashkëjetesës që nisi ai, ka vazhduar pa problem gjer në vitet e fundit të Perandorisë Osmane.

Rruga e Mevlana Halid Bagdadi-t është e një rëndësie të veçantë, për të mbrojtur shtresën sociale të njeriut të sëmurë të shekullit të XIX, që ishte konsideruar Perandoria Osmane. Lëvizja mistike islame që ai kishte nisur, jo vetëm në Irakin Verior, Siri apo Gjirin Persik,

por kryesisht në Stamboll dhe në mbarë Perandorinë Osmane, ka shërbyer në mënyrë mjaft efektive.

Liderët politikë dhe shtetërorë, si Salahadin Ejubi, Idrisi Bitlisi, Mevlana Halid Bagdadi dhe Said Nursiu kanë shërbyer si njerëz shpirtërorë dhe ideatorë. Me ta kemi qindra vlera të përbashkëta. Këta kanë kontribuar në mënyrë serioze për identitetin tonë shpirtëror dhe janë njerëz epiqendrorë, që na mbledhin të gjithëve.

Sot është një detyrë njerëzore t'ia përmendim këto të vërteta historike çdokujt që vlerëson unitetin dhe bashkëjetesën. Andaj është një përgjegjësi historike që të kujtohem se e kemi vëlla tjetrin, para se ta tëhuajsojmë.

Të jesh pjesë e një race apo fisi nuk është në vullnetin e njeriut. Askush nuk pyetet para se të vijë në këtë botë se “fëmijë i cilës familje dëshiron të jesh?” apo “pjesë e cilës racë dëshiron të bëhesh?”. Kësisoj, aq sa është e pakuptimtë mburrja e njeriut me atë çfarë nuk e ka pasur në dorë, po aq e pakuptimtë është edhe përbuzja e tjetrit me atë çfarë nuk ka zgjedhur vetë të jetë.



Dija të bën NJERI

Shejda Muhamed Konevi

"Allahu e di mirë ç'ka në zemrat tuaja"

Allahu i Madhëruar na e prezanton veten e Tij në shumë ajete kuranore, me synimin për ta njohur dhe kuptuar më mirë Atë.

Allahu i Madhëruar, në një ajet thotë kështu: **"Sido që të flisni ju, fshehtas apo haptas, Ai e di mirë ç'ka në zemrat tuaja."** (Mulk, 13) Siç mund të kuptohet nga ky ajet kuranor, Allahu e njeh më mirë nga ç'e njohim ne zemrën, egon, dëshirat dhe ambiciet tona.

Në një hadith, Profeti ynë i dashur (a.s.), thotë: *"Allahu nuk sheh pamjet tuaja të jashtme dhe pasurinë tuaj, por Ai sheh zemrën dhe punët tuaja."* (Muslimi, Ibn Maxe, A. bin Hanbel)

Kjo do të thotë se zemra është vendshikimi hyjnor. Andaj dhe njeriu, duhet ta mbajë të pastër zemrën, duke i flakur gjërat e këqija që mendon dhe ato të liga që i planifikon me zemër.

DITURIA ËSHTË E DOMOSDOSHME!

Meqë zemra është vendshikimi i Allahut të Madhëruar dhe meqë Allahu gjithnjë sheh në zemrat tona, atëherë ne duhet të bëjmë kujdes që qëllimi ynë në zemër të jetë i pastër dhe të marrim masa që gjithçka e jona t'i pëlqejë Allahut.

Natyrisht kjo gjë arrihet vetëm me dije. Vetëm përmes dijes mund të kuptojmë nëse veprat që bëjmë janë të mira apo të këqija apo nëse ato çfarë na kalojnë në zemër janë të gabuara apo të sakta. Andaj dhe njeriu, çfarëdo moshe të ketë, nuk duhet të ketë turp për të mësuar, duhet që gjithnjë të zbukurojë veten me dije të reja.

Nëse njeriu ka turp të mësojë, nëse nuk është në kërkim të njohurive të reja, ndahet injorant nga kjo botë. Injoranti do të pendohet pse nuk mësoi çfarë është e gabuar e çfarë është e drejtë dhe se çfarë do të ndërmjetësonte për të në Botën Tjetër.

Dija është më lart se çdo adhurim tjetër nafle (vullnetar). Ashtu sikurse trupit i nevojitet ushqimi, po ashtu edhe zemrës i nevojitet dija. Zemra e të cilit nuk ka dije është e sëmurë. Madje ajo ka vdekur. Mirëpo njeriu nuk e vëren këtë, për arsye të dashurisë që ndjen për dynjanë. Humbja më e madhe për një njeri është injoranca.

Hz. Hasan el-Basri ka thënë kështu: "Sikur mos të ishin dijetarët, njerëzit do t'u ngjanin kafshëve." Kjo do të thotë se njeriu duke u marrë me dije, ngrihet nga grada e kafshëve në gradën e njerëzve. Nëse dija mësohet për hir të Zotit, atëherë kjo do të thotë se

tek ai njeri ekziston frika ndaj Zotit. Vetëm në saje të diturisë arrihet bindja ndaj Allahut.

BOTA TË MASHTRON!

Allahu i Madhëruar na tërheq vëmendjen me disa ajete kuranore, duke na e bërë të ditur se çfarë na përmbys Botën Tjetër dhe çfarë është shkujdesja, e cila mund të na shpjerë në shkatërrim. Qëllimi ynë kryesor është të fitojmë Ahiretin.

Bota është mashtruese. Si një nuse që është zbukuruar për ne, sytë tanë e shohin, shpirti ynë është drejtuar drejt saj dhe zemra jonë është e dashuruar me të. Mirëpo ajo ka vlarë sa e sa simpatizantë të saj dhe sa e sa ithtarë të saj i ka poshtëruar.

Allahu i Madhëruar kur të na ftojë në audiencën e Tij, do të na pyesë: *“O rob i im! A nuk të dhashë shpirt? A nuk të dhashë sy? A nuk të dhashë këmbë? A nuk të dhashë shëndet? A nuk të dhashë pasuri? Ndërkohë që Unë të kam dhënë gjithçka, për derisa të kam dërguar edhe Kuranin përmes Profetit, po ti si po ma shlyen?”* Lum ata që do të dinë të përgjigjen!

Ç’gjendje do të kenë ata që nuk janë përgatitur t’i kthejnë përgjigje këtyre pyetjeve?! Ja, pikërisht ata do të ndajnë brengë dhe pendim të vërtetë.

Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, transmeton se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë këshutu: *“Allahu i Madhëruar ka thënë: O bir i njeriut! Nëse bëhesh ti prej atyre njerëzve që ushtron ibadetet ndaj Meje, Unë të pasuroj zemrën tënde. Pengoj gjithçka që ty të shpie në varfëri. Por, nëse nuk sillesh në këtë mënyrë, ty të bëj një njeri të lidhur me dynjanë dhe as që pengoj rrugët që ty të çojnë në varfëri.”* (Ibn Maxhe, Tirmidhiu)

Disa njerëz, megjithëse janë shumë të pasur, nuk gjejnë mundësinë të hanë të qetë. Po mirë, kjo pasuri ç’u duhet? Andaj, veçanërisht të pasurit, ngaqë jetojnë në pasuri, duhet të mos e marrin në konsideratë dynjanë.

SI E GJEN PREHJEN SHPIRTËRORE NJERIU?

Hasan el-Basri, rahmetull-llahi alejhi, shkruan këto në letrën dërguar Omer Bin Abdulazizit:

“Dynjaja është një banesë e përkohshme. Nuk qëndrohet vazhdimisht aty. Ademi, alejhis-selam, është dërguar për në dynja në shenjë dënimi për fajin që bëri. O këmbësi i besimtarëve! Bëj shumë kujdes ndaj jetës së dynjasë. Ushqimi më i mirë për emigrimin nga dynjaja në ahiret është të jetuarit në kundërshtim me ambiciet e egos së tërbuar. Pasuria më e madhe në dynja është mbështetja e njeriut tek Allahu Fuqiptotë, duke njohur pafuqinë e vet. Dynjaja e poshtëron atë që punon për të.

“Allahu i Madhëruar ka thënë:

O bir i njeriut!

Nëse bëhesh ti prej atyre njerëzve

që ushtron ibadetet ndaj Meje,

Unë të pasuroj zemrën tënde.

Pengoj gjithçka që ty
të shpie në varfëri.

Por, nëse nuk sillesh në këtë

mënyrë, ty të bëj një njeri

të lidhur me dynjanë

dhe as që pengoj rrugët

që ty të çojnë në varfëri.”

Atë që është në përpjekje për t'u bërë i pasur materialisht, e bën edhe më të varfër.

Jeta që e mashtron njeriun është sikurse helmi që pihet në padijeni. Njeriu ha me një oreks të madh atë ushqim që nuk e di se është i helmuar. Porse, faktikisht vdekja është e fshehur brenda saj. Kështu janë edhe dëshirat e tërbuara të egos. E shmangin njeriun nga rruga e vërtetë dhe e shpien në shkatërrim. Kësisoj, mjeko veten, sikurse një i plagosur mjekon veten. Njeriu, që nuk ha ushqimet që dëshiron, do të thotë që ka zgjedhur të bëjë dietë, që të mos i përkeqësohet sëmundja."

Ai që ka mangësi në ibadetin ndaj Allahut të Madhëruar dhe që është i lidhur me dynjanë, ngaqë nuk di se çfarë i duhet, nuk shpëton dot nga shqetësimet dhe problemet. Dynjaja i bëhet si një burg. I jep lamtumirën kësaj bote pa u përgatitur për ahiretin. Njeriu arrin në prehjen shpirtërore në këtë botë dhe në tjetrën vetëm kur i drejtohet Allahut të Madhëruar.

DYNJAJA ËSHTË E PËRKOHSHME, KURSE AHIRETI ËSHTË I PËRJETSHËM

Njohja e Allahut të Madhëruar ka një rëndësi të posaçme në fenë islame. Ne nuk zbatojmë ndalesat dhe as lejimet si duhet dhe mbesim të dobët ndaj fesë sonë, për arsye se nuk e njohim vërtet Allahun e Madhëruar.

Allahu i Madhëruar, për t'ia prezantuar veten njerëzve, u jep mundësinë e veprave të mbara. Andaj dhe Allahu i Madhëruar thotë në ajetin fisnik: **"Allahut i takojnë thesaret e qiejve dhe të Tokës."** (Munafikun, 7)

Allahu duhet njohur mirë. Duhet mbështetur tek Ai dhe duhet pranuar se gjithçka vjen prej Tij. Nuk duhet të dorëzohemi tek Ai vetëm me gjuhë, por edhe me zemër e shpirt dhe gjithçka duhet prituri prej Tij. Kur është kështu, Allahu i Madhëruar nuk kthen mbrapsht asnjëri.

Sikur t'i kemi në duar të gjithë dhuntitë e kësaj bote, sikur të gjithë njerëzit t'i kemi nën shërbimin tonë, asgjë prej tyre nuk përbën ndonjë vlerë për jetën tjetër. Sepse dhuntitë e kësaj bote janë të përkohshme. Vetëm dhuntitë e botës tjetër janë të përhershme.

Falënderimet i takojnë Allahut të Madhëruar që na ka dhënë besimin, si një dhunti të madhe. Besimtarët e vërtetë, në ditën e kiametit, kur të hyjnë në zjarr, zjarri do t'u thojë: **"O besimtarë! Kaloni shpejt. Drita e basimit tuaj, po fikën flakët e mia."**

Allahu i Madhëruar, në një ajet kuranor thotë kështu: **"Çfarëdo që të shfaqni apo të fshihni, (dijeni se) Allahu është vërtet i Gjithëdijshëm për çdo gjë."** (Ahzab, 54). Pra, Allahu e di atë që është e fshehur në zemrën tonë. Ai e di kur në zemrën tonë hyjnë një

dashuri tjetër përveç dashurisë ndaj Tij.

Një prej njerëzve të veçantë të Zotit, thotë:

"Një ditë dola në udhëtim. Ndërkohë që u ndala diku, m'u mbloodhën përreth të gjithë kafshët, sikur të isha edhe unë një prej tyre. Kur pashë një sorkadhe të vogël që më erdhi pranë, mendova: "Sikur ta merrja këtë sorkadhe dhe t'ia çoja tim biri, të luante me të". Pas kësaj, menjëherë u shpërndanë të gjithë kafshët."

Kuptova që Allahu i Madhëruar desh të më thonte se, mbi dashurinë ndaj Tij, nuk duhet vendosur dashuria për tim bir. Menjëherë u pendova dhe bëra istigfar. Pastaj, pashë që sërish të gjithë kafshët m'u mbloodhën përreth."

Ashtu sikurse mund të vërejmë edhe këtu, Allahu i Madhëruar na kontrollon zemrën tonë çast pas çastit. Ndërkohë që Allahu i Madhëruar është kaq i vëmendshëm ndaj zemrës sonë, me ç'arsye sillemi sikur nuk e kuptojmë këtë, sikur nuk na sheh, sikur nuk na kontrollon?

Këtë duhet ta kuptojmë mirë, se mëshira dhe dhembshuria e Allahut të Madhëruar është arsyeja e vërtetë se përse akoma qëndrojmë në këmbë, përse nuk jemi dëbuar nga prania e Tij, duke pasur parasysh neglizhencën dhe të gjitha mangësitë që na karakterizojnë.

LE T'I FORCOJMË MURET E KËSHTJELLËS SONË

Dorëzimi në fuqinë dhe madhësinë e Allahut të Madhëruar është një kështjellë prej floriri. Besimi tek Allahu i Madhëruar dhe përkujdesja ndaj të lejuarave dhe të ndaluarave është një kështjellë prej argjendi. Mbështetja tek Allahu i Madhëruar është një kështjellë prej hekuri. Ndërsa të pasurit të edukuar egon, është një kështjellë prej dheje të butë. Pikërisht nga kjo fortesë e butë hyn fillimisht shejtani, pastaj me radhë, i pushton edhe fortesat e tjera, Allahu na ruajt, nuk resht derisa na merr edhe imanin.

Andaj, këto kështjella duhet t'i ruajmë mirë përballë shejtanit. Fortesën e edukatës, e cila është edhe fortesa më e fundit dhe më e dobëta, duhet ta forcojmë duke e edukuar me ndalesat dhe lejimet e Allahut, që të mos gjejë forcë të sulmojë kalanë e besimit.

Nëse mbrojmë veten brenda këtyre kështjellave dhe dëgjojmë këto këshilla, atëherë shejtani mbetet si një qen që leh pas kështjellës. Kësisoj, shejtani s'ka ç'të na bëjë. Por, nëse nuk ekzistojnë këto kështjella, atëherë shejtani gjithnjë na sulmon.

Allahu i Madhëruar na mbroftë gjithmonë dhe na bëftë të mundur që të veprojmë punë të mbara e të singerta. Amin!

Kapaciteti i mendjes dhe fuqija e bindjes

Shumë njerëz kujtojnë se njeriut për të qënë I mbaruëm I mjafton ditunija. Sa lark!... Ditunija po nuk pati ndihmat që I duhen rreth qarkut qi ka përmbledhun nuk asht gja tjetër për veç një tualeti në fytyrë të shëmtuëme, vec se një petku I veshun në një trup shtrëmbanik.

Të mejtohem ma parë, ç'asht jeta? A nuk asht një prrallëz plot andrrale qi vazhdon drejt një misteri të panjohun; tue qenë para këtij kaosi, si mund të themi se jeta e shkurtun e njeriut mjafton deri sa me i msue djanat qi na duhen me rruë me jetuë.

Jemi tue jetuë mbi Teren, por kjo Botë midis një deti të gjanë pa kufi, e pa fund, i shëmbllën – një nisie të vogël; trupi t'onë me kufit e tij të ngusht nuk asht e mundur t'a përfshij atë pa-kufizim, e pa fundsi gjinore natyrale; tue kuptuë si duhet fillimin e kësaj të vërtetë nuk asht e mundun për çë do njëri të matunit e përparimit me kohë e llohë; se kapaciteti i mëndjes njeriut nuk asht pa kufi, e cila zhvillohet deri m'atë shkallë qi ka fuqi Nevri i posaçëm; një mëndje tjetër mund të kalojë kufinë qi mejtojmë nee, por kjo i takon tjetrit dhe vet duhet të barazohemi me fuqiën qi kemi; tashi atje ku na çon fundi I fuqiës mëndore në pikën e fundit mbretnon bindja e jonë të cillën jemi të detyruëm me e mbrojtun deri sat ë vdesim.

Në jetë pa kurajo nuk mund të rrojmë, por për me pasun kurajo duhet të kemi bindje. Për të pritun, pa durim nuk mund të rrojmë por për me pasun durim prap duhet të jemi të bindun.

Përfundimet qi mund të shtjerë njeriu ne dorë janë të pa ënrueshëm, por deri sat ë fusë në dorë ato të pa qëndrueshëm, por deri sat ë fusë në dorë ato të pa tronditshmet duhet të duroj deri sa t'l vije guxi-mi, po t'mungojë ky, vjen vet-vetiu dhe e përfshijnë periudha e dëshprimit.

Midis besimit dhe bindjes ka një diferencë të ma-

dhe; besimi asht një vendim qi e nep inteligjenca por bindja asht një ndjejë qi themelohet me anën e ndihmën e të e të provuëmeve qi qi ngjajnë në jetë të njeriut; me të vertetë pot ë mejtohem kuptojmë se ç'do njeriu në vedi ka bindje e cila përmbledhet herë rreth një feje, një principio se teorië.

Themi nga një herë akcili njeri nuk ka bindje në ketë çashtje; kjo nuk asht e vertetë; se ksodore ne ky person jo qi nuk ka bindje por ndodhen cilsina të jasht-zakonshme qi e futin në kundërshtim të mos jetë besniku I një bindjes port ë ndodhet lojë e bindsinavet të ndryshme.

Për të qënë në jetë njeriu fat-bardhë ndonse duhet me pasun shumë gjana por me kuptimin qi dhamë ma naltë e qi ka vet-vetiu, bindja asht e para e para e ktyne dhe mund të thohet themeli i gjallnisë; në një poezië të naltë I Madhi Ali thotë:

Rrizku asht i ndamë së pari,
keq-mendimi s'ban dobië,
I vobekt asht lakmitari,
I pasun kush ka bindësitë.

Pra a dëshirojmë me I përmbajtë në vend lëvizjet negative qi ka trupi I jonë? n'asht po! Duhet t'a dimë se këto janë: dyshimi, pesimizma, trembdija, mos-mosmbesimi; këto janë qi na shkatrojnë fat-bardhësië, qi na zhdukin kapacitetin e punimit. Të shpikim në vedi një gja qi mund të na shtrojë qëllimet e qi mund t'l bindemi, dhe ksodore ksajë le t'i lidhemi me një besim të pa tronditun, tue provue ndodhinat rreth kësajë së vertete morale; këto prova do të pjellin ndër nee një far zakoni I cili asht sigurim i veprimevet t'onë.

A duëm të pelqehemi midis shokve? e lyp puna të mos jemi të hequn në kanë të vet-pelqimit; se ky asht ma shumë negative nga lëvizjet e tjera; duhet pra të jemi në marrëveshje me miqt,në shkëmbim mendimesh, se tue shartue bindjet t'ona në zembër

t' atyne, forcojmë provat dhe shumë herë ketë rast përfitojmë për me ngjallë bindjen e nevojshme. Në qoftë se me tanë kupëtimin e fjalës kemi bindsi të plotë n'idenë t'onë duhet me e përndamë ate gjith kah qi asht nevoja.

Bindsiët e përfitueme duhet njeriu mos me e i ndryshue shpesh herë edhe kur i ndryshon duhet me e dite se në ketë mëndyrë këto nuk i ka të the-meluëme në fundin e besimit shpirtnuëm.

Një të riut qi mund të më thotë se nuk I mbeson të Madhit ZOT e pyesë kujt i mbeson pra? po qi ky i ri me gjith kënaqësinë ndiesore ka një far mbesimi dhe asht i bindun pa druajtsië në një ide qi i ushqen shpirtin e ti ,mund të themë se ky indirect pohon fuqiën e mohuëme, po të provuem nder vet-vedi; në qoft se nga nen-vehtja e nga shpirti ka ngritun bindësiën morale,sociale qi i siguron feja dhe , vend-in e këtyne e ka lanë zbrazun asht i hupun krejt moralisht i shumë vleftsisht por vetëm kotëë sa qi duket i gjallë!..

A duem fat-bardsiën? Ma parë duhet të rregullojmë jetesën në një trajtë të merituëshme due barazue ushqimet landore dhe shpirtnore: pasunia, buja, dobinat materijale, nuk janë ata mjete qi ushqejnë edhe shpirtin pra pa shirt si nuk ka vlett kufoma edhe dobinat materijale pa ato qi janë ma syperiore, e qi janë vlefat morale nuk asht e mundum t' l sigurojmë fat-bardhsi njeriut; jemi tue pa shum pasanik qi nuk janë në fatbardhsi dhe shum të vobekët qi heqin një jetë ma të kënaqshme se ata. Atëherë pra nuk a nuk kemi të drejtë të themi se florin vetëm nuk asht mjeti i lumtunisë po perkundrazi ky asht një zjarr I kuq qi ka tretun e shkrirë palcën e moralit të njeriut qi s'ka ditë me e përdorë I cili me gjith qi duhet të përvjelin shpërbimin e punimit të vet por nuk duhet të perpiqet tue lidhur shpirtin ç'mendsisht të shperblesa: florin i shkretë!

Për njerën e vertetë shtytsi kryesuër në përpjekjet e në punimet gjallnore nuk duhet me qenë vetëm amori ndergjegje- cënuë i kësajë flake të kuqe, por duhet me qenë dashunija kundrejt bijvet, familjes, societies, dhe ndjenjat shirtnore me i bamun mirësi dhe ndihmë tjetrit.

Këjo asht një bindje qi e naltson njerën dhe këjo asht themeli I vertetë qi permban në kambë ngrrfsinën madhshtore të lumnisë e të fat-bardhsiës së

vertetë; këjo bindje e naltë në histori vertetohet me luftat e të demokrasisë ashtu edhe me përpjekjet e sakrificat e dijetarvet qi venë jetën e tyne në rrezik për realizimin e bindjes së tyne, e dobishme edhe për njerziën.

Njeriu qi dishiron të naltsohet në ketë shkallë duhet të këndojn jet-shkrimet e atyne herojve qi për realizmin e fuqiës bindsore i kanë durnë tanë heqjet e keqe tue marë parasyshë ç'do far theorie; duhet të dij se per një ide' se sa trupe janë shkri nen ketë dhe' i cili me gojën e pa ngijun rrin gati-rrufitës si një ku çedër por nuk e ka kthym e nuk ka mund me e thyem vullndetin e çeliktë t' atyne qi kan nje bindje themelore në thellsinat e zhvilluëshme të shpirtit.

Aleksandrin e madh cila fuqië e çojë deri n'Indië? Kristof Kolombin cila fuqië e drejtoj n'Oqeanet e gjana të çelin velat e anijës drejt orizonave të pa njehuna për me gjetun rrugë tjetër e me kalue n'Indië? Vetëm e vetëm bindja e tyne qi kan pasun në vedi të qendrueshme e të pa thyëshme! Skender Beg Katriotin, cila fiqië e hoqi nga Turkia dhe e solli në Shqipnië tue e shty t'i sylmojë një anmikut me qindra herë ma shum se Shqyptarët? Dashunia e Atdheut q'ish fuqizuë në shpirtin e tij si një bindje e shejtë!... Mustafa Qemal Pasha i Turkisë re', kur therriste atdhetarët në Luftën e shpëtimit, pse nuk u trëmb nga fuqitë e Grekut e të Antantës fituese? Se bindja e tij ballazi këtyne fuqive ishte ma e fort, dhe e shifte para syshë Yllin e Turkisë gati-aguës në mbarim të një nate të zezë.

Heroj i kombit t'onë A.ZOGU, pse nuk u trëmb nga fuqia okupuese, kur Kongresi Historik i Lushnjes e ngarkoj të çelin rrugen e Tiranës? Pse u hodh në zjarrin e kaqi luftimeve e mu në fund durojë gjith të këqiat q'i banë anmiqët tue mos u rresht sa një herë nga theorit morale e materiale? Se ky ishte i bindun ndër veht-vedi dhe, asht besniku i gjithëhershim i asajë bindjeje sa qi me meriten e plotë u naltësuen deri në shkallën ma të naltë të Shtetit t'onë.

N'asht se në Historinë e pergjithëshme gjejmë këto e si këto të tjer Heroj qi me përpjekjet mrekullore janë bamun rrugë-heqësit e kombeve dhe shpëtimtarët e tyne, duhet ta dimë se veprimet kësodore nuk janë gja tjetër veç përfundimet e pjelluna nga martesat e kapacitetit menduer me fuqinë zhvillimtare të një bindjeje të ngulshëme shpirtënore.

Popujt do të ekzistojnë për sa kohë që do të ruajnë parimet dhe bazat e moralit

Burimi hyjnor i Islamit, Kurani, thekson rëndësinë e koncepteve të moralit, dashurisë, mëshirës, përkushtimit, sakrificës, tolerancës dhe paqes. Myslimani që i zbaton siç duhet në jetën e tij këto parime, bëhet një njeri i sjellshëm, i thjeshtë, i drejtë, i besueshëm dhe me të cilin mund të krijohen marrëdhënie të sigurta. Ai reflekton përreth tij dashuri, respekt, harmoni dhe kënaqësi.

Morali është një ndër elementet kryesore që formojnë një mysliman të vërtetë, të edukuar dhe të vetëdijshëm rreth parimeve islame.

Çdo civilizim ka si kusht tri gjëra, në mënyrë që të mbijetojë dhe të zhvillohet. Ato janë kushte financiare, shpirtërore dhe morale. Civilizimi islam është civilizimi i vetëm që i plotësoi të tria këto kushte dhe ky është shkaku përse civilizimi islam vazhdoi për trembëdhjetë shekuj, pa pësuar asnjë deformim në parimet e tij. Të gjithë civilizimet e tjerë: pers, romak, egjiptian, grek etj..., nuk arritën kurrë t'i plotësonin këto tre kushte.

Popujt do të ekzistojnë për sa kohë që do të ruajnë parimet dhe bazat e moralit. Kur ato rrënohen, mos pyet pse zhduken popujt.

Morali zë vendin më të rëndësishëm në fenë tonë dhe është sekreti dhe urtësia me të cilën Zoti dërgoi profetin Muhamed (a.s.). Këtë e ka pohuar vetë Profeti (a.s.), kur ka thënë "Jam dërguar ta përsos moralin".

Ky hadith, është tregues i moralit të lartë të Profetit (a.s.). Pra, Ai ka ardhur të vendosë moralin e lartë, ta përsosë atë. Morali ka baza të hershme dhe Profeti (a.s.), ishte perfeksionuesi i tij.

Tëksa lexon këtë hadith, dikush mund të pyesë: "Si është e mundur që Pejgamberi (a.s.), qenka dërguar për të përsosur moralin?!"

Në fakt, morali është gjëja më kryesore për mbarëvajtjen dhe lumturinë e një shoqërie. A mund ta imagjinoni se si jetohet në një shoqëri, në të cilën dominon mashtrimi, frika, veprat e ulëta, ligësia, pasiguria etj.? Nëse në një sho-

qëri ekziston një person negativ, të cilit të gjithë i druhen se mos i vjedh, i vret dhe i bën të mos ndihen të sigurt, e gjithë shoqëria ndihet e pasigurt.

Kur myslimanët vajtën në Abisini, mbreti abisinas u kërkoi sqarime rreth fesë islame. Xhafer ibn Ebu Talib, ishte ai që iu përgjigj. Ai nuk i foli gjatë, siç e kanë zakon disa ftues në fe. Ia përmbloodhi fenë në disa norma morale, të cilat bëjnë për vete çdo njeri. Xhaferi i tha: "Ne kemi qenë një popull injorant, adhuronim idhujt, të fortët prej nesh shtypnin të vobektët, me komshinjte dhe farefisn shkonim keq... Nga mesi ynë, Zoti dërgoi një profet, të cilit ia njihnim prejardhjen, moralin, sinqeritetin dhe besueshmërinë. Ai na urdhëroi të themi të vërtetën, të çojmë në vend amanetin, të shkojmë mirë me farefisn..."

Duket qartë që Xhafer ibn Ebu Talib e kishte kuptuar drejt islamit. Ai nuk i përmendi aspak pesë shtyllat e islamit, por përmendi objektivat e tyre. Në fillim, Xhaferi foli mbi të metat e jetës së tyre para islamit, ku të gjitha vërtiteshin rreth normave morale. Më pas, e prezantoi me Profetin (a.s.) dhe të gjitha cilësitë e tij ishin morale. Në fund, e njohu me normat dhe ligjet që kishte sjellë ky Profet, të cilat ishin sërish morale dhe edukative. Siç e shohim, ai i foli për moralin.

Umeti mysliman i ngjan një peme, e cila lëshon filiza me njohjen e Zotit, ushqehet me adhurimin e Zotit. Frytet e saj janë morali i lartë, edukata dhe mirësjellja. Frytet tregojnë sa mirë ushqehet një pemë dhe sa kujdes është treguar për të. A e imagjinoni dot si do të ishte situata në botë, nëse morali i myslimanëve do të ishte ashtu siç duhet të jetë? Nëse kjo do të ndodhte, as mijëra media nuk do të mund ta deformonin imazhin e islamit. Metoda më efektive për të ftuar të tjerët në islam është morali i mirë.

Bëhuni të edukuar, se nëse jeni mbretër, fitoni lumturi, nëse jeni njerëz të shtresës së mesme, bëheni të famshëm, nëse jeni të varfër do të pasuroheni. **(Nga libri Edebul mexhalis).**

Hasan Haki pashë Bushatlliu

Në veprën e tij, "Poetët e Shkodrës", Ali Emiri pohon se ka shkruar vetë në fshatin Bushat, që gjendet tri orë larg Shkodrës dhe që ishte shndërruar në gjendje të mjerë, për shkak të moçalishteve të krijuara në këtë fshat, pasi lumi Drin ndërroi rrjedhën e tij, duke bërë që Bushati i dikurshëm me shtatëqind deri në tetëqind shtëpi, të mos e kishte pasurinë që kishte më parë. Ai pohon se në Bushat ka gjetur disa dorëshkrime me vlerë dhe një akt peme gjenealogjike (silsilename). Mbështetur në këtë pemë gjenealogjike (silsilename), ai jep trungun familjar të Bushatlinjve, duke filluar nga Ibrahim Halil pasha, biri i Koxha Mehmed pashës, biri i Mustafai, biri i Mehmed bej Kapedanit, biri i Sylejman pashës, biri i Ymer beut, biri i Mehmed pashës.

Koxha Mehmed pasha pati treguar aftësi drejtimi dhe ushtarake, kur gjendej në detyrën e ruajtësit (muhafiz) të kalasë së Shkodrës, prandaj në vitin 1763 që emëruar vali i Shkodrës nga ana e shtetit osman, duke u dekoruar me gradën e vezirit.

Ai kishte shërbyer plot katëmbëdhjetë vjet si vali në Shkodër, duke siguruar një administrim të mirë të këtij vilajeti dhe pati ndërtuar në lagjen Tabakë të Shkodrës një xhami elegante me tetë apo dhjetë kube.

Në hyrje të xhamisë gjendej pllaka e ndërtimit (monogram) të xhamisë, nga ku mësohet se kur ka përfunduar ndërtimi i saj, viti 1187.

Sipas Ali Emirit, punët e mira dhe paratë e sadakasë, që pati shpërndarë Mehmed pasha me rastin e përfundimit të xhamisë dhe përrurimin e saj, ende rrëfihen gojë më gojë nga banorët e këtij vendi.

Mustafai dhe Mehmet bej Kapedani nuk kanë qenë ndonjëherë valinj në Shkodër, por me detyrën e mbrojtësit të kalasë.

Sulejman pasha ka qenë vali në Shkodër dhe në Rumeli, deri në vitin 1698.

Ymer beu kishte qenë me detyrë vali, ashtu siç që emëruar edhe i ati, Mehmet beu, pasi kishte përbushur më parë disa detyra shtetërore. Si vali, ai kishte qenë deri në vitin 1664.

Sipas Ali Emirit, i pari i Bushatllinjve të Shkodrës, Koxha Jusuf beu, shtatë apo tetë barqe prej të cilit rridhte Mehmed pashë Bushati, kishte pasur fatin të takohej me vetë sulltan Mehmetin II.

Hasan Haki pasha lindi në qytetin e Shkodrës, në vitin 1826.

Gjatë kohës që ishte në Shkodër, kur ishte ende adoleshent, së bashku me vëllain e tij më të madh, Mahmud pashën, u dekoruan në vitin 1827 me gradën mirmiran dhe, pasi i ati i tyre Mustafa pashë Sherifi Bushatlliu, përbushu detyrën e tij si vali i Shkodrës, të cilën e kishte kryer prej 23 vjetësh, ashtu siç edhe u shpall me imtësi në kopjen e gazetës Takvim-i Vekaji të vitit 1832, u largua nga detyra e valiut të Shkodrës dhe së bashku me familjen e tij shkuan në Stamboll. Kur ishte në moshën shtatëvjeçare, ata u pranuan në audiencën e sulltan Mahmudit II, veshur me rroba shqiptare.

Sulltani pati urdhëruar që të jepej leja perandorake, në mënyrë që ai të vishej me rroba të stolisura, ashtu sikurse urdhëroi që t'i dhurohej edhe një sahat. Të gjitha këto janë të shkruara në gazetën Takvimi Vekaji të atij viti.

Hasan Haki pasha, pasi fitoi dije dhe njohuri, si dhe plotësoi

përgatitjen në artin e shkrimit (fenn-i kitabet), në vitin 1845 u rrit në gradën e mirmiranit, që e gëzonte që në moshë të re në shkallën mirmiran sani dhe u emërua në zyrën e sekretarisë së ministrisë së jashtme (mektubi-i hariciye kalemi).

Duke vazhduar për një kohë të gjatë detyrën në Portën e Lartë, ai arriti në vitin 1855 gradën ula sani, ndërsa në vitin 1857 mori gradën ula evvel.

Më pas u emërua në mënyrë të vazhdueshme, pa u liruar asnjëherë nga detyra, në postet e mytesariffllëkut në Midilli, në vitin 1862, në Rodos, në vitin 1864, në Biga, në vitin 1865, në Varna, po në atë vit, në Kytahja, në vitin 1868, në Izmit, në vitin 1872, në Nigde në vitin 1873, më pas në Herceg dhe në Filibe, në vitin 1875. Në të gjitha këto poste ai shërbeu në mënyrën më të mirë, prandaj edhe në vitin 1874 u dekorua me gradën mexhidije të rangut të dytë.

Në vitin 1292 (1875) ai u dekorua me gradën bala dhe më pas u emërua në mytesariffllëkun e Mamuretulazizit, në vilajetin e Diyarbakirit.

Në vitin 1876 ai u emërua në detyrën e valiut të Vanit, duke marrë edhe gradën e vezirit. Në vilajetin në fjalë, deri sa ishte në valillëk për plot shtatë vjet, ai shërbeu më së miri dhe veçanërisht gjatë luftës me Rusinë, ai pati treguar mendjehollësi, politikë dhe administrim të situatës deri në vitin 1883, kur u nda nga kjo detyrë. Më pas, në vitin 1885 u emërua në vilajetin e Selanikut.

Në vitin 1887 u emërua në anëtarësinë e komisionit për punët publike (nafia) dhe në muajin tetor të vitit 1888, u emërua në vilajetin e Halepit, ku shërbeu për një vit e gjysmë. Në muajin shkurt të vitit 1890 u nda nga kjo detyrë dhe u kthye për herë të dytë si vali i Halepit, në muajin qershor të vitit 1894.

Kur Ali Emiri u emërua në detyrën e defterdarit të vilajetit të Mamuretulazizit, në muajin qershor të vitit 1895, gjatë rrugës për në vendin e detyrës së shtetit pati ndaluar në qytetin e Halepit, që ndodhet në itinerarin e rrugës, ku u takua për të parën dhe të fundit herë me Hasan Haki pashën dhe bashkëbisedoi me të në lidhje me letërsinë dhe historinë.

"Megjithëse nga trupi ishte i vogël, çehrja e tij të linte të kuptoje se fizikisht që më i lodhur nga jeta, sesa nga mosha që kishte." - do të shkruante Ali Emiri për të.

Ndonëse ishte në moshën shtatëdhjetë e një vjeç, ai u kthye në Stamboll, kur i erdhi urdhri se detyra e tij kishte përfunduar në muajin korrik të vitit 1895. Atje, pas shtatë muajsh, pra më 17 maj 1896, e dorëzoi shpirtin për në banesën e përjetshme.

Nuk pati fëmijë, sepse nuk u martua.

Ai zotëronte shumë libra të rrallë dhe i takonte tarikait mevlevi. Në kapakun e pasmë të librave e kishte zakon të shkruante një distik (bejt) dhe të shënonte firmën e tij, Hasan Haki Mevleviu.

Ai fliste pesë gjuhë: shqip, frëngjisht, arabisht, turqisht dhe persisht.

Ali Emiri kujton se, kur që takuar me të në Halep, i pati thënë se kishte bërë gati një divan, ku kishte përmblodhur poezitë e tij.

Tregimet Islame

Një grup letrarësh, shkrimtarësh, filozofësh dhe etikistësh myslimanë kanë shkruar tregime letrare, filozofike, historike dhe etike. Ka pasur prej studiuesve, si orientalisti gjerman Adam Mez, që këtë kalim të arabëve, nga poezia tek tregimi e kanë konsideruar si një tregues i venitjes së fuqisë letrare arabe, pasi arabët shquheshin për poezinë dhe oratorinë.

Kulturën letrare arabët e kishin formësuar kryesisht mbi poezinë. Ata shquheshin si poetë e oratorë, fjala vjen, kurejshitë shquheshin si hazërxevapë, aftësi e cila nuk mund të gjendej lehtë tek joarabët. Ky është edhe dallimi: joarabët ishin më mendimtarë, ndanin më shumë kohë për procesin e të menduarit. Andaj dhe tregimet e shkruara në botën islame ishin kryesisht nga myslimanët joarabë.

1. TREGIMET LETRARE

Si tregime letrare mund të veçojmë ndër më të njohurat: *Njëmijë e një net* dhe *Lejlaja me Mexhnunin* etj. Janë shkruar po ashtu edhe një seri anekdotash dhe tregimesh humoristike, si: *Miku i vetmisë* (Unsul-ferid) i Miskevejh-it, *I dashuruar pas lopës*, *Macja dhe miu*, *Jash-tëqitja e shendëve*, *Aromëmiri* etj.

Le të ndalemi pak tek veprat më identifikuese të letërsisë arabe:

a. "NJËMIJË E NJË NET"

Krahas tregimeve dhe novelave të tyre origjinale, letrarët myslimanë kanë përkthyer dhe mbledhur disa tregime që qarkullonin, duke i pasuruar ato me arabeskat dhe duke i dekoruar me kulturën perse. Një prej tyre është pikërisht edhe kjo vepër e mrekullueshme, *Njëmijë e një net* (*Elf lejletin ve lejle*).

Bagdati i kohës së Kalifit Harun er-Rashid, në shekullin VIII, ishte një qytet i rëndësishëm kozmopolit, i cili ishte i mbushur me tregtarë iranianë, kinezë, indianë, afrikanë dhe evropianë. Kultura arabe ishte harmonizuar me kulturat e tjera. Pikërisht në këtë kohë shfaqen *Tregimet e njëmijë e një netëve*, si tregime popullore. Këto tregime qarkullonin gojë më gojë tek njerëzit. Mendohet të ketë qenë novelisti Ebu Abdullah Muhamed el-Gahshigar, nga shekulli IX, ai i cili i mblodhi në një libër të vetëm, që Evropa e njohu përmes përkthimit të parë në frëngjisht, në vitin 1704.

Lidhur me origjinën e saj, ka disa mendime. Në kulturën arabe njihet një vepër perse me titull *Hezar Efsan* ("Njëmijë legjenda"), e cila në fakt nuk kishte më shumë se dyqind tregime. Disa studiues të tjerë përpiqen ta gjejnë zanafillën e *Njëmijë e një netëve* tek Panchatantra (Pesë Librat), e shkruar në sanskritisht, nga shekulli i gjashtë.

Këto tregime të magjishme pasqyrojnë një mozaik të mbarë mendimit dhe qytetërimit botëror, pasi realisht aty mund të gjenden pjesë nga kultura e lindjes së largët, lindjes së mesme, nuanca të qytetërimit babilonas, pers, madje edhe të Greqisë së lashtë.

Autori i librit "*Letërsia e Lindjes*", studiuesi dhe shkrimtari shqiptar i Kosovës, Zejnullah Rrahmani, shprehet kështu për këtë vepër madhështore:

"*Një mijë e një net*" është vepra më fantastike e novelave e krijuar ndonjëherë. Të gjithë pajtohen që është një krijim i pakufishëm i realitetit dhe fantazisë arabe nëpër shekuj. Realiteti dhe fantazia alternojnë nëpër rreshtat e tekstit, që herë duket novelë e mrekullueshme, herë tregim me ngjyra të fuqishme të reales dhe herë me gjuhën e përrallës kalon në botën e së çuditshmes dhe të mrekullueshmes." (Letërsia e Lindjes, fq. 124.)

b. LEJLA ME MEXHNUNIN

Lejla me Mexhnunin është varianti oriental i *Romeo dhe Zhulieta*. Është një tregim, që mendohet se është i bazuar në një ngjarje të vërtetë, të ndodhur nga shekulli X. Është shkruar në dy variante, nga dy mjeshtra të mëdhenj të letërsisë turke, Nizami dhe Fuzuli.

Falë mjeshtërisë së autorëve të legjendës, me shekuj të tërë është rrëfyer kjo dashuri mes një djali dhe një vajze, të çmendur pas njëri-tjetrit. Porse nga kushtet sociale, kulturore dhe politike asnjëherë nuk bëhet i mundshëm bashkimi i tyre në një kurorë. Madje, familjet e tyre i ndajnë, që të fillojnë ta harrojnë njëri-tjetrin. Nga ky dëshpërim i vazhdueshëm, djali del nëpër shkretëtirë. Nga mërzia nuk hante e as nuk pinte, vetëm këndonte bejtet që kishte thurur për vajzën, ato bejte që pastaj me shekuj të tërë u bënë himni i dashurisë në gojën e shumë të dashuruarve. Në çdo gjethe, në çdo sy e në çdo krijesë shikonte vajzën. Ngase vajza ishte me flokë të zeza, sy dhe vetull të zezë, nata i kuj-

tonte vetëm atë dhe, ngaqë nata ishte ajo që e bëri t'i shterreshin lotët nga malli dhe t'i lotonin gjak tashmë, vajzën e quajti **Lejla**, që do të thotë "e natës". Ndërsa njerëzit, ngaqë e shikonin se si ishte katandisur djali, i cili fliste me erën, me shkretëtirën, me lulet dhe me kafshët e egra, ngaqë mbulohej me natën dhe fliste me hënën, jetonte në yje dhe s'e ngrohte më as die-lli dhe vetëm për dy rrokje i hapej goja, "**Lej-la**", ai u quajt "**Mexhnun**", që do të thotë "i xhindosur i lajthitur".

Lejla si një zanë, si mëngjes që shndriste botën, **Mexhnuni** si një copë flake, si qiri që ndizte veten. **Lejla** si një trëndafil që s'kish parë vjeshtë, **Mexhnuni** si një bar i tharë në pranverë. **Lejla** një kopsht me lule, **Mexhnuni** një plagë mbi plagë. Dhe ky djaloshi i shkretëtirës që ecte si i pirë, vdiq i dehur jo nga vera, por nga era e verës së dashurisë, me mushkëri të djegur, të cilit i nevojitej vetëm një pikë nga burimi, nga **Lejla**, të cilën kurrë s'arriti ta shohë më. Një shpirt në dy trupa...

Ndërkohë që Nizami e përcjell në mënyrë mjaft mjeshtërore, në formën e prozës, këtë ngjarje mes dy të dashuruarve, si një dashuri fantastike platonike, Fuzuli përmes dyvargëshit (mesnevi) përpiket të përcjellë një mesazh mistik islam, atë të dashurisë absolute, dashurisë hyjnore.

I. TREGIMET FILOZOFIKO-MISTIKE

Me shfaqjen në skenë të letërsisë mistike islame, nga vitet 800, si dhe përkthimet që iu bënë veprave filozofike botërore, letërsia u popullarizua në mënyrë të çuditshme, pasi krahas fjalës drejtuar masës së gjerë, letërsia mistike islame kishte nuanca të forta ezoterike, metaforike dhe filozofike. Letërsinë sufiste e përbënin poezitë, prozat dhe kohët e fundit edhe romanet dhe novelat.

Hajj Ibn Jakdhan, Salaman u Absal dhe Risaletut-Tajr i Ibn Sinasë, *Hajj Ibn Jakdhan* i Ibn Tufejlit, *el-Gurbetul-garbijje* dhe *Akli surh* i Suhreverdrit, *Salaman u Absal* i Hunejn Bin Is'hakut, *Risaletut-Tajr* i Muhamed Gazalit, *Risaletut-Tajr* i Ahmet Gazalit, *Fadl bin Natik* i Ibn en-Nefisit, novelat në vargje *Mantikut-Tajr* e Feriduddin Attarit dhe *Salaman u Absal* i Abdurrahman Xhamiut, janë vetëm disa prej romaneve dhe novelave filozofiko-mistike të mendimtarëve myslimanë ndër shekuj.

Ne po ndalemi në dy prej tyre:

a. HAJJ IBN JAKDHAN I IBN TUFEJLIT

Hajj Ibn Jakdhan (I gjalli, i biri i të zgjuarit), quhet romani i parë filozofik në historinë e njerëzimit, i shkruar nga filozofi andaluzian mysliman Ibn Tufejl (shek. XII).

Romani ka tre personazhe, të cilët përfaqësojnë tri llojet e dijes: filozofinë, tasavvufin dhe shariat. Filozofi Hajj, mistiku Absal dhe dijetari rigoroz i fesë Salamani.

Romani fillon me një diskutim që kurrë nuk e kanë vjetëruar vitet, diskutimin e zanafillës së qenies njerëzore. Duke argumentuar mënyrën e shfaqjes së Hajjit në njërin prej ishujve indianë, ai arsyeton tezën e ardhjes së tij në jetë pa baba dhe nënë, përmes shkaqeve natyrore, si pasojë e faktorëve materialë. Pra, me fjalët e sotme, ai shtjellon në njëfarë mënyre hipotezën e ardhjes së njeriut, sipas teorisë së evolucionit. Si variant të dytë arsyeton ardhjen e tij në jetë, përmes një babai dhe një nëne. Mundësi të cilin duket se e mbështet gjatë ngjarjes.

Ky roman tregon rrugëtimin, meditimin, mënyrën se si Hajj arrin përsosjen shpirtërore. Ngjarja trajton në mënyrë të shkëlqyer problematikat filozofike me gojën e Hajjit edhe përmes ngjarjeve dhe personazheve të tjerë të tregimit. Disa prej këtyre çështjeve që përmenden në këtë roman, janë: zanafilla e njeriut dhe e gjithçkasë, ekzistencializmi, shpirti dhe nivelet e tij, materia, dhe pafundësia e gjithësisë, Zoti, arsyja dhe nivelet e saj, absolutja, e vërteta, revelacioni dhe profetësia etj.

Duke shpjeguar për shkakun e krijimit të një novele të tillë, Ibn Tufejl, krahas arsyes "për të sqaruar disa enigma", ka thënë:

"Njohuritë që ju kërkoni, jam përpjekur t'i përcjell përmes novelës që e kam titulluar *Hajj Ibn Jakdhan*. Ju do të arrini tek të vërtetat që dëshironi, nëse e ndiqni me kujdes Hajj Ibn Jakdhanin, për të cilin jam frymëzuar nga tregimet *Hajj Ibn Jakdhan*, *Salamani* dhe *Absali*, i Ibn Sinasë."

b. MANTIKUT-TAJR I FERIDUDDIN ATTAR-IT

Një tjetër vepër e mrekullueshme e shekullit XII, është *Mantikut-tajr* (Gjuha e zogjve), e mendimtarit mysliman pers Feriduddin Attar. Kjo vepër është e përbërë nga disa tregime të shkurtra, shkruar në vargje, të cilat tregojnë në një mënyrë mjaft të bukur rrugëtimin e zogjve për të gjetur mbretin e tyre Simurgun.

Një ditë mblidhen mijëra zogj për të zgjedhur mbretin e tyre. Mirëpo pupëza, u thotë atyre se ato e kishin një mbret, i cili ishte Simurgu. Kështu, të gjithë, nën udhërrëfimin e pupëzës nisen për të kërkuar Simurgun, por vetëm tridhjetë prej tyre arrijnë ta përfundojnë këtë rrugë të mundimshme. Përfundimisht, kur shohin Simurgun, arrijnë të kuptojnë se Simurgu (simurg persisht do të thotë "tridhjetë") ishin vetë ata. Thënë në gjuhën sufiste, ai që kërkon, e gjen Zotin brenda vetes. Gjatë udhëtimit, kur zogjtë përballen me vështirësi nga më të ndryshmet, pupëza u rrëfen tregime nga më të ndryshmet, duke kryer me sukses detyrën e saj prej murshidi.

Ashtu si *Hajj Ibn Jakdhan*, i Ibn Tufejlit edhe *Mantikut-tajri* i Attarit, janë konsideruar si vepra me shumë rëndësi, të cilat janë përkthyer shpejt në gjuhë të ndryshme dhe kanë bërë efekt të paimagjinueshëm në letërsinë dhe kulturën mbarëbotërore.

XHENETI, PARAJSA MYSLIMANE

Fjala xhenet, e cila buron nga folja xhene, që do të thotë “mbuloj, fsheh”, ka kuptimin “kopsht me pemë dhe me lule.” Në gjuhët evropiane përdoret fjala paradisi (paradise), e marrë nga gjuha greke peradeisos, e cila, sipas filologëve, është marrë nga gjuha e vjetër perse pairi-daeza, që ka kuptimin “vend i rrethuar me bimë, kopsht me bimë dhe me pemë”.

Togfjalëshi “gan Eden” i përdorur në Biblën e Vjetër për të cilësuar vendin ku jetonte ati dhe nëna e njerëzimit, Adami dhe Eva, e thënë ndryshe “Kopshti i Edenit”, përmban fjalën “gan” e cila u përkthye në përkthimin e parë të Biblës së Vjetër në Greqisht (Septiantina), me fjalën greke paradeisos. Fjala paradisesos ndeshet për herë të parë në literaturën antike greke në shkrimet e Ksenofanit.

Besimi dhe koncepti i parajsës është hasur edhe në ato fe që sociologët e religjionit i kanë quajtur “fetë primitive”. Kështu, besimi në parajsën si vendi ku do të shkohet pas vdekjes, ndeshet në popujt primitivë të ishujve Andaman, Malaja, tek lëkurëkuqtë Guarani në Brazil, madje edhe në shkrimet më të hershme të racës njerëzore, si në shkrimet Sumere, te egjiptianët e vjetër dhe persët.

Fjala xhenet përmendet në Kuran plot 147 herë (në të gjithë numrat e emrit), nga të cilat në 25 vende në kuptimin e kopshteve të kësaj bote, në gjashtë vende si vendi ku jetuan Ademi dhe Havaja, në një vend si parajsja të cilën e pa profeti Muhamed kur ishte në ahiret së bashku me melekun Xhebrail, për t’u takuar më pas me Zotin e gjithësisë (Nexhm, 13-15.), ndërsa në pjesën tjetër si parajsja ku do të shkojnë pas kiametit besimtarët

e vërtetë. Ndërsa në literaturën e hadithit, fjala xhenet është përdorur si në kuptimin e kopshtit, ashtu edhe në kuptimin e parajsës.

Në literaturën islame, më shumë në tekstet kuranore, janë përdorur edhe fjalë të tjera për të cilësuar parajsën si xhennetu’n-naim, adn, firdevs, husna (Junus, 26.), darusselam (Enam, 127), darulmukame, daru’l-ahire, akibetu’d-dar, ukbe’d-dar, illijjin, makadu sidk (Kamer, 55.)

Përshkrimi i xhenetit në literaturën islame, duke filluar me vetë Kuranin e shenjtë zënë një volum të rëndësishëm dhe janë shumë më të tepërta, po të krahasohen me përshkrimet që i bëhen xhehenemit në literaturën në fjalë. Ky fakt përbën temën bazën të cilën e ka shpallur feja islame, në lidhje me marrëdhënien Krijues-krijesë dhe vendin e njeriut brenda gjithësisë.

Me përshkrimet e xhenetit nuk janë marrë vetëm komentatorët e Kuranit, shkencëtarët e hadithit apo teologët e fesë islame, por edhe mistikët, poetët dhe shkrimtarët, si dhe pedagogët, kur kanë dëshiruar t’u drejtohen masave të gjera të popullit. Gjatë historisë së njerëzimit, xheneti ka qenë bota që dëshironin të gjithë ata që përpëliteshin mes mijëra mundimesh të kësaj jete, që nuk shijonin lumturinë në këtë botë apo që jetonin në një sistem rregullash që ishin shumë larg nga ideali i lumturisë në të cilën ata besonin. Kjo është arsyeja përse pjesë të caktura të literaturës myslimane, në të cilat flitet për xhenetin, si Bedve Tarih e Mutahar b. Tahir Makdisit, Futuhati i Muhidin Arabiut apo Jevakiti i Sharanit, nuk duhen trajtuar si burime fetare islame që kërkojnë të përshkruajnë xhenetin e jetës tjetër.



Ajetet kuranore që flasin rreth xhenetit, pjesa më e madhe e tyre në suret Rrahman, Vakia, Insan dhe Gashi-je, janë numerikisht më shumë se ajetet që flasin rreth xhehenemit. Në literaturën e hadithit, numri i haditheve që flasin rreth xhenetit është shumë herë më i madh. Në mesin e tyre, si të sakta (sahih) janë pranuar më së shumti hadithet që flasin rreth veprimeve që duhen kryer për të hyrë në xhenet apo për veprimet që do ta privojnë besimtarin nga xheneti, si dhe hadithe që flasin rreth cilësive që gëzojnë ata që do të jenë në xhenet.

Ebu Nuajm el-Isfahani pati hartuar një vepër në lidhje me hadithet që flasin për xhenetin dhe pati arritur të grumbullonte rreth 454 hadithe, së bashku me vargun e raportuesve (sened). Ndonëse flet për dyert e xhenetit, Kurani nuk na bën të ditur numrin e tyre (Hixhr, 44.), ndërsa në literaturën e hadithit nuk janë ta pakta hadithet në të cilat rrëfëhet se xheneti ka tetë dyer. Ashtu siç sqarohet edhe në hadithe, çdo derë e xhenetit do të jetë për një grup besimtarësh që janë shquar me kryerjen e një ibadeti, megjithëse i kanë kryer të gjitha llojet e ibadeteve. Kështu, do të ketë derë nga do të hyjnë ata që janë dalluar me faljen e namazit, derë për ata që kanë dhënë sadaka në rrugën e Allahut, derë për ata që janë njohur më shumë me kryerjen e agjërimit. Sikurse rrëfëhet në disa hadithe (Muslim, Xhenet, 34.), xheneti ka për të pasur vend të lirë edhe pasi të kenë hyrë në të gjithë ata që do të shkojnë në xhenet.

Nuk ka dyshim se shkalla dhe niveli me të cilin janë të lidhur besimtarët dhe njerëzit në këtë botë nuk është e njëjtë për të gjithë. Prandaj është normale, që edhe dënimi apo shpërblimi i tyre në jetën tjetër, të variojnë në varësi të punëve dhe veprave që kanë kryer ata gjatë jetës. Fakti se ata që do të hyjnë në xhenet nuk kanë për t'u shpërblyer të gjithë në një shkallë, shprehet qartë në Kuran. (Nisa, 96, Enfal, 4.). Të tërheq vëmendjen fakti se emrat Firdevs dhe Adn të xhenetit përdoren shpesh në hadithe, në krahasim me emrat e tjerë.

Mbështetur në ajetet e Kuranit dhe në hadithet e profetit, mund të thuhet se karakteristikat kryesore të begative të xhenetit për besimtarët që do të meritojnë të hyjnë në xhenet janë: 1. Luks dhe prehje e pafund, 2. Paqe dhe rehati e pandërprerë, 3. Gjendje e lartë fizike e banorëve të xhenetit, 4. Përmbushje e dëshirave shpirtërore, 5. Takimi dhe bashkëbisedimi me Allahun, 6. Amshueshmëria që i përfshin të gjitha këto që thamë më lart.

Karakteristika shpirtërore kryesore e banorëve të xhenetit, e cila theksohet më shumë në tekstet e Kuranit, është fakti se ata nuk do të ushqejnë në mendjen dhe në zemrën e tyre për asnjë moment të vetëm zili dhe urrejtje. Madje, fjalët e Kuranit "do ta heqim prej zemrave të tyre smirën" (Araf, 43.), argumenton se ata që do të hyjnë në xhenet do të përjetojnë më parë një purifikim ndjenjash dhe dëshirash. Po kështu, mbështetur në ajete dhe në hadithe, mund të thuhet se në xhenet do të përjetohet një jetë morale pa më të voglën të metë, se banorët e xhenetit nuk do të bashkëbisedojnë mes tyre gjëra të kota dhe fjalë pa vlerë, por do të mbretërojnë një jetë e vërtetë vëllazërie dhe miqësie. (Hixhr, 47, Vakia, 25, Muslim, Xhenet, 16-17.)

Struktura e xhenetit, jeta në të dhe begatitë që gjenden në xhenet tregojnë se jeta në xhenet, ashtu sikurse jeta në xhehenem, nuk ka për të qenë vetëm me shpirt dhe ndjenja, por do të përjetohej edhe fizikisht me trup, pasi bota tjetër është një botë realitetesh të ndjeshme me mish dhe me shpirt. Vetëm po të merren parasysh ajetet e Kuranit, shpjegimet dhe rrëfimet e tij në lidhje me xhenetin, ambientin e tij, begatitë e tij, përjetimet që do të jetohej aty, tregojnë qartë për një realitet të prekshëm në jetën tjetër, i cili nuk mund të komentohet vetëm me simbolikë. Të gjithë dijetarët e fesë islame janë me një mendim unanim në këtë çështje.



Lamtumirë Nënë!

2 mars: Jeta ime sapo filloi. As nëna ime e as babai akoma nuk dinë për ekzistencën time. Jam aq e vogël, sa nuk mund të shihem me sy. Por ç'rëndësi ka? Ekzistoj dhe jam e gjallë. Madje edhe gjinia ime tashmë është caktuar. Do jem një bebe femër. Do kem sy të kaltër si deti, e flokë si ari.

16 mars: Goja filloi të më formohet. Edhe pak dhe do buzëqesh për herë të parë. E di mamush, fjala ime e parë do jetë "mami". E kush e tha që unë akoma nuk kam shpirt?!

25 mars: Sot për herë të parë zemra filloi të më rrahë. U gëzova shumë. Këtë zemër do e mbush me besim dhe dashuri. Mami, mos harro, këto ditë janë shumë të rëndësishme për mua. Të lutem mos bëj radiografi, mos u sëmur dhe mos përdor ilaçe. Pi sa më shumë qumësht, largohu nga cigarja... Nuk e di si mund t'i tregoj këto këshilla, por ti e di më mirë se unë, do bëhesh mamiiii.

1 prill: Çdo ditë e më tepër rritem. Fytyra dhe gjymtyrët po më formësohen edhe më shumë. Ja, me këto këmbë do vrapoj tek ti, me këta krahë do t'i hidhem në qafë babit dhe do ta përqafoj, por më duhet ende kohë...

11 prill: Sot po vërej që në duart e mia po ndodh diçka e çuditshme, po shoh sesi dalëngadalë po më formësohen gishtërinjtë. Oh, sa bukur! Po çuditë dhe po mrekullohem se si Krijuesi im po më skalit me imtësinë më të madhe. Në të ardhmen këta gishtërinj do të rriten. Mamush, ja, me këta gishtërinj do të të përkëdhel flokët, do të mbledh lule për ty, do të kap duart e babit, do marr lapsin e do shkruaj për ju, do ndërroj faqet e librit...

19 prill: Sot nëna ime, për herë të parë mori vesh për mua. Sa shumë u gëzove apo jo, mamushi im. E gjithë bota është e jotja. E imagjinon dot ditën kur do më marrësh në krahë, kur do më ulësh në prehërin tënd, kur do më ushqesh. Oh, sa e gëzuar që jam!

21 prill: Prindërit e mi akoma nuk e dinë se jam vajzë, mbase presin djalë. Unë dua t'u bëj atyre surprizë. Dua që ata të më vendosin një emër të bukur. E dini, në Islam ka shumë rëndësi edhe emri. Kur të rritem, dua që të më thërrasin me një emër të bukur.

9 maj: Tashmë fytyra më është formuar plotësisht. Mami! E di sa shumë të ngjaj?

12 maj: Tashmë kam filluar të shoh, por këtu ka shumë errësirë. Mami, mamushi, s'të kam parë fare, oh sa shumë do doja të të shihja, të të përqafoja.

23 maj: Mami, tashmë mund ta dëgjoj zemrën tënde edhe ti timen.. Po ti, e dëgjon zemrën time që rreh vetëm për ty? Dua të vij në këtë botë, të fle në krahët e tu, të të shikoj fytyrën, të mos ndahem kurrë nga ti. A do më përqafosh? Edhe ti më pret me të njëjtën dashuri apo jo?

27 maj: Oohh, mami, mamushi im! Një dhimbje e madhe më pushtoi qenien time, më prenë gishtërinjtë, më copëtuan mushkërinë, po më shkulet zemra nënë! Mamush, të paktën më lër zemrën që të rrahë vetëm për ty. Vrasës, vrasës!

Sot nëna ime më mbyti. Ndoshta unë do bëhesha një nënë që do sillja në botë njerëz të paqtë e të mirë. Nënë, a nuk mendove fare, vrasare e kujt u bëre?

Kjo është drama e një bebeje vajzë, që nuk iu dha e drejta të vinte në këtë botë... shprehje e një të vërtete, të hidhur, por reale... Alarmi i instancave shtetërore sa vjen e shtohet, duke publikuar shifra të frikshme që dëshmojnë rritjen e këtij fenomeni jonjerëzor. Tashmë shteteve perëndimore nuk u ka mbetur gjë tjetër, veçse hartimi dhe miratimi i ligjeve që ndalojnë vrojtimin e gjinisë së bebeve në barkun e nënës.

Ndërsa Islami ndalon në mënyrë kategorike, t'i mohohet e drejta më e madhe njeriut, e drejta për të jetuar: "...Mos vritni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë, Ne ju ushqejmë ju dhe ata..." (En'am, 151)



Kini kujdes nga pecetat e letrës që përdorni!

Hulumtuesit kanë gjetur bakterie që mund të dëmtojnë shëndetin njerëzor në pecetat dhe letrat higjienike. Më e keqja është se letrat përdoren edhe pas larjes së duarve, çka do të thotë se mbrojtja nga bakteriet në to është gati e pamundshme. Ekspertët theksojnë se më të kujdesshëm duhet të jenë njerëzit me sistem të dobët të imunitetit dhe ata që punojnë në departamente të izoluar të institucioneve shëndetësore.

Lajmi arrin nga Kanadaja, ku hulumtuesit kanë testuar gjashtë marka të pecetave dhe të letrës higjienike – dhe secila ka pasur bakterie! Problemi lind tek riciklimi i letrës. Makinat janë të mbushura me mukozë bakteriale, ndërsa, për shkak të mirëmbajtjes jo të rregullt, ajo bartet edhe në letër të parashikuar për shitje dhe përdorim.

Shkencëtarët theksojnë se shumica e produkteve të krijuara nga letra e ricikluar, përmbajnë numër të madh të bakteve. Bakteriet mund të mbijetojnë gjatë në letër, sepse ajo për-

mban niseshte, që u shërben si ushqim. Shumica e bakteve që janë gjetur në letrat higjienike janë *bacillus cerus*, që shkaktojnë helmim me ushqim, infeksione të syve, mushkërive, gjakut dhe dëmtimin e sistemit nervor qendror.

Edhe pse sasitë e gjetura të bakteve nuk do të rrezikojnë shëndetin e njerëzve me imunitet të fortë, megjithatë ato paraqesin kërcënim të madh për njerëzit me imunitet më të dobët dhe këta, në të shumtën e rasteve janë fëmijët dhe njerëzit e moshuar.

Megjithatë, Elizabeth Scott, koordinatore e qendrës për higjienë në Boston dhe kolegët e saj, theksojnë se ende nuk kanë gjetur prova që dëshmojnë se dikush është sëmurë nga letrat higjienike apo pecetat.



Fiku dhe ulliri, ushqim dhe ilaç

në ditë. Kjo kurë vazhdon për 4-6 ditë.

Vaji i ullirit shërben si ilaç për mëlçinë, kuron parazitët në stomak dhe shëron kapsllëkun. Vaji i ullirit ka gjetur përdorim si pomadë për kurimin e rënies së flokëve e disa lloje sëmundjesh lëkure. Arabët i kanë njohur vlerën dhe dobitë e pemëve të ullirit që jetojnë rreth 2000 vjet. Kjo pemë është përzier me hurmat, me pseudonimin pema e arabëve, si në ushqim, ashtu edhe në shërim.

Studimet kanë vërtetuar se ulliri përmban përqindje të lartë të ujit, rreth 30%, vaj nga 15-50%, lëndë proteinore rreth 5%, karbohidrate rreth 10%, kripëra minerale, më të rëndësishmet fosfor, hekur dhe kalcium. Gjithashtu, në të gjenden vitamina A me sasi të mëdha, vitaminë B e pasur me lëndë minerale.

Vaji ka ngjyrë të verdhë që anon nga jeshilja, me erë të këndshme, ku për nga aspekti mjekësor konsiderohet i butë e i lehtë dhe i dobishëm për disa sëmundje të tëmthit, si dhe përdoret në prodhimin e disa lloje sapunësh e kremrash mjekësorë.

Ndërsa gjethet e ullirit përmbajnë lëndë kapëse, ndër më të rëndësishmet tanine, përdoret si gargarë, forcuese e kundër etheve. Thuhet se gjethet e ullirit, po të zihen, vlejnë në parandalimin e gargarinës. Gjithashtu, është provuar shkencërisht se gjethet e ullirit kanë të njëjtat veti pothuajse, duke pasur parasysh se në përmbajtjen e tyre ka hidhësi. Dihet se lënda e taninës që nxirret nga gjethet e ulliri, përdoret në procesin e tharjes së lëkurave.

Studimet e kryera nën kujdesin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, kanë vërtetuar se vaji i ullirit i pajis përdoruesit e tij me 35% të nxehtësisë dhe shmang kolesterolin në qarkullimin e gjakut. Për më tepër, vaji i ullirit ndihmon që njeriu të gëzojë shëndet të mirë, sepse ky vaj konsiderohet absolutisht më i miri, pasi nuk mbetet në muret e arterieve dhe për më tepër, ndihmon në shërimin e mëlçisë, aktivizon daljen e verdhëzës dhe pastron aparatit tretës.

Nëse trupi lyhet me vaj ulliri, ai fiton butësi të ndritshme dhe për këtë, sapuni i cili ka në përbërjen e tij vaj ulliri, konsiderohet më i vlefshëm për trupin. Kjo, pasi është vërtetuar se vaji i ullirit është më i dobishëm sesa dhjami për shëndetin dhe më i lirë materialisht.



“Pasha fikon dhe ullirin!”

(et-Tin, 1.)

Jo më kot Allahu betohet në Kuran për këto dy fruta që përmbajnë shërim, ushqim dhe shumë të mira të tjera që ende nuk i dimë.

Studimet e bëra kanë vërtetuar se fiku përmban një përqindje të lartë të lëndës ushqyese dhe vitamina. Është bërë e qartë se fiku është një frut kalorig që ekuilibron e shmang aciditetin e trupit të njeriut. Është i pasur me burime natyrale të vitaminave A, B, C dhe përmban një përqindje të pasur e të lartë të lëndëve ushqyese, sidomos elementet hekur, kalcium, bakër. Përqindja e sheqerit tek fiku zë 19% të peshës së tij, dhe për këtë, çdo 100 gr. fiqu i jep fuqi e nxehtësi trupit rreth 70 sa“ren. Është i dobishëm për gratë shtatzëna dhe ato që japin gji. Ndërsa në aspektin kurativ, fiku është i dobishëm, mbrojtës e shërues i sëmundjeve të aparatit tretës, kapsllëkut, sëmundjeve të gojës e mishit të dhëmbëve.

Është vërtetuar shkencërisht se infuzioni (ekstrakti) i fikut të thatë ndihmon diuretikët në pastrimin e gjakut. Po të konsumohet esëll, konsiderohet si një medikament i mrekullueshëm për rastet e kapsllëkut të përkohshëm, sepse përmban lëndë pastruese.

Përdorimi i brendshëm

Në rastet e kapsllëkut të përkohshëm, veçanërisht tek të moshuarit, përdoret lëngu i përfuar nga tre kokrra fiku të thatë në një gotë uji të ftohtë në mëngjes esëll e një tjetër para se të shkohet për të fjetur.

Përdorimi i jashtëm

Për inflamacione të laringjtit përdoret lëngu i përfuar i fikut të thatë si gargarë, tre herë në ditë. Për djegiet e lehta vendosen copa fiku, pasi të jenë prerë në rripa tek vendet e dëmtuara e lidhen me një fashë të pastër, e cila ndërrohet mëngjesin e ditës në vijim.

Për ulçerat e plagët e këqija vendoset fik i thatë, i zier mbi plagë, duke e lidhur me fashë, me kusht që të ndërrohet tri herë

Ndërtesa më rezistente ndaj tërmeteve

Një nga ndërtesat më të mëdha në botë, që mund t'u bëjë ballë tërmeteve të mëdha deri në 8 ballë, është terminali ndërkombëtar i Aeroportit Sabiha Gokçen të Stambollit.

I shtrirë në më shumë se 185 mijë metra katrorë, terminali nuk qëndron direkt mbi tokë, por në më shumë se 300 izolatorë, gjë që sjell mundësinë e lëvizjes horizontalisht gjatë një tërmeti. E gjithë ndërtesa lëviz si një njësi e vetme, gjë që ndalon dëmtimin nga veprimi i forcave të pabarabarta në strukturë.

"Ajo çfarë bën një sistem izolimi, është se ai i mundëson ndërtesës lëvizjen gjatë zhvendosjeve të mëdha në mënyrë kompakte. Me anë të kësaj lëvizjeje përthithet energjia e tërmetit", tha Atila Zekioglu, inxhinieri i firmës Arup, e cila projektoi ndërtesën.

Tërmetet i lëvizin ndërtesat anash, duke i lëkundur ato para dhe mbrapa. Izolatorët ngadalësojnë lëvizjen e ndërtesës. Në rastin e terminalit të ri, ndërtesës do t'i duhet t'i rezistojë një të pestës së përshpejtimit që do t'i duhej pa mbrojtjen nga tërmeti. Për fat të mirë, skicimi i strukturave të një rendimenti të tillë është bërë i lirë dhe i lehtë. Njehsimet e rritura mundësojnë simulime më të mira se si ndërtesat do të reagojnë kur i godet një tërmet.

Zekioglu dhe skuadra e tij, e skicuan ndërtesën e tyre përmes 14 simulimeve të ndryshme të tërmeteve. *"Ekzis-*



tojnë shumë teste në mbarë botën, si tavolinat lëkundëse, laboratorët testues etj. dhe ajo çfarë ne kemi bërë gjatë viteve të shkuara, është marrja e këtyre të dhënave dhe testimi i aftësisë së programit tonë kompjuterik të simulimit sizmik", - tha ai ndër të tjera.

Ky program, i quajtur Dyna, është zhvilluar së pari në Laboratorin Kombëtar të Lawrence Livermore, në 1970. Ai mund të përdoret për të modeluar atë çfarë do t'u ndodhë materialeve nën të gjitha kushtet e mundshme, nga përplasjet e makinave të tërmetet dhe të shpërthimit me bombë. Programi kompjuterik ka lejuar inxhinierët si Zekioglu, të shkojnë përtej plotësimit thjesht të kënaqësisë dhe objektivave të pronarëve të strukturës. Ju nuk doni që një aeroport (ose një spital) thjesht të qëndrojë ende më këmbë pas një tërmeti, por doni që ai të jetë ende funksional pas tërmetit.



Thika zvicerane, të cilën ushtria e këtij vendi e përdor prej shumë vitesh, tashmë do të dalë në treg me USB, me kapacitet 1TB.

Thikë zvicerane me 1 Tb USB

Nuk mendoj se ka njeri që nuk ka dëgjuar për thikën e famshme zvicerane, të cilën e prodhon firma Victorinox. Kjo thikë përmban çdo vegël, që nga kruajtësja e dhëmbëve e deri te sharra dhe njihet gjithashtu edhe si miku më i mirë i një kampisti.

Në fakt, firma Victorinox, në vitin 2009 ka hedhur në treg thikën me USB, me kapacitet 32 GB, e cila kishte aftësinë e njohjes së gjurmëve të gishtave. Mirëpo firma, me qëllim që ta çonte edhe më tej punën që kishte nisur, e pa të arsyeshme t'i shtonte thikës një USB me kapacitet 1 TB.

Firma ka prodhuar thika me performanca të ndryshme USB-je dhe u jep mundësinë përdoruesve të zgjedhin midis USB-ve me shpejtësi 2.0 dhe 3.0. Krahas kësaj, firma jep mundësinë e zgjedhjes midis SATA II dhe III. Këto USB kanë aftësinë e leximit të të dhënave me 220 MB në sekondë dhe ngarkesë me 150 MB në sekondë.

2012-ta, Një vit i vështirë për vendet e Ballkanit

Për vitin 2012 janë duke u bërë paralajmërimet për përqendrimin e gjendjes ekonomike në vendet e Ballkanit, për shkak të krizës së borxheve në vendet e zonës euro. Një shok i ri i krizës ekonomike që filloi në vitin 2008, do të mund të thellojë edhe më shumë problemet aktuale socio-ekonomike të vendeve të rajonit, të cilat ende nuk arritën t'i kapërcejnë në mënyrë të mjaftueshme ndikimet negative të valës së parë. Pritet që kriza ekonomike e zonës euro të ndikojë në vendet e Ballkanit, posaçërisht nëpërmjet kanaleve tregtare dhe financiare. Ndërsa mbretëron shqetësimi se sektori bankar në Ballkan duhet të jetë më i kujdesshëm gjatë dhënies së kredive.

Afërsisht 55% të tregtisë së jashtme, vendet e Ballkanit janë duke e realizuar me vendet e Bashkimit Evropian. Bullgaria realizon rreth 60% të tregtisë së jashtme me vendet e Bashkimit Evropian, Greqia 70%, ndërsa Shqipëria dhe Rumania i afrohen 70%. Për këtë arsye, duket se është i pashmangshëm ndikimi i vendeve të Ballkanit nëpërmjet kanalit të tregtisë së jashtme, për sa kohë që vazhdon kriza e borxheve në zonën euro.

Sot, më tepër se 80% e sistemit financiar në vendet e Ballkanit, përveç Greqisë, është në duart e bankave. Thënë ndryshe, një pjesë e rëndësishme e kursimeve transferohen në ekonominë reale nga ana e bankave. Ndërsa aktivitetet e tjera financiare, si sigurimet dhe fondet e pensionistëve vazhdojnë të jenë në nivel të ulët. Pjesa e bankave të huaja në sektorin bankar në vendet e Ballkanit, në ditët e sotme ndryshojnë ndërmjet 75-95%. Ndërsa pjesa e bankave publike është ulur në nivel minimal, kurse në shembujt e Shqipërisë dhe Malit të Zi janë ulur në zero.

Intensiteti i bankave të huaja në vendet e Ballkanit, në njërin anë është tregues se tregjet financiare në këto vende janë zhvilluar në mënyrë të sigurt, transparente dhe të volitshme. Bankat e huaja që sollën me vete edhe njohuri të rëndësishme teknike dhe risi financiare, kanë kontribuar në mënyrë të rëndësishme në forcimin e sektorit bankar në vendet e Ballkanit. Megjithatë,

për shkak të dominimit të kapitalit të huaj, sektori bankar në vendet e Ballkanit është ndikuar më shumë nga kriza ekonomike ndërkombëtare. Kështu, me ndikimin e krizës ekonomike, pas vitit 2008 janë rritur interesat mesatare vjetore të kredive në sektorin bankar në vendet e Ballkanit, ndërsa disa banka të huaja nxorën kapitalin e tyre jashtë vendit. Tani mbretëron shqetësimi se kriza në zonën euro do të mund të shkaktojë një sjellje të tillë në sektorin bankar në vendet e Ballkanit. Për shembull, në Rumani mbretëron shqetësimi se bankat austriake në këtë vend, do t'i kufizojnë kreditë me shumën e depozitave të grumbulluara dhe, për këtë arsye, do të jetohej një ulje në numrin e përgjithshëm të kredive.

Rritja e normave të interesit e lë në pozitë të vështirë edhe vetë sektorin bankar. Ndërsa, kur bëhet fjalë për shkaqet, normat e larta të interesit e rrisin edhe më shumë rrezikun e mospagesës së kreditë. Kështu që, niveli i kredive të pambledhura prej vitit 2009 e këtej, filloi sërish të paraqesë probleme në vendet e rajonit. Sipas të dhënave të Bankës Botërore, mesatarja e thjeshtë e kredive të pambledhura në 10 vendet e Ballkanit, në krahasim me numrin e përgjithshëm të kredive të dhëna në vitin 2010, ishte 11%. Siç duket, ky problem në vitin 2011 është përqendruar edhe më shumë në disa vende. Për shembull, niveli i kredive në dhjetor të vitit 2011 në Serbi, ishte 22%, në Malin e Zi 17%.

Si përfundim, kriza në zonën euro do të mund të rrisë edhe më shumë koston e marrjes së kredive dhe përqindjen e kredive të pambledhura në vendet e Ballkanit. Ndërsa rritja e nivelit të kredive të pambledhura do të mund të shkaktojë ngushtim në vëllimin e kredive. Të gjitha këto mund të shkaktojnë ngecjen e rritjes ekonomike të rajonit dhe kërkesat e brendshme, për këtë arsye, gjendja e prodhuesve mund të vështirësohet edhe më shumë. Për shkak të kësaj, viti 2012, nga pikëpamja e ekonomisë së vendeve të Ballkanit, do të mund të jetë plot sfida.

Franca miraton projektligjin e gjenocidit armen

Në dhjetor të vitit të shkuar, Asambleja Kombëtare e Francës votoi në favor të kriminalizimit të mohimit të "gjenocidit" turk ndaj armenëve, të kryer në vitin 1915. Nëse këtë vit ky ligj miratohet edhe në Senat, çdo person i cili mohon që turqit të kenë kryer gjenocid ndaj armenëve në vitin 1915, do të dënohet me një vit burg dhe me 45 mijë euro gjobë. Kjo ka shkaktuar reagimin e menjëhershëm të Ankarasë zyrtare, e cila, ashtu siç edhe kishte paralajmëruar më parë, tërhoqi ambasadorin nga Parisi. Turqia mohon termin "gjenocid" për përshkrimin e vrasjeve të Armenëve në kohën e Perandorisë Osmane. Armenia pretendon se turqit nën Perandorinë Osmane kanë vrarë rreth 1.5 milionë armenë, në vitet 1915-1916.

Ankaraja ngul këmbë se kjo shifër nuk i kalon 300000 dhe nga ana tjetër, thotë se gjatë luftës janë vrarë edhe mijëra turq. Ngjarjet kanë ndodhur në Anatolia, pasi Rusët në bashkëpunim me armenët, pushtuan lindjen e Turqisë. Më shumë se 20 shtete kanë njohur zyrtarisht vrasjet si gjenocid. Ambasadori turk, Tahsin Burcuoglu, ka lënë Francën, ndërkohë që masat e tjera që do të ndërmerren, do të shpallen nga kryeministri turk Rexhep Tajip Erdoan.

Më herët, partitë politike të Turqisë lëshuan një deklaratë

të përbashkët, me të cilën dënonin projektligjin. Ndërkohë që protestat janë zhvilluar jashtë ambasadës franceze në Ankara. Ministri turk i Punëve të Jashtme, Ahmet Davutollu, tha se shpreson që Franca nuk "do të shkelë një miqësi të madhe dhe të vjetër, për shkak të përfitimeve elektorale." Nga ana tjetër, ministri armen i Punëve të Jashtme, Edward Nalbandian, falënderoi edhe një herë parlamentin francez për projektligjin.

Vetë ministri francez i Punëve të Jashtme, Alain Juppe, ka kundërshtuar publikisht projektligjin. Ai kritikoi propozimin e projektligjit, i cili pason njohjen e vrasjeve si gjenocid që Franca ka bërë në vitin 2001. Por asokohe nuk ishte kërkuar asnjë ndëshkim për mohimin e gjenocidit. "Projektligji është i padobishëm dhe kundërproduktiv", tha Juppe.

Qëndrimi i Juppës bie në kundërshtim me qëndrimin e Presidentit Sarkozy, i cili e ka mbështetur atë. Mendohet që mbështetja e Sarkozisë për projektligjin vjen pasi në Francë jetojnë rreth 500 mijë armenë dhe vota e tyre do të jetë tepër e rëndësishme në zgjedhjet e ardhshme presidenciale. E përditshmja franceze, "Le Monde", ka publikuar një sondazh, sipas të cilit 64% e popullsisë franceze e kundërshton projektligjin. /Start/F. Prroni